

Qershor 2013
Numri: 63
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den

ETIKA




VËLLAZËRIA ISLAME
OSMAN NURI TOPBASH




QAJ PËR HIR
TË ALLAHUT...
SEMIH KURTULLUSH



SËMUNDJET
E ZEMRËS
MUHAMED EL-GAZALI



PËRLOTJA, NJË LOTJE
E HESHTUR E ZEMRËS
DR. ADEM ERGYL




DEMOKRACIA
OLIGARKIKE
NUREDIN NAZARKO



HASAN KAMIL JËLMAZ
VRAPONI PAS KURANIT

Loti i Zemrës



ISSN 2227-3611 06
9 772227 361004

Syri është një organ i mrekullueshëm, i krijuar prej Allahut, por është drita e diellit e krijuar prej Tij ajo që e bën syrin të shohë botën. Allahu nuk ka krijuar asgjë pa lidhje.

Gjithçka është e lidhur, me zemrën, ndër krijimet më të madha të Allahut mbi tokë, prandaj shpesh Ai quhet edhe Mbreti i zemrave.

Edhe zemra ka sy. Syri i zemrës është në Dorën e Tij. Drita e Tij kur bie mbi zemër e bën syrin e saj të shohë të fshehtat, ato që nuk shihen me sytë e ballit.

Por Allahu ka krijuar diçka që sytë e ballit të lidhen me sytë e zemrës.

Lotin...

Kjo është një lidhje mes botës së dukshme dhe asaj të padukshme. Malli, dashuria, trishtimi, gëzimi, dhimbja shprehen përmes lotit.

Kur njeriu nxjerr lot të çfarëdo shëm, Mëshira e Allahut është afër tij, por kur këto lot, nxirren prej mallit që njeriu ka për Krijuesin, Nuri i Allahut e rrethon krijesën.

Loti është abdesti i syrit të zemrës, që pastron edhe syrin e jash-tëm, që tregon se zemra po merr Dritën e fshehtë brenda saj, kjo është drita me të cilën besimtari

sheh Cilësitë e Zotit të tij brenda vetes, dhe i lutet Krijuesit ta pastrojë.

Kjo është Drita me të cilën besimtari bën dallimin mes së mirës dhe së keqes në këtë botë, në të përditshmen e tij. Kjo është drita me të cilën ai gjen rrugën drejt Profetit të zemrave të pastra, Muhamedit (a.s.), kjo është të ndjekësh **siratul mustakim**, rrugën e drejtë të cilën besimtari e lexon në çdo namaz, në suren *el Fatiha* (Hapja).

Ai kështu me ndihmën e Allahut, hap rrugën e zemrës, e pastron atë me lotët e tij të pendimit dhe të mallit, të dashurisë dhe frikës, të krenarisë dhe modestisë.

Loti është vetëdije dhe njëkohësisht pranimi i faktit se je krijesë, që ke nevojë për Krijuesin, loti është përkujtimi (dhikri) më i bukur i Allahut, loti është gëzimi i kuptimit të fshehtë, është dije e pastër që hyn në një zemër që po pastrohet, është dhimbja e bukur e ndjenjës së rritjes, së përgjegjësisë dhe përlësisë.


Kjo botë ka nevojë për lotët e njerëzve modestë dhe të përshpirtshëm. Ashtu si çdo lot i derdhur në këtë botë, do të jetë një mik më shumë në Botën e Amshuar.

Përmbajtja



6

Syri im!
Neslihan Nur Turk



Vëllazëria Islame
Osman Nuri Topbash

34




18



22

Përlotja, një lutje e heshtur e zemrës
Dr. Adem Ergyl

- 5 O sy i bekuar! Qaj për hir të Allahut**
Semih Kurtullush
- 8 Adhurimet janë vëllezër të njëri-tjetrit**
Rabia Christine Brodbeck
- 11 Nefsi i njeriut**
Didmar Faja
- 14 Vraponi pas Kuranit**
Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz
- 16 Dhimbjet e Habbabit dhe mesazhi universal**
Adem Saraç
- 17 Demokracia oligarkike**
Nuredin Nazarko
- 18 Dhikri dhe qetësia**
Salih Zeki Meriç
- 20 Ata që e shitën botën tjetër për këtë botë**
Salih Zeki Meriç



44

- Të dashuruar pas Parajsës -2** 24
Altin Torba
- Sëmundjet e zemrës** 27
Muhamed El-Gazali
- Komunikimi shembullor i Pejgamberit (a.s.) me fëmijët** 30
Ali Bulladë
- Një Ajet - Një Hadith** 31
- Si arrihet qetësia shpirtërore** 41
Naim Drijaj
- Bontoni islam, ç'është ky?** 42
Nexhat Ibrahim
- Lotët, çelësi i jetës shpirtërore** 44
Sadik Dana
- Qabja, qendra e vëllazërisë** 51
Ahmet Basher
- Elementet fetare në Ciklin e Kreshnikëve** 52
Drita Isufaj
- Shejtanët prej njerëzve dhe xhindeve** 55
Nuredin Jëlldëz



Lartësimi drejt devotshmërisë me shërbim fetar dhe kryerja e shërbimit fetar me devotshmëri
Mustafa Erish

38



Kurani dhe Suneti i Pejgamberit (a.s.)
Serkan Kejlu

46



Qaj për hir të Allahut...

Semih Kurtullush

Lotët janë pika të vogla që përpiqen të shuajnë zjarrin e zemrës. Brenga në zemrën e njeriut përhapet pika-pika nëpër sy, si gjethet që bien në stinën e vjeshtës. Brenga, që e ka robëruar mendjen dhe zemrën tënde, e pushton të gjithë shpirtin. Lotët nuk janë dobësi e vullnetit. Ato janë shenjat e zemrave tona, që tremben dhe ndjesisë sonë shpirtërore. Ato pika të kripura janë pjesët me të pastra dhe më të vlefshme të njerëzve.

Lotët janë respekt ndaj Allahut, frikë e brendshme dhe dridhje e zemrës, që formohet te besimtarët kundrejt Tij. Janë një frikë që lind nga dashuria dhe madhështia. Lotët që janë ndjenja e pendimit te mëkatarët dhe esenca e gëzimit të adhurimit te adhuruesit, zotërojnë cilësinë e shuarjes së zjarreve, sado të mëdhenj dhe të tërbuar qofshin. (Rijazu's-Salihin)

Lotët janë një burim pendimi për ata që hyjnë në rretjen e dashurisë hyjnore. Pendimi është si sapun. Siç i pastron sapuni papastërtitë fizike, edhe pendimi i pastron papastërtitë shpirtërore. Ai i shkatërron mëkatet. Është një falënderim kundrejt Zotit të Madhëruar. Lotët janë një vend shprese nga Allahu Teala. Fatlumët e vërtetë janë ata që mund të qajnë në derën e këtij vendstrehimi, në momentin kur priten të gjitha shpresat. (Osman Nuri Topbash)

Shehr bin Havsheb ka thënë:

“Kur Ademi u zbrit në tokë, nuk e ngriti kokën treqind vjet prej turpit që kishte ndaj Allahut.” Sikur të mblihdeshin lotët e të gjithë banorëve të tokës, nuk do të bëheshin sa lotët që derdhte Davudi, alejhi's-salam, për një gabim të tij. Sikur të mblihdeshin lotët e Davudit (a.s.) dhe lotët e të gjithë banorëve të tokës, nuk do të bëheshin sa lotët që derdhi Ademi (a.s.), kur u nxor nga xheneti. (Ruhu'l-Bejan)

Allahu Teala e pranoi pendimin e Ademit (a.s.). Allahu i Lartësuar është **“më i Mëshirshmi i mëshiruesve.”** (Jusuf, 64.)

Sikur të derdheshin kaq shumë lot për një mëkat të vetëm, do ta kishin shumë të vështirë gjendjen ata që notojnë në de-

tin e mëkatit. Nëse robi heq dorë nga mëkati dhe i rregullon veprat, edhe Allahu ia rregullon gjendjen dhe ia jep përsëri mirësitë që i ka humbur.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Dy sy nuk i prek zjarri i xhehenemit: syrin që qan duke menduar Madhëstinë e Allahut dhe syrin që nuk fle natën në rrugë të Allahut.” (Tirmidhi, Fedailu'l-Xhihad 12.)

Lotët që derdhen me vetëdijen e frikërespektit ndaj Zotit, kanë një vlerë shumë të madhe tek Ai. Derdhja e lotëve prej frikës ndaj Allahut, e shuan zjarrin e xhehenemit. Për këtë arsye, zemrave besimtare u ka hije të qajnë për shkak të frikës ndaj Allahut Teala.

Në Mesnevi thuhet:

Kur Allahu Teala dëshiron të na ndihmojë,
Dëshiron dhe dashurinë tonë e bën të qajë me halle.

O sy i bekuar! Qaj për hir të Allahut!

O zemër e bekuar! Mallëngjehu me përmallimin ndaj Allahut!

Çdo lot në fund bëhet buzëqeshje dhe gëzim.

Njeriu që mendon fundin e tij, është njeri i bekuar.

Derdh shumë lot nga sytë e tu,

Derisa filizat e këtyre lotëve të shpërthejnë në mes të shpirtit tënd.

Për ata që e shohin botën me lot të sinqertë, secila prej atyre pikave është si pasqyrë që shfaq një mijë e një oqeane në kraharonin e tij dhe në çdo grimcë të tyre duket qartë dhe ashikare madhështia hyjnore. Me atë lexohen shumë faqe urtësie të palexueshme, sepse lotët janë një gjuhë që mbart dhe shpreh kuptime që nuk mund t'i mbartin fjalët. Në këtë mënyrë, robi kërkon nga Allahu Teala gjëra që edhe vetë nuk i ka imagjinuar. Por robi duhet ta dijë se pendimi, ngaqë është kërkim i faljes, bën të domosdoshëm një vendosmëri kategorike për të mos e bërë përsëri mëkatin për të cilin kërkohet falje dhe shfaqjen e një sinqeriteti të plotë.



O drita e Syrit tim!

Nesilhan Nur Tyrk

Nëse thua se po kërkon një thesar, nuk mjaftojnë vetëm përpjekjet, në qoftë se nuk ke filluar gjurmimin.

Do të qash edhe më shumë, kështu që mos i fshij lotët, o drita e syrit tim dhe përpiku.

Tani nuk është koha për t'iu dedikuar dhimbjes, por shërimit. Por shikimi gjithnjë të ka ngelur pas. Ndërkohë që duhet të kthehesh përpara dhe të ecësh me shpresë, mos u jep rëndësi vuajtjeve që të përgojnë nga pas! Kurrë mos prano të lidhesh pas këmbëve të tyre si pranga, sepse ky shans i vetëm që quhet jetë po kalon, o drita e syrit tim.

Një vend mund të mos jetë i pastër aq sa e pandeh, ndërsa një vend tjetër mund të mos jetë aq i papastër sa pandeh. Në vend që të mashtrohesh duke u dhënë pas pamjes së jashtme, mundohu të përfitosh duke menduar mirë, sepse ai që mendon mirë, përfiton nga e pastra dhe nga e papastra. Ti shiko mirë ashtu siç të ka hije, në mënyrë që të shohësh mirësi.

S'ka gjë. Le të supozojmë, se vëllai të ka dëmtuar në diçka. Le të supozojmë se ka rënë në një gjendje që s'ka mundësi të kujdeset për ty. Madje, le të jetë i pafytyrë etj., etj... Ti përsëri duaje atë. Lutu sinqerisht për të. Nëse nuk e di se si do t'ia dalësh mbanë kësaj, po të tregoj një rrugë: Mendo sikur është ndezur një

zjarr i madh për vëllain që s'e fal dot. Aty do të digjet e përvëlohet, madje, përpara të gjithëve. Britmat e tij do arrijnë deri në kupë të qiellit. A mund të durosh? A mund ta falësh përballë kësaj panorame çfarëdo që të të ketë bërë? Nëse ti nuk e fal, zjarri do të rritet edhe më shumë, do të kthehet në xhehenem dhe ai do të përvëlohet. A ta pranon zemra këtë? Nëse thua: "E kam falur. Të mos digjet", Allahu të faltë ty, vëllain tënd dhe të gjithë ne. Por, nëse thua: "Pranoj. Ç'më duhet mua. Le të digjet", Allahu të faltë o drita e syrit tim!

Ajo që kërkohet është shija e kafes dhe sinqeriteti i atij që e bën. Atëherë, shijoj dhe mos e nënçmo, duke i thënë se qenka bërë pa shkur. Nëse vepron kështu, mund të arrish një shërim që nuk e ke shpresuar. Të vërtetën fetare mund ta kuptosh vetëm duke e shijuar. Kur ta kuptosh, do të qash. Kur të qash, do të pastrohesh, o drita e syrit tim.

Sikur ta dije anën e brendshme të disave që shkon pas tyre dhe i respekton, nuk do të kaloje qoftë edhe nga afër tyre. Sikur ta dije të vërtetën e shumë prej atyre që nuk i pëlqen dhe e rrudh fytyrën, do të dëshiroje të ishe rob natë e ditë në derën e tyre. Allahu Teala fsheh shumë thesare nëpër rrënoja, në mënyrë që të mos i gjejnë të padurueshmit dhe të verbrit. Por ka edhe rrënoja që i pandehim thesare. Allahu na ruajtë të gjithëve nga shkatërrimi i këtyre mbi kokat tona. Përfundimisht, të gjesh nuk është e lehtë. Nëse thua se po kërkon thesar, nuk mjaftojnë vetëm përpjekjet, po nuk gjermove. Do të qash edhe më shumë, kështu

që mos i fshij lotët, i dashur dhe përpiku.

Të ndodhin shumë probleme për shkak të gabimeve që ke bërë dhe belave që ke kërkuar, por ti përsëri pyet: "Çfarë bëra unë?" Mbi të gjitha, kërkon fajtorë të tjerë. Në vend që të veprosh kështu, hesht dhe ki turp, sepse të turpërohesh është diçka e bukur. Ki turp, sepse ai që ka turp përpiket të mos i përsërisë gabimet. Ki turp, sepse kundrejt Krijuesit gjithmonë të ka hije turpi. Ndoshta kështu të ulet koka, shpëton nga mendjemadhësia dhe nuk i shikon më me nënçmim robërit e Allahut Teala, o drita e syrit tim.

Ata që e teprojnë dhe i kalojnë kufijtë, janë dy llojesh: Lloji i parë sillet duke e bërë të qartë njetin që ka. Në këtë mënyrë, të trembin dhe të bëjnë të largohesh. Lloji i dytë e fsheh njetin e tij si një gjuetar mjeshtër. Ia fiton zemrën gjahut me dashamirësi dhe i përgatit kurthin me mirësjellje. Dy gjëra mund të bësh përballë një njeriu të tillë:

1- E kupton shpejt gjendjen, por të bën të ndihesh mirë dhe bie në kurth duke e ditur. Në këtë situatë nuk je viktimë. Kështu që mos bërtit dhe mos bëj zhurmë për shkak të mashtrimit.

2- Nuk e kupton kurthin dhe nuk e ndjen sherrin, për shkak të njetit tënd të mirë. Madje gëzohesh, kur e shikon ngaqë e do. Por kur të biesh në kurth, e kupton se ke gabuar. Këtë herë je viktimë, por çfarë do të përfitosh, nëse bërtet pasi të biesh në kurth? Të gjithë do ta dëgjojnë. Nëse e heq baltën, ngelet shenja e saj. Ajo shenjë nuk do të të ngjitet vetëm ty, por të gjithë atyre që të rrethojnë. Atëherë, lëre veten në një qoshe dhe përsëri hesht e mos bërtit, në mënyrë që të pengosh një dëm edhe më të madh, edhe pse e di se do të përpiqen të japin argumente kundër teje dhe do të thonë: "Ishe i kënaqur dhe nuk nxore zë." Derdh lot dhe duro për atë që të ka ndodhur! Padyshim se vjen një ditë dhe ndahet shapi nga sheqeri dhe drejtësia gjen vendin e saj.

Vjedhjen e kanë quajtur sëmundje dhe turpin e kanë quajtur rehati. Zhveshjen e konsiderojnë guxim dhe të shikuarit e zhveshjes e konsiderojnë burrëri. Pasi ranë deri në këtë gradë, disa njerëz e pandehën si famë apo mjeshtëri bërjen e disa punëve që vetëm kafshët i bëjnë përpara të gjithëve. Sikur dikush i urdhëroi: "O njerëz! Virtyti është turp dhe turpi është virtyt! Termat duhen ngatërruar. Njerëzit duhet të garojnë në neglizhencë dhe në humbje!" Ata që përpiqen në rrugë të Zotit, sikur janë kthyer në dele përballë atij që dha këtë urdhër. Ndërkohë që termat janë ngatërruar kaq shumë, ti e ke farz qëndrimin pranë atyre që e kanë zemrën e zgjuar. Këtë e tutje, duhet të shikosh më me shumë kujdes rreth e rrotull dhe duhet të qash më shumë në sexhde, o drita e syrit tim.

Shkrimet nuk mund të tregojnë tonin e zërit tënd

dhe as qëllimin e përvëlmin e zemrës tënde. Për ta konsideruar fajtor apo të pafajshëm një njeri duke u mbështetur në një argument të shkruar, duhet ta njohësh nga shumë afër atë, por prapëseprapë, zemra e atij njeriu që e njeh shumë mirë, shpeshherë është një botë misterioze për ty. Atëherë vëzhgoje, edhe një herë vëzhgoje. Nëse dëshiron të mos pendohesh më vonë, llogarite edhe anën e padukshme të çështjeve dhe mos nxito të gjykosh me atë që ke parë, o drita e syrit tim.

Para se të gjykosh, shikoje me kujdes, sepse ai që e pandeh kosh mbeturinash, mund të ketë ndonjë copë floriri. Nëse nuk ka flori, mund të ketë argjend. Nëse nuk ka argjend, mund të ketë thërrime buke. Sidoqoftë, ti mësohu të shikosh me kujdes. Kontrolllo përsëri para se të varësh, të presësh dhe të derdhësh. O drita e syrit tim! Mos u bëj mendjeshkurtër, dembel dhe i verbër!

The: "Unë e dua vuajtjen që më bën të të shikoj dhe të të takoj. Por pas kësaj, dua gëzimin që më bën të vij te ti." Tha: "Ti do ta arrish edhe atë gëzim kur të mësosh të falënderosh për vuajtjen. Ja, atëherë do të qash me gëzim dhe jo me vuajtje, o drita e syrit tim."

Ke një njet të mirë dhe një shikim të pastër, por kjo nuk mjafton. Këtyre bukurive shtoj edhe zgjuarsinë dhe mendjemprehtësinë, në mënyrë që shija jote të jetë e përsosur. Mos u zemëro me asnjë. Çfarëdo që të të ndodhë, është pasojë e punëve të tua. (esh-Shura, 30) Mund të bësh çdo lloj gabimi, por nëse je i dashuruar, mos gabo ta shohësh me dyshim të dashurin, o drita e syrit tim.

Duhet të shohësh pa bërë zënka, pa ofenduar, pa sulmuar dhe pa e larguar si dallkauk atë që nuk meriton. Duhet ta pranosh se britma e papjekur nuk është gjë tjetër përveçse zhurmë. Ti duhet të rritesh për hir të respektit të nënës, e cila të ka përkundur në gjunjë përgjatë gjithë natës, duke thënë: "Rritu, rritu, rritu!" A nuk do të ishte keq për ty, o drita e syrit tim, nëse nuk i dëgjon këto që them dhe nuk ua vë veshin këtyre që shkruaj, nëse nga një mish i butë shndërrohesh në një mish të madh të papjekur?

E kam shumë të qartë se askush nuk është pa mangësi qind për qind. Por edhe të mangët qind për qind nuk ka. Allahu i bëftë sunduese të vërtetat tona dhe na mundësoftë që të përkujtohemi me drejtësi. Gjithashtu, kam mësuar se çdo njeri ka mirësi. Po ashtu, ka edhe sherr. Allahu i shndërroftë sherret tona në mirësi, mirësitë tona i bëftë dominuese dhe na mundësoftë të përkujtohemi me mirësi. Tani për tani nuk kam gjë tjetër për të thënë. Kjo është fjala ime e fundit: Mos shiko ashtu! Mos rri duke parë, por thuaj amin, o drita e syrit tim!



Adhurimet

janë vëllezër të njëri-tjetrit

Rabla Christine Brodbeck

Çdo besimtar ka nevojë për ekuilibër. Në njërin krah duhet të jenë adhurimet dhe në tjetrin morali i bukur e sjelljet e mira. Mënyra e jetesës sonë, është mënyra e adhurimit tonë dhe mënyra e adhurimit tonë, është mënyra e jetesës sonë. Qëllimi ynë dhe dëshirat tona përcaktojnë cilësinë e adhurimit dhe besimit tonë. Ndërkohë që jemi duke plotësuar detyrat fetare, në të njëjtën kohë duhet të meditojmë edhe mbi kuptimet që bartin ato. E shprehur ndryshe, ndërkohë që jemi duke plotësuar të gjitha detyrat si robër të devotshëm të Allahut, duhet të bashkojmë luftën tonë fizike dhe ekzistencën tonë trupore me rrënjët tona hyjnore dhe ekzistencën tonë shpirtërore. Mevlana i nderuar ka thënë:

“Të kërkojmë prej Allahut të arrijmë sukses në edukatë. Të paedukatit, i mungon mirësia e Allahut. I paedukati nuk i bën dëm vetëm vetes së tij, por djeg me zjarr në të katër anët. Çfarë të të bjerë (në kokë) prej errësirave dhe hidhërimeve, janë prej mungesës

së frikës prej Allahut dhe arrogancës ndaj Tij. Kush nuk ka frikë në rrugën e Mikut (Allahut), merr rrugën e shejtanit dhe ai është frikacaku (i vërtetë). Ky qiell, në sajë të edukatës, është mbushur me dritë. Gjithashtu edhe meleku prej edukatës e ka pafajësinë dhe pastërtinë”.

Sheriati (ligji i Allahut), është dhënë me qëllim që të thellojë ekzistencën e njeriut. Mirëpo, shumë njerëz të fesë mendojnë se çështja e mënyrës së edukimit dhe qëllimet shpirtërore, kanë të bëjnë vetëm me tarikatin. Por në fakt, pa pasur një formë (të jashtme), s'ka as një përbërës të brendshëm, pa qenë përpjekja për adhurim, nuk ka as ngritje shpirtërore. Pa qenë shishja, uji s'mund të vendoset gjëkund. Po të mendojmë të kundërtën, nëse nuk ka ujë, s'ka nevojë as për shishe. Një fjalë që s'ka kuptim, as nuk hyn në punë. Pa pasur një xhenet, toka s'ka shkak të ekzistojë. Po trupi, ç'dobi ka, nëse shpirti s'ekziston?

Gjithashtu edhe në shariat mund të shohim të njëj-



tën urtësi. Allahu Teala i ka radhitur në një mënyrë aq të mrekullueshme pesë kushtet e Islamit, sa të gjitha plotësojnë dhe ushqejnë njëra-tjetrën. Çdo njëra prej tyre ka nevojë për tjetrën. Plotësimi me përpikëri i njëres prej tyre, siguron sukses edhe në plotësimin me përpikëri të të tjerave. Ato janë radhitur në një mënyrë kaq të mrekullueshme, sa që kur shkelet një prej atyre kushteve, urdhrat e tjera hyjnore e humbasin pasurinë, kuptimin dhe thellësinë e tyre shpirtërore.

Një herë, Allahu Teala e pyeti Xhebrailin (alejhi salam):

“O Xhebrail! Nëse do të të kisha krijuar si njeri, si do të më adhuroje?”

“O Zot!”

Thirri Xhebraili (a.s.).

“Për Ty nuk ka asnjë të fshehtë.”

“Po, ashtu është,-” tha Allahu. **Prandaj njoftoji robërit e Mi, se ata nuk i dinë ato që di Unë.”**

Pastaj Xhebraili (a.s.), vazhdoi duke thënë:

“Unë do të të adhuroja në tri mënyra: e para, duke ndihmuar të varfrit, e dyta, duke mbuluar gabimet e gabimtarëve dhe e treta, duke u shuar etjen të eturve për ujë...”

Allahu i Madhëruar urdhëroi e tha: **“Për shkak se e dija që ti ishe kështu, të kam zgjedhur si mjetin më të sigurt për të përcjellë shpalljet e Mia.”**

Nëse e adhurojmë Allahun Teala pa treguar mëshirë ndaj njerëzve, si do të qëndronim para Tij në atë gjendje? Nëse nuk do të qëndronim me mëshirë në namaz, si do të arrinim te Mëshiruesi?

Një herë, Dhunun-i Misri po shkante në haxh. Gjatë udhëtimit në shkretëtirë, rastisi një qen i cili po lëpinte dheun prej etjes. Mirëpo, me vete nuk kishte fare ujë, prandaj nxitoi pas karvanit dhe u thirri: “O haxhilerë! Ky është haxhi im i shtatëdhjetë. Kush i jep ujë këtij qeni, do t’i fal shpërblimin e shtatëdhjetë haxheve që kam bërë.”

Përveç këtyre:

As meditimi nuk pranohet pa zbatuar urdhrat e Allahut.

As dituria pa veprat dhe punët e mira.

As mirësia pa adhurimet.

As namazi pa vetëdijen hyjnore.

As dituria pa namazin.

As zekati pa dashurinë.

As agjërimi pa sadakanë.

As dashuria pa vepra.

Dhe as adhurimi pa agjërimin.

Kurani Kerim, në lidhje me diturinë pa zekat, pa dashuri dhe pa shërbim, shprehet me këto fjalë:

“...Ata i ngjajnë gomarit, që vetëm sa i bart librat...”
(Xhumu’a, 5.)

Në të njëjtën mënyrë, sakrifica, sadakaja dhe shërbimi që bëhen pa vetëdije hyjnore, pa dashuri dhe pa përlujë, nuk janë gjë tjetër veçse veprime të kota dhe të pakuptimta.

Ka prej atyre besimtarëve që e duan shumë adhurimin, por neglizhojnë meditimin. Ashtu siç ka edhe njerëz që vrapojnë sa në një ligjëratë fetare në tjetrën dhe që i lexojnë të gjithë librat fetarë, por nuk falin namaz. Gjithashtu ka edhe njerëz të cilët agjërojnë vazhdimisht, por nuk tregojnë mëshirë dhe butësi ndaj shokëve e miqve të tyre dhe nuk i ndihmojnë ata.

Adhurimet janë vëllezër të njëri-tjetrit. Haxhi dhe namazi janë si dy vëllezër binjakë, që e plotësojnë njëri-tjetrin. Haxhi dhe namazi nuk janë gjë tjetër përveçse sprova për botën tjetër. Haxhi dhe namazi janë prej adhurimeve, në sajë të të cilave Allahu Teala i dhuron robit Paqen e Tij. Namazi, brenda një kuptimi simbolik, është një haxh i vërtetë. Namazi, është një haxh që bëhet në thellësi të zemrës, në atdheun e vërtetë të shpirtit. Miraxhi në të cilin arrin njeriu gjatë faljes së namazit, është një haxh shpirtëror. Dhe një haxh i tillë, në thelb është një Miraxh.

Zekati dhe agjërimi, janë dy vëllezër binjakë. Të dy janë një mënyrë edukimi dhe lufte me nefsin (egon) dhe të dy arrijnë ta eliminojnë egoizmin. Gjithashtu, ata sigurojnë pastërtinë e trupit, mendjes, zemrës dhe shpirtit. Ata pakësojnë lidhjen e tepërt me materien dhe lehtësojnë peshën e trupit duke rritur cilësinë e jetës shpirtërore. Zekati dhe agjërimi pastrojnë botën e brendshme të njeriut dhe të gjitha papastërtitë që janë mbledhur gjatë një viti. Zekati dhe agjërimi na ndihmojnë të kryejmë më mirë namazin dhe haxhin. Gjithashtu, edhe namazi me haxhin na ndihmojnë të kryejmë më mirë zekatin dhe agjërimin. Zekati dhe agjërimi, janë vepra të padukshme, adhurime që bëhen në fshehtësi. Kurse haxhi dhe namazi, janë adhurime të dukshme.

Për kryerjen e adhurimeve të haxhit dhe agjërimit, Allahu ka caktuar një muaj për secilin prej tyre, Dhil-hixhen dhe Ramazanin. Në Islam, këta dy muaj konsiderohen muajt më me vlerë ndër të gjithë muajt e vitit. Këta dy muaj janë dhuratë e Allahut për umetin e Muhamedit (a.s.). Dhe umetit të Muhamedit (a.s.), nuk i është dhënë në asnjë kohë tjetër një 30 ditësh kaq i begatë me mëshirë, sa ç’është muaji i Ramazanit. Për këtë arsye, Ramazani quhet edhe sulltani i të gjithë muajve ose muaji i dritës. Siç thuhet edhe në një hadith fisnik: **“Në muajin e Ramazanit hapen dyert e mëshirës,**

mbyllën dyert e xhehenemit dhe lidhen shejtanët."

Prej thesareve të fshehta të këtyre dy muajve të shenjtë përfitojmë aq sa edhe i përjetojmë ato. Muajt e Ramazanit dhe të Haxhit e zbukurojnë jetën tonë, e ngrenë atë në një nivel më të lartë, e pastrojnë, e ndriçojnë dhe e vetëdijësojnë atë.

Gjatë muajve të Ramazanit dhe të Haxhit besimtarët festojnë mirësitë e fesë islame. Veçanërisht në muajin e madhërisëm të Ramazanit, ne festojmë bukurinë dhe përsosmërinë e fesë islame. Zbritjen e Kuranit të Madhërisëm e festojmë duke agjëruar. Ky muaj i begatë u është falur njerëzve për të nderuar natën e Kadrit, në të cilën u zbritën ajetet hyjnore. Shpirti i Ramazanit, janë ajetet hyjnore. Nëse Ramazani është trupi, Kurani është shpirti i tij. Gjithashtu, me haxhin festojmë fenë e teuhidit. Feja islame është një thirrje drejt përsosmërisë, ajo është feja e teuhidit. Ndërsa haxh do të thotë të jetosh fenë e teuhidit. Përfitimi prej haxhit, shpërblimi, përpjekja dhe qëllimi i tij, është teuhidi. Festimi i tij, do të thotë që besimtarët t'i kthehen er-Rahimit, të strehohen tek Ai dhe të rigjallërohen me Të.

Qabja është përgjigja që u jep Allahu haxhilerëve, të cilët digjen nga malli për Zotin e tyre. Kurse besimtarët, gjatë haxhit përjetojnë gëzim të madh kur i përgjigjen ftesës së Allahut, duke thënë: "Lebejke Allahume...". Në Ramazan besimtarët ndjejnë kënaqësinë e përgjigjes që u japin përgjërimeve të Pejgamberit (a.s.), i cili thoshte, "Ummeti Ummeti / Populli im, Populli im".

Në haxh, haxhilerët emigrojnë në vendin e shenjtë të Mekës, duke dalë në një udhëtim shpirtëror. Kurse Ramazani vjen si mysafir në jetët e besimtarëve që agjërojnë. Shpirti i Ramazanit ndikon në çdo fushë të jetës së umetit të Muhamedit (a.s.) dhe duke e stolitur atë me ekzistencën hyjnore, i bën besimtarët të kuptojnë vlerën e tij të madhe. Në këtë mënyrë, Ramazani i bekuar bëhet një skenë hyjnore për të gjithë umetin e Muhamedit (a.s.), i cili agjëron mbi faqen e dheut.

Në Ramazan, mbaj stomakun bosh, që të arrish mirësitë hyjnore. Në haxh bëhu pjesë e tregtisë hyjnore të botës tjetër dhe pritja damarët nefsit (egos), që të fitosh jetën e përjetshme.

Në Ramazan, agjëro ndaj mirësive të kësaj bote, që të rritet dashuria për Allahun dhe vetëdija hyjnore. Në haxh shijo vdekjen e nefsit, që të fitosh të drejtën e rilindjes.

Në Ramazan, bëhu mbreti i zemrës së dikujt, që të fitosh thelbin e dashurisë dhe vetëdijes hyjnore. Në haxh bëj kurban nefsit, që të arrish dritën hyjnore, bëhu jetim e rob i Allahut dhe kërko strehim tek Ai.

Agjërimi shton urtësitë dhe ndjenjat tona shpirtërore. Ai i bën më të qarta ajetet e Kuranit, duke e bërë njeriun pjesë të shpalljes. Haxhi e ndihmon njeriun të shpëtojë prej jetës në mes të katër mureve dhe e hedh atë në shkretëtirën e ekzistencës për të përjetuar urtësitë e ajeteve hyjnore.

Në Ramazan trokit në derën e urisë dhe kërko ujin e jetës në shkretëtirën e ekzistencës së thatë. Dhe si shpërblim do të të jepet zemzemi. Në haxh ec drejt zjarrit të Ibrahimit (a.s.), drejt thikës së Ismailit (a.s.). Afrohu tek ata aq sa ta ndjesh nxehtësinë e zjarrit dhe tehun e thikës në fyt. Dhe si shpërblim do të të jepen bahçet me trëndafila. Do të të jepet jeta e përjetshme dhe kënaqësia e mrekullueshme e rilindjes.

Agjërimi shton nevojën e krijesave për Krijuesin dhe largon pengesat në rrugën që të çon tek Halik-i Dhu'l Xhelal ue'l Ikram. Shton mallin dhe etjen për rrugën e së vërtetës dhe nevojën absolute për botën tjetër. Haxhi është mënyra për të shprehur fizikisht strehimin tek Allahu prej mashtrimeve të kësaj bote, nxitimin dhe ikjen për tek Ai.

Dhjetë ditët e itikaftit, që janë kulmi i muajit të Ramazanit, janë simboli i dorëzimit të plotë ndaj Allahut Teala. Pra, qëllimi dhe thelbi i vetmisë, është qëndrimi i njeriut me të dashurin e tij, Allahun Teala. Gjatë haxhit, në sheshin e Arafatit, njeriu rifton xhenetin e humbur. Përballet përsëri me të vërtetën. Dëshiron ta rifitojë përsëri besimin e tij. Gjen përsëri ujin e jetës. Arrin përsëri madhësitinë e vetëdijes hyjnore, thelbin, forcën dhe frymën e ngritjes. Bëhet përsëri Njeri.

Haxhi dhe Ramazani janë sexhdja e vazhdueshme e zemrës, miraxhi i vazhdueshëm i shpirtit, kthimi në shtëpinë e përjetshme, sprovë e vazhdueshme e botës tjetër. Haxhi dhe Ramazani, janë thirrje për vdekjen e vërtetë të nefsit, një operacion i zemrës dhe sprovë që e ndryshojnë rrënjësisht jetën. Haxhi dhe Ramazani janë adhurime universale. Një edukim shpirtëror për të gjithë njerëzimin. Agjërimi është xhihad, është flijim i vetvetes. Flijimi i vetvetes, do të thotë të vdesësh para se të të vijë vdekja. Të vdesësh para se të të vijë vdekja, është ihram. Ihrami është itikaf, itikafi është tehexhud, tehexhudi është sexhde dhe sexhdja është miraxh.



NEFSI I NJERIUT

Nga perceptimet e mistikëve klasikë myslimanë

Didmar Faja

Zoti i Plotfuqishëm e ka krijuar njeriun dhe e ka pajisur atë me perceptorë të ndryshëm, në mënyrë që të mbijetojë në këtë botë dhe të arrijë lumturinë e tij në botën tjetër. Ndër këta perceptorë që i ofrohen atij, është edhe ai që Kurani i referohet me fjalën *nefs*, vetja. Në lidhje me këtë fjalë, janë dhënë përkufizime të ndryshme nga studiuesit, por ato janë të ngjashme me njëri-tjetrin. Disa prej tyre e përkufizojnë atë me fjalën vetja e njeriut, ndërsa studiues të tjerë e përkufizojnë si pasion dhe ambicje e njeriut, e cila mund ta dërgojë atë në disfatë. Fjala *nefs* është përmendur në shumë ajete kuranore. Për shembull, në Kuran thuhet: **“Për shpirtin dhe për Atë që e ka përsosur, duke ia bërë të njohur atij të keqen e të mirën! Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë, ndërsa kushdo që e shtyp atë (me punë të këqija), do të dështojë.”**¹

Pas pranimit të faktit se nefsi mund ta çojë njeriun në humbje dhe mund të bëhet kërcënim për jetën e tij të përtejme, kërkohet një rëndësi e veçantë jo vetëm në të kuptuarit e anës negative, por dhe në të kuptuarit se si funksionon ai. Kjo nuk është një arritje e lehtë, për shkak se kërkohet që njeriu të merret me botën e brendshme dhe jo me fizikun e tij. Me fjalë të tjera, kjo është një luftë shpirtërore dhe jo materiale.

Shpesh, njerëzit tregojnë vëmendje të veçantë në parandalimin e sëmundjeve trupore, por neglizhojnë

parandalimin e sëmundjeve shpirtërore dhe bëhen viktima të ambicjeve të tyre. E gjithë përpjekja me nefsin duhet ta bëjë njeriun të arrijë në bindjen se çdo gjë është për Zotin dhe jo për nefsin. Kjo bindje fuqizohet dhe e bën njeriun të dëshmojë Allahun (xh.sh.), në veprat e tij, kur ai asgjëson ambicjet. Zoti e paralajmëron Profetin Daud në Kuran:

“O Daud, Ne të kemi bërë mëkëmbës në Tokë, pra ndaj gjyko ndërmjet njerëzve me drejtësi dhe mos shko pas dëshirave dhe tekave, se ato të largojnë nga rruga e Allahut! Me të vërtetë, për ata që largohen nga rruga e Allahut, ka dënim të ashpër, ngaqë e kanë harruar Ditën e Llogarisë.”²

Ndër veprat më të rëndësishme, që e dallon njeriun nga krijesat e tjera (duke përfshirë edhe engjëjt), është aftësia e të luftuarit me epshet. Shpërblimi i kësaj përpjekjeje është suksesi në këtë botë dhe në botën tjetër. Në Kuran është përmendur:

“I shpëtuar është ai që pastrohet.”³

Në librin e famshëm *El-Risāleh el-Kushejrijeh*, shkruar nga Ebū el-Kāsim el-Kushejri (v. h. 464, 1072), në lidhje me nefsin, autori thekson dy kategori kryesore, të cilat përfshijnë mangësitë e njeriut. E para, përmban mëkatet dhe mosbindjen dhe për të dytën, Kushejri përmend kategorinë, e cila përfshin bazën morale të pandarë të individit. Kjo kategori përmbledh sjelljet dhe veset e këqija, si: krenaria, zilia,

1. Shems, 7-10.

2. Sad, 26.

3. A'la, 14.

zemërimi, temperamenti i keq, mungesa e tolerancës dhe tipare të tjera të ngjashme.⁴

Kushejri gjithashtu përmend se veçoria më e vështirë dhe më e pakëndshme për nefsin është mendimi se përmban diçka të mirë në brendësi dhe për atë meriton respekt. Autori e përfshin këtë në aktet e politeizmit.⁵ Kjo karakteristikë çon shumë njerëz në humbje. Disa prej tyre, meqë zotërojnë pasuri dhe status të veçantë, presin respektin e të tjerëve. Kjo ambicje është një atribut djallëzor dhe burim i shumë veçorive të tjera negative. Është përmendur në Kuran se kur Jusufi (a.s.), foli për nefsin të tij, e përkufizoi shumë bukur atë duke thënë:

“Unë nuk e shfajësoj veten, sepse shpirti (i njeriut) është fort i prirur për të keqe, përveç atij që e mëshiron Zoti im. Me të vërtetë, Zoti im është Falës dhe Mëshirëplotë.”⁶

LLOGARITJA E VETVETES

Ta llogarisësh ose ta analizosh veten tënde, është një ndër veprat më të theksuara në Islam. Udhëheqësi i besimtarëve 'Umer el-Khaṭṭāb (v. h. 23, 644) përmendet të jetë shprehur: "Bëni llogari veten tuaj, para se të bëheni llogari."⁷ Shumica e njerëzve gjykojnë mangësitë e të tjerëve dhe harrojnë të gjykojnë veprimet e tyre. Kur t'ia vendosësh gishtin dikujt, duhet të shikosh se të gjithë gishtat e tjerë të dorës të drejtohen ty. Ky shembull tregon se njeriu në fillim duhet të analizojë veten e tij. Jo vetëm aq, por ne jemi gjithashtu të rekomanduar që njerëzit e urtë të na i kontrollojnë veprimet dhe të na këshillojnë. Kjo bëhet për shkak se individit është i kufizuar në perceptimin e të gjitha të metave, ndërsa të tjerët mund të shikojnë më shumë duke vëzhguar sjelljen e jashtme. Për këtë, udhëheqësi i parë i besimtarëve myslimanë pas Profetit Muhamed (a.s.), Hz. Ebu Bekri (r.a.), deklaroi në fjalën e tij pasi u zgjodh Khalif, "Unë nuk jam më i miri midis jush. Nëse bëj mirë, më ndihmoni dhe nëse anoj drejt së keqes, atëherë më drejtoni në rrugën e drejtë."⁸

KËRKESA E NDIHMËS NGA ZOTI

4. Ebu el-Kasim el-Kushejri: *El-Risaleh el-Kushejrijeh*, Metabe' Mues - eseh Dar el-Sha'b, Kajro, 1989, fq.174.

5. Ibid.

6. Jusuf, 53.

7. Abdullah ibn Ebi Shejbeh: *Musnefibebebi Shejbeh*, El-Faruk el-H - ditheh li-el-tiba'ahve el-Neshr, Kajro, 2007, v. 12, hadithi 35463, fq. 58.

8. Xhelal el-Din el-Sujuti: *Tarikh el-Khulefa*, Dar Ibn Hazim, Bejrut, 2003, fq. 57.

Një mënyrë tjetër, që mund të jetë e dobishme në kufizimin e nefsit të njeriut nga ambicjet, është kërkesa e ndihmës nga Zoti, në luftën kundër epsheve. Në suren en-Nās, Allahu e urdhëron Profetin Muhamed (a.s.) dhe besimtarët për të kërkuar strehim te Zoti i njerëzve⁹. Sidoqoftë, është i pavlerë kërkitimi i mbrojtjes nga Allahu i Plotfuqishëm, pa punuar në kufizimin e epsheve.

QËNDRIMI NË SHOQËRINË E TË DEVOTSHMËVE

Në librin e tij, *Fīhi mā fīhi*, Xhelal el-Dīn el-Rūmi përmend, që përpjekjet me nefsin janë të llojeve të ndryshme, por më e madhja dhe më e vështira është përpjekja e qëndrimit të vazhdueshëm me ata që i kanë kthyer fytyrat e tyre nga Zoti dhe i kanë kthyer shpinën kësaj bote.¹⁰ Kjo, për shkak se ata janë vazhdimisht të kujdesshëm në lidhje me Zotin, larg ambicjeve të nefsit. Qëndrimi në shoqërinë e tyre arrihet përmes përpjekjeve ndaj nefsit. Rūmi shkon edhe më tej, duke

përmendur se edhe hipokritët përfitojnë kur gjenden në shoqërinë e njerëzve të devotshëm dhe përmend ajetin kuranor:

“Kur takohen me besimtarët, ata thonë: ‘Besojmë’ – por, kur mbesin vetëm me djajtë e tyre, thonë: ‘Në të vërtetë, ne jemi me ju; ne vetëm po tallehim.’”¹¹

Rumi pastaj shtron pyetjen: “Nëse dhe një hipokrit përfiton nga qëndrimi me njerëz të devotshëm, atëherë, sa mund të përfitojë besimtari kur qëndron me besimtarin?”¹²

Transmetohet se Lukmani i tha të birit:

“Gjëja e parë, për të cilën do të ta tërheq vëmendjen është nefsi. Çdo nefsi përmban ambicjet dhe epshet. Nëse ju përmbushni ambicjet e nefsit, atëherë ai do të kërkojë përmbushjen e ambicjeve të tjera. Ambicja është e fshehur në zemër si zjarri që fshihet në gur (vullkanik). Nëse çahet guri, zjarri ekspozohet. Nëse lihet siç është, zjarri do të mbetet i fshehur.”¹³

Një nga problemet, me të cilin njerëzit ballafaqohen shpeshherë, është edhe caktimi i një dite në të ardhmen, në të cilën personi vendos të heqë dorë nga një mëkat. E vërteta është se askush nuk mund të garantojë të ardhmen, e cila është pjesë e dijës së Zotit. Duke pasur

9. Nas, 1.

10. Xhelal el-Din Rumi: *Kitab Fīhi mā fīhi*, përkthyer nga persishtja në arabisht nga Isa Ali el-Akub, Dar el-Fikr el-Muasir, Bejrut, 2001, fq. 334.

11. Bekare, 14.

12. Rumi: *Kitab Fīhi mā fīhi*, fq. 316.

13. Ebu Hamid Gazali: *Mukashafat el-Kulub*, përkthyer nga arabishtja në anglisht nga Muhammad Muhammady Dar el-Kutub el-Ilmijeh, Bejrut, 2009, fq. 395.

parasysh këtë, ne duhet ta korrigojmë menjëherë veten tonë. Ndonjëherë ndodh që të presim të tjerët të na ndryshojnë. Kjo, jo vetëm që tregon dobësinë tonë, por dhe një kuptim të gabuar në lidhje me trajtimin e nefsit. Zoti i Plotfuqishëm thotë në Kuran: **"..Me të vërtetë, Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë ç'ka kanë në vetvete..."**¹⁴

Dijetari dhe mistiku i famshëm ^cAbdulkādir Gejlānī (v.h. 561, 1166), thotë në librin e tij *Xhilā' el-Khāṭir*: "Nëse një person nuk vepron si predikues për nefsën e tij të ulët, këshilla e asnjë predikuesi nuk do t'i bëjë dobi atij."¹⁵ Gejlānī gjithashtu thekson: "Përmbushjet e dëshirave të shumta e dehin nefsën. Dhe sa keq do të ishte, nëse njeriu i përmbush ambicjet e nefsit përmes rrugëve të ndaluara?"¹⁶

Ambicjet në këtë botë, u ngjajnë iluzioneve tërheqëse nga jashtë, bosh nga brenda. Kurani përmend në detaje bisedën e zhvilluar midis Profetit Nuh (a.s.) dhe djalit të tij, para se të ndodhte përmbytja: **"...Nuhu thërriste birin e vet, i cili ishte ndarë veç: 'O biri im, hip me ne e mos u bëj me mohuesit!' (I biri) tha: 'Unë do të strehohem në një mal, i cili do të më ruajë nga uji'. Nuhu iu përgjigj: 'Sot askush nuk do të kursehet nga dënimi i Allahut, përveç atij që e mëshiron Ai! Një valë në mes tyre i ndau dhe ai u fundos.'"**¹⁷

Gejlānī, duke komentuar këto ajete, përmend se mali u ngjason ambicjeve të mëdha dhe egoizmit të babëzitur në këtë botë.¹⁸ Njerëzit në këtë botë mbështeten më së shumti në malet materialiste-iluzore, që ndërtojnë dhe harrojnë të mbështeten në Krijuesin Suprem të qiejve dhe të tokës. Ndërsa varka e Nuhut (a.s.), është litari i Zotit, litari i shpëtimit.

Transmetohet se shoku i Profetit, Xhabiri (r.a.), tha: "Profeti (a.s.), u kthye nga një prej betejave të tij dhe na tha: "Ju keni ardhur me një përfundim të shkëlqyer. Keni ardhur nga xhihadi i vogël¹⁹ te xhihadi i madh (përpjekja e një adhuruesi kundër ambicjeve të tij)."²⁰

14. Ra'd, 11.

15. Abd el-Kadir Xhejlani: *Xhila el-Khatir*, përkthyer nga arabishtja në anglisht nga Shetha al-Dargazelli dhe Louay Fatoohi, Kuala Lumpur, 1999, fq. 53.

16. Ibid.

17. Hud, 2-3.

18. Abd el-Kadir Xhejlani: *Xhila el-Khatir*, fq. 55.

19. Lufta.

20. Ahmed el-Bejhakij: *Kitabel-Zuhdel-Kebir*, Dar el-Xhinan, Bejrut, 1987, fq. 165.

NDJEKJA E VEPRIMEVE

Në librin e tij të famshëm *Ihja'ulūm el-Dīn*, Ebū Hāmid Gazālī (v. h. 504, 1111), përmend tri lloje veprash që lidhen me *murāqabah*: Së pari, veprimet e virtytshme. Aplikimi i *murāqabah* në këto vepra do të thotë kryerja e tyre me sinqeritet dhe ruajtja e tyre ndaj mangësive. Së dyti, veprimet që konsiderohen të lejueshme. Aplikimi i *murāqabah* në këto vepra do të thotë ruajtja e kufirit në veprimin e tyre dhe të qenit mirënjohës (ndaj Zotit) për dërgimin e tyre. Së treti, veprimet që konsiderohen mëkate. Aplikimi i *murāqabah* në këto vepra do të thotë të pendohesh dhe t'i ekzaminosh ato.²¹

DËNIMI

Dijetarët mistikë e theksojnë shumë ndëshkimin e nefsit. Megjithatë, kur ata sqarojnë metodat e ndëshkimit, nuk kanë për qëllim abuzimin fizik të trupit, por ndalimin e epsheve, duke mos i plotësuar ambicjet. Përndryshe, abuzimi me trupin është i ndaluar, sipas Islamit. Sidoqoftë, ka dhe disa transmetime të dijetarëve mistikë, ku ndëshkimi fizik individual i limituar është praktikuar nga njerëz të një disipline të veçantë në përmirësimin e nefsit të tyre. Ndoshta ata shembuj janë cituar në librat e tyre për të treguar se sa larg dhe sa seriozisht kanë shkuar njerëzit për përmirësimin e nefsit të vet. Shembuj të shumtë, të përmendur nga Kushejriu, Gazaliu dhe të tjerët, të çojnë drejt metoda-ve konstruktive dhe shpërblyese nga praktika e *mu'ākabeh*.

Shumë njerëz të shenjtë zgjedhin për të ngrënë më pak dhe shpejt, në mënyrë që të kenë kontroll më të mirë ndaj nefsit të tyre. Të tjerët bëjnë gjumë më pak, në mënyrë që të kryejnë lutjet gjatë natës. Në përmbledhjen e haditheve të Buhariut dhe të të tjerëve ka shumë thënie të Profetit (a.s.), ku inkurajohet agjërimi, jo vetëm gjatë Ramazanit, por edhe gjatë ditëve të tjera brenda vitit. Objektivi është dobësimi i nefsit. Jahjā bin Muadhi përmend: "Nëse dikush mund ta blinte urinë në treg, atëherë kërkuesit e botës tjetër (besimtarët) nuk do të kishin nevojë të blinin gjë tjetër aty."²² Në të njëjtën mënyrë, Ebū Sulejmān el-Darānī është shprehur: "Çelësi i kësaj bote është mbushja e barkut, ndërsa çelësi i botës tjetër është uria."²³

21. Ebu Hāmid Ghazali: *Ihjaulūm el-Dīn*, përkthyer nga arabishtja në anglisht Fazl-ul Karim, Dar Isha-at, Karachi, 1993, v. 4. fq. 342.

22. Kushejri: *el-Qushayri's Epistle on Sufism*, fq. 80.

23. Ibid: fq. 81.



VRAPONI PA

Vrapimi drejt Kuranit është vrapim drejt Allahut, sepse Allahu në ajetin kuranor urdhëron: **“Prandaj, shpejtoni drejt Allahut, se unë në të vërtetë jam i dërguar te ju si paralajmërues i qartë!”** (Dharijat, 50), besimtarët të vrapojnë drejt Tij. Mjeti më i sigurt dhe këshilluesi më i qartë në marrëdhëniet tona me Allahun është Muhamedi (a.s.). Pozita e Kuranit është po aq e rëndësishme për besimtarët, sa edhe pozita e Pejgamberit (a.s.), sepse njohja e Allahut dhe e Profetit të Tij është e mundur vetëm përmes Kuranit. Është ai që na prezanton me Allahun dhe Pejgamberin (a.s.). Niveli i komunikimit të njerëzve me Allahun është në raport të drejtë me nivelin e kuptimit të Kuranit dhe fjalës profetike.

Kurani është çelësi i adhurimit dhe udhërrëfyesi i pagabueshëm drejt lumturisë së amëshuar. Ai që e lexon Atë, flet me Allahun. Prandaj, rendja drejt Kuranit është rendje drejt Allahut. Muhamedi (a.s.), përmes hadithit **“Nëse dëshironi të flisni me Allahun, atëherë lexoni Kurandin”,** e ka konsideruar leximin e Kuranit komunikim me Allahun.

Kurani dhe Hadithi i Profetit (a.s.), siç është recetë shpëtimi në rrafshin individual, është edhe formulë shpëtimi në planin familjar dhe shoqëror. Leximi i Kuranit është një ibadet. Kuptimi dhe zbatimi i Tij në jetë është shprehje e qëndrimit në rrugën e drejtë, e cila të çon në destinacionin e duhur.

Një pyetje thelbësore, që i del besimtarit me afrimin e vdekjes, është se kujt do t’ia lërë trashëgim Kurandin

dhe sexhaden ku është falur. Prindërit përpiqen me gjithfarë mënyrash për t’u lënë trashëgimtarëve pasuri të bollshme materiale, por nuk mendojnë aspak për trashëgiminë shpirtërore të fëmijëve, megjithëse myslimani është përgjegjës t’i japë trashëgimtarit edukimin shpirtëror, në mënyrë që të plotësojë vendin e tij në bashkësi.

Duke u nisur nga kjo, arrijmë në përfundimin se prindërit kundrejt fëmijëve kanë një përgjegjësi të madhe, që në asnjë mënyrë nuk duhet anashkaluar. Kjo përgjegjësi i siguron prindit edukimin e fëmijës, por në të njëjtën kohë edhe një lëmshë të vazhdueshme pas vdekjes. Pejgamberi (a.s.), e shpreh kështu këtë: **“Kur vdes njeriu, regjistrimi i veprave të tij ndërpritet, përveç tri veprave: sadakasë së vazhdueshme, diturisë prej së cilës pëfitojnë njerëzit dhe pasardhësit e mirë që luten për të.”** (Muslimi, Uasijet, 14)

Prindërit, për të siguruar lëmshën e vazhdueshme, duhet t’u mësojnë fëmijëve lutjen, namazin dhe Kurandin. Zemrat e fëmijëve duhen ndriçuar me dritën e Kuranit dhe ushqyer me moralin e Pejgamberit (a.s.). Realizimi i kësaj arrihet përmes zbatimit të Kuranit në çdo nivel të jetës.

Bota shpirtërore dhe vetëbesimi janë më të mëdha tek një fëmijë që rritet në një mjedis ku lexohet Kurani, falet namazi dhe bëhen dua. Kësaj të vërtete i referohet Pejgamberi (a.s.), kur thotë: **“Kush e mëson Kurandin në moshë të vogël ai mëshirohet në çdo pjesë të qelizës së tij.”** (Ali el-Muttaki, I 532)

AS KURANIT

Gjëja më e mirë që mund të bëjnë fëmijët pas vdekjes së prindërve, është lutja dhe Kurani. Prandaj prindërit duhet t'i edukojnë fëmijët me frymën e Kuranit dhe të thurin në zemrat e tyre dashurinë për leximin e Tij. Për prindërit që i edukojnë fëmijët me këtë frymë, nuk ka lajm më të mirë se hadithi "Kush lexon Kuran dhe vepron sipas tij, prindërve të tij i vendoset një kurorë. Drita e kësaj kurore është më e bukur se drita e diellit që bie mbi një shtëpi. Mendoni se si është drita e atij që e zbaton vetë Kuranin!" (Ebu Davud, Vitër, 14)

Një ndër gëzimet më të mëdha të njeriut në këtë botë është suksesi i fëmijëve. Por më e rëndësishme është që të lëmë pas një fëmijë me edukatë shembullore, në mënyrë që çdo sjellje e mirë e tij të na shërbejë si një sadaka e vazhdueshme. Pa dritën e Kuranit, fëmijët e kanë tepër të vështirë të dallojnë të vërtetën nga gënjeshttra. Vetëm përmes dritës së Kuranit bëhet i mundur dallimi i së vërtetës prej gënjeshtres.

Prindërit sot zgjedhin shkollën më të mirë për fëmijët për t'u mësuar atyre një profesion dhe gjuhë të huaj dhe për këtë nuk druhen nga asnjë lloj shpenzimi. Nuk ka dyshim që mësimi i gjuhës së huaj është i rëndësishëm. Por interesi vetëm për gjuhë të huaj, duke lënë pas dore mësimin e Kuranit, është një veprim jo fort i mençur, sepse ky është një privim që i bëhet fëmijës nga fjala hyjnore dhe nga drita që lëshon ajo në zemrën e tyre.

Fëmijët që rriten larg shpirtit dhe edukimit kuranor nuk janë në gjendje të vlerësojnë siç duhet veten, një-rëzit dhe gjithë mjedisin përreth. Familja e besimtarit

nuk duhet të qëndrojë për asnjë çast larg Kuranit dhe atmosferës shpirtërore që krijon Ai. Pejgamberi (a.s.), i porosit besimtarët që të mos i shndërrojnë shtëpitë në varre. Nëse zemrat e njerëzve privohen nga Kurani, atëherë shtëpitë e tyre janë shndërruar në varreza. Shprehja e Pejgamberit (a.s.) e thotë qartë se zemra që nuk përmban sadopak Kuran është si një shtëpi e rrënuar. Prandaj, duhet që fëmijët të mos i privojmë nga Kurani, por të qëndrisim në zemrat e tyre fjalën hyjnore. Zemra e mbushur me fjalën e Allahut është një saraj i mbushur me dritën e mesazhit hyjnor. Edukimi dhe arsimimi përmes Kuranit fillon me reflektimin dhe meditimin mbi mesazhin e Tij. Përpara se t'u mësojmë fëmijëve Kuranin, duhet t'i mësojmë dhe ndërgjegjësojmë për burimin dhe rëndësinë e këtij libri. Leximi sipërfaqësor i Kuranit pa reflektim dhe meditim, sipas Pejgamberit (a.s.), nuk e kalon fytnin e njeriut. Pra, nga një lexim i tillë, zemra nuk ka asnjë dobi.

Institucionet fetare duhet të inkurajojnë hapjen e kurseve të Kuranit për edukimin dhe arsimimin e pasardhësve me fjalën e Allahut. Leximi dhe reflektimi mbi Kuranin në ditët tona, ku bota gjithnjë e më shumë po egërsohet, fiton një vlerë krejt tjetër. Prandaj, duhet t'i prezantojmë fëmijët me Kuranin që në moshë të hershme, sepse Kurani është një libër hyjnor, që përfshin të gjitha aspektet e jetës së njeriut.

Përqaftimi i urdhrat hyjnor "**Vraponi tek Allahu**", fillon me vrapimin për të lexuar dhe kuptuar Kuranin. Prandaj për të vrapuar tek Allahu, shpejtoni te Kurani.

Dhimbjet e Habbabit dhe mesazhi universal



Adem Saraç

Pasi u nderua me Islam, Habbab bin Ereti, radijallahu anhu, filloi një jetë të re. Ai punonte si farkëtar në Mekë. Pasi u dëgjua se është bërë mysliman, i bënë tortura shumë të tmerrshme. Një ditë, pas një torture të rëndë Hz. Habbabit i ra të fikët dhe erdhi në vete vetëm pas një kohe të gjatë. Çdo anë e trupit të tij ishte djegur tmerrësisht.

Si të gjithë sahabët e tjerë edhe Habbabi, (r.a.), përpëlitej prej mallit që ndjente ndaj të Dërguarit të Allahut, alejhi's-salam, nëse nuk e shikonte qoftë edhe një ditë, sepse e donte atë shumë. Vetëm me dashurinë që kishte ndaj Pejgamberit (a.s.), ai po rezistonte kundrejt gjithë këtyre torturave dhe vuajtjeve. Kur e shikonte të Dërguarin e Allahut, (a.s.), i pushonin të gjitha dhimbjet.

Filloi të ecte sikur zvarritej, duke përdorur të gjithë fuqinë. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ishte pranë Qabes. Kur Habbabi, radijallahu anhu, e pa, ndjeu sikur iu lehtësuan dhimbjet, edhe pse ishte larg. Kur iu afrua pranë, e përqafoi dhe mezi e mbajti veten nga të qarët:

"Nëna, babai, jeta, gjaku dhe çdo gjë e imja të qofshin falë, o i Dërguari i Allahut! Nëse nuk të shikoj qoftë edhe një ditë, më vjen të vdes. Por çfarë të bëj, po më torturojnë dhe po më bëjnë të vuaj aq shumë, saqë s'po mundem të vij pranë jush. Nganjëherë nuk mund të vij, sepse më burgosin."

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e pa këtë sahab që sakrifikonte për besimin dhe kundrejt këtij durimi të madh


buzëqeshi me një bukuri që e linte diellin në hije. Habbabi, (r.a.), e flijonte çdo gjë për këtë buzëqeshje. Atij filloi t'i vinte shpirti përsëri në vend. Duke marrë guxim nga kjo buzëqeshje e të Dërguarit të Allahut, (a.s.) dhe prej sahabëve që gjendeshin aty në atë moment ai parashitroi një kërkesë:

"Nëna, babai, jeta, gjaku dhe çdo gjë e imja të qofshin falë, o i Dërguari i Allahut! Siç e shikon, më kanë djegur në çdo anë. Nuk po ankojem, por po të kërkoj të lutesh për mua, në mënyrë që të shërohem. A nuk do t'i lutesh Allahut të shpëtojme nga këto tortura dhe vuajtje të padurueshme që po heqim? A nuk mund t'i lutesh Allahut dhe t'i kërkosht ndihmë për ne, o i Dërguari i Allahut?"

I Dërguari i Allahut, (a.s.), u mërzit shumë. Habbabit, (a.s.) dhe atyre që gjendeshin aty, u tha:

"Në umetet e tjera para jush kishte njerëz të cilët përjetuan vuajtje që nuk i ka hequr askush. Atyre ua ripnin lëkurën dhe mishin me krehër prej hekuri, por kjo torturë nuk i bëri dot të ktheheshin prej fesë së tyre. Pastaj e kapnin njërin, hapnin një gropë, e futnin në të dhe ai ndahej në dysh me sharrë duke filluar nga koka, por përsëri këto vuajtje nuk i kthyen dot ata nga feja e tyre. Me të vërtetë, Allahu Teala do ta plotësojë këtë fe dhe do ta përsosë Islam, saqë dikush do t'i hipë kafshës së tij dhe do të niset i vetëm nga Sana për në Hadrameut dhe nuk do të ketë frikë asgjë përveç Allahut. Ai nuk do të ketë frikë për delet e tij, përveçse mos i sulmon ndonjë ujk... por ju nxitoheni!"

Pas këtij qortimi dhe sihariqi për të ardhmen, i Dërguari i Allahut, (a.s.), e preku lehtë kraharorin dhe shpinën e bekuar të Habbabit (r.a.) dhe u lut për shërimin e tij. Sapo Habbabin e prekën duart e bekuara të sulltanit



DEMOKRACIA OLIGARKIKE

Nuredin Nazarko

të peygamberëve, nuk kishte më dhimbje dhe rrjedhje të plagëve, edhe pse kishte aq shumë plagë.

Me këtë shembull mahnitës, që dha i Dërguari i Allahu, (a.s.), Habbabi dhe shokët e tij, radijallahu anhuma, i harruan vuajtjet dhe plagët e tyre kundrejt torturave dhe vuajtjeve të padurueshme që patën hequr popujt e mëparshëm. Në të njëjtën kohë, u gëzuan edhe për sihariqin që dha Pejgamberi (a.s.). Domethënë, Allahu Teala do ta plotësonte fenë e Tij dhe Islami do të përhapej në çdo anë. Habbabi, (r.a.), edhe pse kishte kaq shumë plagë, tha i entuziazmuar:

-Nëna, babai, jeta, gjaku dhe çdo gjë e imja të qofshin falë, o i Dërguari i Allahu! Përderisa ti të jesh me ne, do të durojmë çdo lloj torture dhe vuajtjeje.

I Dërguari i Allahu, (a.s.), u gëzua shumë për Habbabin, që nuk e kishte humbur aspak shpresën edhe pse gjendjen e kishte kaq të vështirë. Pastaj ngriti duart lart dhe u lut:

"O Zot! Ndhimjoje dhe shëroje Habbabin!"

-Nëna, babai, jeta, gjaku dhe çdo gjë e imja të qofshin falë, o i Dërguari i Allahu! Tashmë asgjë nuk mund të më dëmtojë mua!


Habbabi, (r.a.), u kthye në punën e tij me një shpirt dhe gjallëri të re. Ai nuk u dorëzua kundrejt këtyre torturave e vuajtjeve dhe nënshtrimi ndaj Allahu dhe të Dërguarit të Tij u shtua më shumë.

Vallë, a po ngutemi ne? A nuk është universal mesazhi që ka dhënë i Dërguari i Allahu, (a.s.)?

Në Librin e tij *Republika*, Platoni ka shtjelluar sesi një formë qeverisjeje gjeneron nga një formë e mëparshme qeverisjeje, deri sa mbërrin te tirania si forma më e egër e qeverisjes. Ndër format e qeverisjes që shtjellon, janë edhe oligarkia me demokracinë, ku kjo e fundit rrjedh nga shturja e oligarkisë. Pavarësisht rrjedhjes kronologjike nga një sistem në një sistem tjetër qeverisjeje, format hibride nuk janë të përjashtuara nga praktikatat qeverisëse. Por çfarë është oligarkia? Sipas përcaktimit platonian, oligarkia "është forma e regjimit që bazohet mbi censin, ku komandojnë të pasurit, ndërsa të varfrit nuk kanë pjesë në qeverisjen e vendit". (Republika: 319-320). Por me vendosjen e sistemit demokratik të krijohet përshtypja se përmes procesit të votimit askush nuk është i përjashtuar nga vendimarrja se kush do të jetë qeverisësi. Megjithatë edhe në sistemin demokratik, roli i censit është i padiskutueshëm, kur vjen çështja për të zgjedhur ata që do të qeverisin popullin. Problematika nuk qëndron te pasuria, por te fakti që censi përjashton apo pamundëson nga përfshirja në qeverisje apo poste shtetërore ata të cilët klasifikohen si shtresë e ulët vetëm e vetëm nga sasia e pasurisë që zotërojnë dhe jo nga vlerat që kanë, pasi tek këto të fundit mund të jenë më sipëranë sesa ata të cilët legjitimohen në qeverisje për shkak të censit, qoftë edhe kur censi nuk është i shprehur si *conditio sine qua non* për përfshirje në sferën e qeverisësve. Në sistemin e qeverisjes oligarkike krijohen detyrimisht dy klasa shoqërore që qëndrojnë përkundrazi njëra – tjetrës, të pasurit nga njëra anë dhe të varfrit nga ana tjetër, duke thëlluar në mënyrë të vazhdueshme këtë hendek, pasi në sajë të pasurisë që zotërojnë dhe dëshirës për t'u pasuruar gjithnjë e më tepër si shenjë e fuqishmërisë dhe pushtetit, të pasurit blejnë pasuritë e atyre të cilët nuk kujdesen për trashëgiminë e tyre ose në raste të caktuara mund të përdorin edhe artifica të nduarduarshme për arritjen e qëllimeve të tyre. Duke kaluar në sistemin demokratik, aq më tepër kur dalim nga një sistem i egër dhe tiranik, dhe jo më nga një sistem oligarkik sipas rendit platonian, na duket sikur të gjithë kanë shanse dhe mundësi të barabarta për t'u bërë të pasur. Por ngjarjet rrokullisen, jo më sipas rendit kronologjik platonian në ndryshimin e sistemeve të qeverisjes. Dalëngadalë krijohen forma hibride qeverisjeje, të cilat ngërthejnë në vetvete tipare të oligarkisë, demokracisë dhe tiranisë. Duke kaluar nga tirania në demokraci, dalëngadalë një shtresë e caktuar, në sajë të pushtetit, vjen e bëhet zotëruese e pasurisë në masë të konsiderueshme, ndërkohë që populli i dehur nga liria demokratike me tepri vetëkënaqet me faktin që "unë jam sovran!", pasiqë mjafton që të deklarohesh si mik i popullit, që të jesh i mirëpranuar prej tij si udhëheqës. Kjo shtresë pasanikësh rishtarë, duke përdorur modelin demokratik të qeverisjes, dominon në të gjitha sferat e jetës shoqërore, duke përdorur artifica nga më të ndryshmet, për ndërhyrje në institucionet që duhet të jenë përgjegjëse dhe kompetente për mbarevajtjen e punëve të shtetit, duke mos lejuar implementimin e fun-

ksionimit normal të tyre, sipas parimit të drejtësisë dhe meritokracisë. Dhe nuk ka sesi të ndodhë ndryshe, sepse atje ku humbasin virtytet dhe nënçmohen të virtytshmit, do të nderohen pasuria dhe të pasurit. Problemi nuk është as me pasurinë dhe as me të pasurit, por me qëllimin për të cilin përdoret fuqia dhe pushteti që burojnë nga zotërimi i pasurisë, duke shkaktuar kështu një shtet jo të qeverisur mirë, pasi që në një shtet të qeverisur mirë “do të pranojnë të qeverisin ata që janë të pasur, jo me flori, por me virtyte dhe me urtësi, pasuritë e nevojshme për lumturinë. Po atje, ku çapaçulët dhe njerëzit e babëzitur për pasuri vetjake vijjnë në krye të punëve publike, të bindur se aty mund të zhvatin sa të duan, nuk është e mundur të kemi një qeverisje të mirë, mbasi ata luftojnë midis tyre kush e kush të marrë frenat në dorë dhe kjo luftë e brendshme bën që të humbasin ata vetë dhe gjithë Shteti. (Republika: 279). Në këtë mënyrë, në sajë të përdorimit të fuqisë dhe pushtetit që buron nga zotërimi i pasurisë, që shpeshherë përftohet nga mjelja e punëve botore, dalëngadalë krijohet brenda sistemit demokratik një shtresë oligarkësh, të cilët herët ose vonë, me ose pahir do t’i imponojnë popullit zgjidhjet e tyre, të cilat gjithëherë peshojnë në kahun e interesit të të pasurve rishtarë, pavarësisht se deklarativisht shfaqen si miq të popullit dhe të zgjedhur nga sovran popull për ta qeverisur në përputhje me “interesat” e këtij të fundit. Kjo lloj qeverisjeje hibride do të formësojë dy palë, “fituesit” dhe fituesit. Fituesit janë të ricikluarit në vazhdimësi përbrenda qarkut të mbyllur të pushtetit, dhe “fituesit” janë ata që ngrejnë doli për fitoret e fituesve. Kjo lloj qeverisjeje nuk do të themeliset mbi bazën e miqësisë dhe solidaritetit, por mbi bazën e shfrytëzimit dhe urrejtjes, përderisa ata që drejtojnë dhe udhëheqin nuk mendojnë dhe punojnë për qeverisjen me drejtësi dhe meritokraci. Duke mos pasur si busull qeverisjen meritokratike, urrejtja, zilia, armiqësia, pabesia, dhe makinacionet bëhen bashkudhëtarë të pandarë në raportet midis klasës që drejton dhe klasës që drejtohet.

Ata që kanë shumë pasuri, forcë, fat, miq e të tjera si këto, nuk janë as të gatshëm as të aftë për t’iu nënshtruar autoritetit. E keqja nis nga shtëpia; pasi kur janë djem (*por edhe vajza, N.N.*), për shkak të luksit, në të cilin rriten, ata nuk e mësojnë kurrë madje as në shkollë, zakonet e bindjes. Kështu që njëra klasë nuk mund të bindet, por mundet vetëm të sundojë në mënyrë despotike; tjetra nuk di të udhëheqë dhe duhet të sundohet si skllave. Kështu ngrihet një qytet, jo me njerëz të lirë, por me zotër dhe skllavër, njëra palë që përçmon dhe tjetra që ka zili; dhe asgjë nuk mund të jetë më fatale për miqësinë dhe shoqërinë e mirë në shtete sesa kjo, pasi vëllazëria e mirë buron nga miqësia; kur njerëzit janë në armiqësi me njëri – tjetrin, ata nuk do të donin të ndanin as të njëjtën rrugë. (Aristoteli, Politika:111)



Karakteristikë e të gjithë ibadeteve është kujtimi dhe përmendja e Allahut. Si pasojë e përmendjes ndodh afria. Nga ky këndvështrim, namazi është përmendje, agjërimi është përmendje, Haxhi dhe Zekati po ashtu është një lloj përmendjeje dhe kujtimi.

Një ibadet që nuk përmban dhikrin nuk konsiderohet ibadet, por një veprim i shkuar kot. Lëmosha që bëhet për t'u dukur, namazi që falet pa ndjeshmëri dhe agjërimi që nuk ka përmbajtje, konsiderohet si një vepër pa dobi.

Vazhdimësia e përmendjes së Allahut nuk realizohet vetëm përmes ibadeteve, por edhe përmes shprehjes dhe reflektimit mbi cilësitë e bukura të Allahut. Ashtu si çdo krijesë në gjithësi, që e lëvdon dhe madhëron Allahun me gjuhën e vet edhe njeriu duhet ta përmendë vazhdimisht Allahun me gjuhë dhe me zemër, në shenjë nderimi dhe bindjeje ndaj Tij.

Pika kulmore e besimtarit të përsosur është kur dhikri shfaqet në çdo qelizë të trupit të tij. Niveli i besimit është i lidhur ngushtë me gjendjen shpirtërore. Qëndrimi në vetmi me Allahun e mbush zemrën me qetësi dhe prehje. Prandaj, qetësia e vërtetë është e lidhur me vazhdimësinë e dhikrit.

Kurani thekson faktin se ibadeti i dhikrit është gjithëpërfshirës. Disa nga ajetet kuranore që flasin për këtë temë janë:

“Lexo (o Muhamed) atë që të është zbritur ty prej Librit (Kuranit) dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe! Allahu di gjithçka që ju bëni.” (Ankebut, 45)

“Prandaj, më kujtoni Mua (me namaz e lutje) që Unë t’ju kujtoj (me shpërblime) dhe falënderomëni Mua (duke M’u bindur) e mos i mohoni dhuntitë e Mia (me mosbindje)!” (Bekare, 152)

“Qëndro larg atij që lë pas dore përmendjen Tonë dhe dëshiron vetëm këtë botë” (Nexhm,29)

Përmende Zotin tënd me vete, i përlulur dhe me frikë - jo me zë të lartë, në mëngjes dhe mbrëmje dhe mos u bëj nga ata që nuk i kushtojnë vëmendje! (Araf, 205)

“... Mos reshtni së përmenduri Mua.” (Taha,42)

Kushdo që i kthen shpinën përmendjes Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër. (Taha, 124)

“Mos dëgjo atë, zemrën e të cilit ia kemi lënë mos-përfilljëse ndaj përmendjes Sonë e që shkon pas dëshirave të veta, duke shkelur çdo kufi në veprimet e tij.” (Kehf, 28)

“...ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, qetësohen. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!” (Rrad, 28)

“Dhe, kur të përfundojë namazi, atëherë shpërndahuni nëpër tokë, kërkoni nga mirësitë e Allahut dhe përmendeni shumë Allahun, në mënyrë që të shpëtoni.” (Xhuma, 10)

“O besimtarë, përmendeni shpesh Allahun dhe lavdërojeni Atë në mëngjes dhe në mbrëmje!” (Ah-zab, 41-42)

“Pasi të kryeni namazin, përmendeni Allahun duke qëndruar në këmbë, ulur dhe të shtrirë. Kur të jeni jashtë rrezikut, atëherë faleni namazin të plotë, sepse namazi është detyrë për besimtarët në kohë të caktuar” (Nisa,103)

“O besimtarë, mos lejoni që pasuria dhe fëmijët tuaj t’ju largojnë nga të përmendurit e Allahut. Ata që e bëjnë këtë, do të humbin.” (Munafikun, 9)

Ajo që kuptojmë nga ajetet e mësipërme, është fakti se njeriu në çfarëdo lloj situatë dhe gjendjeje nuk duhet ta anashkalojë dhikrin. Asnjë gjë nga kjo botë nuk duhet ta pengojë nga përmendja e Allahut. Nuk mund të ketë justifikim për mospërmendjen e Allahut.

Ibadeti dhe dhikri e afrojnë njeriun tek Allahu dhe i japin siguri dhe mbrojtje. Mbi zemrën e besimtarit që adhuron dhe përmend Allahun zbrit qetësia hyjnore. Pejgamberi (a.s.), ndikimin e dhikrit mbi besimtarët e shpreh kështu: **“Kur një grup besimtarësh mblidhen së bashku për të përmendur Allahun, rreth tyre mblidhen engjëjt, mbi ta zbrit qetësia dhe mëshira dhe Allahu i përmend në prani të engjëjve.”** (Muslimi, Dhikër, 25,30, nr, 2689,2700)

Besimtari ndjen mbrojtjen e Allahut, për aq kohë sa vazhdon përmendjen e Tij. Kjo gjendje bëhet shkak për lumturinë dhe qetësinë e njeriut, si në këtë botë edhe në tjetrën. Dhikri është ilaç për problemet, shqetësimet dhe rreziqet e ndryshme që i ofron jeta njeriut. Nuk duhet harruar asnjëherë që zemrat qetësohen vetëm përmes dhikrit.



Ata që e shitën Botën tjetër PËRKËTË BOTË

Alli Riza Temel

Xhebel b. Ejhem u përkiste bijve të Xhefnes prej Gassanitëve dhe ishte prej fisit Ezd të Jemenit. Për rrjedhojë, ishte i afërm i fiseve Eus dhe Hazrexh në Medine.

Poeti i Pejgamberit tonë (a.s.), Hasan b. Thabit, në kohën para Islamit shkonte shpesh në Siri dhe e vizitonte Xhebelin, me ç'rast recitonte edhe poezi ku i thurte lavde atij dhe Bijve të Xhefnes, duke marrë prej tyre dhurata të ndryshme.

Xhebel ishte mbreti i asaj zone. Sipas burimeve¹, Xhebel deshi të bëhej mysliman dhe me anë të një letre i çoi lajm Omerit (r.a.), ku i kërkonte leje për të ardhur në Medine. Omeri (r.a.) dhe myslimanët e tjerë u gëzuan jashtë mase nga ky lajm. Prandaj dhe Omeri (r.a.), si përgjigje i dërgoi një letër ku e ftonte të vinte në Medine dhe i tregonte se do të fitonte të gjitha të drejtat dhe detyrat që i përkisnin një myslimani.

Xhebel doli për udhë së bashku me pesëqind kalorës prej fisit Akka dhe Xhefne. Kur iu afruan Medines, i veshi njerëzit e vet me rroba të qendisura dhe të punuara me flori e argjend, ndërsa vetë vuri një kurorë në të cilën kishte vendosur edhe një vëth që i kishte ngelur trashëgim prej gjyshes së vet. Në hyrje të Medines kishin dalë të gjithë, burra, gra, fëmijë e pleq. Ata ishin shumë të gëzuar që Xhebeli po vinte në Medine dhe do të bëhej mysliman.

Atë vit, në periudhën e haxhit edhe Xhebel shkoi për haxh së bashku me Omerin (r.a.). Gjatë tavaftit, njëri prej bijve të Fezares, padashje i shkeli ihramin (rrobën e haxhit), i cili u zgjidh. Xhebeli i nxehur jashtë mase, u kthye dhe e gjuajti me një grusht duke ia thyer hundën. Njeriu i gjerë shkoi dhe u ankua tek Omeri (r.a.), i cili më

pas e thirri Xhebelin dhe e pyeti për shkakun. Xhebeli iu përgjigj se ai ia kishte shkelur dhe përdhosur ihramin e, po të mos ishte për respekt të Qabes, do t'ia nxirrte edhe sytë. Omeri (r.a.) i tha: "Ti e pranove fajin. Tani ose do t'i kërkosh falje dhe ta kënaqësh atë njeri, ose do të përdor "kisinin" (ndëshkimin me të njëjtën mënyrë) mbi ty." "A po më barazon mua, që jam mbret, me një njeri të thjeshtë?" - tha Xhebeli. Omeri (r.a.), iu përgjigj: "O Xhebel! Është Islami që ju bëri të barabartë me njëritjetrin. Ti nuk mund të jesh më superior se ai, përveçse me devotshmëri." "Unë pata menduar se me të hyrë në Islam, do të bëhesha më i lartë dhe më i respektueshëm se më parë, tha Xhebeli." "Lëri këto, sepse çështja është siç të thashë unë," - i tha Omeri (r.a.). "Atëherë unë po kthehem përsëri në krishtërim," - tha Xhebeli. "Atëherë edhe unë ta heq kokën," - tha Omeri (r.a.)

Ndërmjet njerëzve të Xhebelit dhe të të afërmeve të njeriut që iu thye hunda, për pak desh filloi një konflikt. Për këtë arsye, Xhebeli kërkoi leje prej Omerit (r.a.), me qëllim që të mendohej deri të nesërmen. Omeri (r.a.), i dha leje, por Xhebeli së bashku me njerëzit e tij iku fshehurazi sapo ra nata. Ai arriti të largohej dhe frymën e mbajti drejt e në Kostandinopojë (Stamboll), ku u bë i krishterë dhe hyri nën mbrojtjen e Herakliut, mbretit të atëhershëm të Bizantit. Herakliut iu bë shumë qejfi nga kjo ngjarje. Prandaj i dhuroi Xhebelit shumë pasuri e tokë.

Omeri (r.a.), dërgoi Xhusame b. Musahik el-Kinanim si përfaqësues tek Herakliu për ta ftuar atë në Islam. Herakliu u propozoi marrëveshje paqeje, pa e pranuar Islamin. Ndërkohë që po i shkruante këtë përgjigje Omerit (r.a.), Herakliu pyeti të dërguarin e Omerit (r.a.): "A u takove me Xhebelin që u kthye në fenë tonë?" "Jo, nuk u takova," - tha i dërguari. Herakliu i tha të takohet dhe letrën e përgjigjes do t'ia jepte në fund të takimit.

I dërguari, arriti te dera e Xhebelit, ku pa se hyrja e shtëpisë së tij ishte e mbushur me roje, shërbyes dhe plot njerëz të tjerë si në pallatin mbretëror të Herak-

1. Ibën Abdurabbih, el-lkdu'l-Ferid. 2/44-48. Bejrut

liut. I dërguari tha: "Pas shumë kërkesash, m'u dha leje të hyja brenda. Kur hyra, pashë një njeri me mjekër të verdhë. Në fakt, ky njeri më parë ka qenë esmer, me flokë dhe mjekër të zezë. E pashë me çudi dhe kuptova se mjekra e tij ishte bërë e verdhë, për shkak se e spërkaste me ujë floriri.

Ky njeri qëndronte i ulur mbi një kolltuk kristali me këmbë të florinjta e të gdhendura në formë luani. Kur më njohu, më uli pranë vetes. Më pyeti për gjendjen e myslimanëve dhe unë iu përgjigja, duke i thënë se janë mirë dhe çdo ditë forcohen edhe më tepër. Pastaj më pyeti për Omerin (r.a.) dhe, kur i thashë se edhe ai është mirë, vura re se në fytyrën e tij u shfaq mërzia.

Unë zbrita nga kolltuku me këmbë të florinjta, kurse ai më pyeti, se përse e refuzova qerasjen dhe zbrita nga kolltuku. Kur i thashë se Resulullahu (a.s.), e ka ndaluar këtë gjë, ai tha: "Ti mbaje zemrën të pastër dhe mos shiko se ku ulesh! Duke marrë shkas nga këto fjalë, i thashë: "Turp të kesh, o Xhebel! Përse nuk bëhesh mysliman, pasi e mësove Islamin dhe superioritetin e tij?" "Pas gjithë atyre që ndodhën?" - tha Xhebeli. "Po, i thashë unë. Njëri prej Fezarinjve veproi shumë më keq se ti. U largua prej Islamit dhe u nxori shpatën myslimanëve. Pastaj hyri përsëri në Islam dhe u pranua: 'Më lër rehat', - tha Xhebeli. Por nëse Omeri më jep vajzën e tij për grua dhe më garanton se do të ma lërë mua udhëheqjen pas tij, bëhem përsëri mysliman: 'Unë të garantoj, se ai ta jep vajzën për grua, por për udhëheqjen nuk të garantoj gjë', - i thashë unë."

I dërguari i Omerit (r.a.), tregon shumë detaje në lidhje me jetën luksoze të Xhebelit. Ai thotë, se shtroheshin sofrat prej floriri dhe argjendi dhe hahej me pjata të florinjta dhe të argjendta, mirëpo vetë qëndronte larg tyre. Kur na tregon për jetën e tij luksoze, shprehet: "Xhebeli u bënte me shenjë shërbyesve dhe ata menjëherë i sillnin ndenjësë të zbukuruara me gurë të çmuar. Në të djathtë dhe në të majtë të tij qëndronin vajza me një bukuri të paparë. Në kokën e një robëreshë që ndrishte si diell, qëndronte një kurorë dhe mbi kurorë një zog. Në njërin dorë të robëreshës kishte një kuti kristali të mbushur me misk dhe amber, ndërsa në dorën tjetër, një kuti kristali mbushur me ujë trëndafil.

Robëresha i bënte me shenjë zogut dhe zogu duke rrahur krahët prekte miskun dhe ujin e trëndafil. Pastaj me një shenjë tjetër të robëreshës, zogu rrihte krahët mbi kryqin e kurorës në kokën e Xhebelit. Misku dhe uji i trëndafilit spërkatej mbi Xhebelin, ndërsa ai qeshte me të madhe nga gëzimi, sa që goja i shkonte te veshët. Aty recitonin edhe poezi. Përveç poezive të gëzueshme, recitonin edhe poezi melankolike. Falë kësaj jete përrallore, ai shijonte çdo gjë që mund të shijohej. Mirëpo, Xhebeli nuk ishte aspak i lumtur brenda kësaj jete përrallore. Kërkonte kënaqësinë me ngushëllime dhe zbukurime të rrejshme, por nuk mundi ta gjente

atë. Për shkak të mendjemadhësisë, nuk i kërkoi falje as personit të cilit ia theu hundën, por nuk pranoi as kisasin (ndëshkimin). Për këtë arsye, u privua nga burimi i vërtetë i lumturisë së përfjetshme, Islami. Shijet dhe bukuritë e përkohshme nuk e ngopën dhe nuk e kënaqën atë."

Transmetohet se ndarjen prej Islamit për shkak të mendjemadhësisë, e ka shprehur me një hidhërim të thellë duke thënë: "Prej turpit ndaj shuplakës, fisnikët u bënë të krishterë. Nëse do ta kisha duruar kisasin, nuk do të pësoja asnjë dëm. Mendjemadhësia dhe inati, më larguan prej Allahut. Shita syrin e shëndoshë dhe bleva syrin e vëngër. Ah sikur të isha çoban devesh në shkretëtirë. Të isha robi i Rebias dhe Mudarit. Ah, sikur të jetoja me krejt pak të ardhura në Siri, i verbër dhe i shurdhër midis popullit tim."

I dërguari i Omerit (r.a.), e vazhdon kështu tregimin e tij: "Xhebeli më pyeti për Hasan bin Thabitin në ishte gjallë apo kishte vdekur. 'Është gjallë', - i thashë unë. Më vonë më dha veshje, mall dhe grurë si dhuratë për të dhe më urdhëroi: 'Nëse e gjen gjallë, jepja atij duke i përcjellë edhe përshëndetjet e mia. Por, nëse ka vdekur, dhuratat jepja familjes së tij dhe te varri i tij të bëjë kurban një deve."

I dërguari u kthye tek Omeri (r.a.) dhe i tregoi gjithçka. Ndërsa dhuratat ia dorëzoi Hasan bin Thabitit. Më vonë, Omeri (r.a.), të njëjtin person e dërgoi përsëri në Kostandinopojë, me qëllim që ta njoftonte Xhebelin se të gjitha kushtet e tij pranoheshin vetëm nëse ai bëhej mysliman. Mirëpo, kur i dërguari arriti në Kostandinopojë, i gjeti njerëzit duke u kthyer nga varrimi i tij. Sa keq! Shkoi në botën tjetër pa u bërë mysliman. Mendjemadhësia dhe luksi i rremë ia kishin verbuar sytë Xhebelit. Froni, ari, xhevahiret, argjendi, parfumet, robëreshat dhe ushqimet e ndryshme ngelën pas. Ashtu siç është shprehur edhe në fjalët e tij të pendesës, "ah sikur të mos kaplohesha nga mendjemadhësia". Po të kishte pranuar kisasin, të kërkonte falje dhe të kënaqte të dëmtuarin, do të ishte fisnikëruar edhe më shumë. Në vend që të jetonte në mes të luksit në pallatin e mbretit, më mirë të qëndronte mysliman dhe të jetonte në shkretëtirë si çoban. As nuk do të pendohej dhe as nuk do të privohej nga lumturia e përfjetshme.

Në përgjithësi, shkaqet kryesore të mospranimit të Islamit nga ata që kanë pasuri dhe famë, janë frika e ndërprerjes së përfitimeve të tyre të padrejta ose humbja e tyre, mospranimi i të qenit në të njëjtin status me njerëzit e thjeshtë, frika e braktisjes së jetës me famë dhe me privilegje të përkohshme dhe dëshira për t'u dukur gjithmonë lart. Të gjitha këto i bëjnë njerëzit si Nemrudi e Faraoni, të shkojnë drejt një humbjeje të sigurtë. Lum ata që jetojnë thjeshtë e me modesti në atmosferën islame dhe fitojnë nderin dhe fisnikërinë në këtë rrugë.

Përlotja, një lutje e heshtur e zemrës

Dr. Adem Ergyl

Një person nga Beni israilët i drejtua Allahut: "O Zot, sa mëkate kam kryer unë dhe Ti nuk më dënove si të tjerët!" Në lidhje me këtë, Allahu i shpalli Pejgamberit të asaj kohe (a.s.): **"Shko, lajmëroje filanin se e kam dënuar me dënimin më të ashpër që ekziston, por ai është i pavetëdijshëm për atë dënim...Unë e kam privuar atë nga loti dhe lutja".**

Mungesa e përlotjes është shenjë e zemërgurësisë, kurse zemërgurësia është shenjë e largësisë midis njeriut dhe Krijuesit të tij. Qortimet kuranore për indiferencën e Jahudive përballë këshillave dhe mesazheve hyjnore tregojnë se në çfarë niveli mund të arrijë ashpërsia e zemrës së njeriut. **"Por, pas kësaj, zemrat tuaja u forcuan e u bënë si guri, madje edhe më të forta. Në të vërtetë, ka gurë nga të cilët burojnë lumenj, ka të atillë që çahen e nga të cilët rrjedh uji, madje ka edhe syresh që rrëzohen nga frika e Allahut. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj veprimeve tuaja."** (Bekare,74)

Për të mos rënë në këtë gjendje të mjerueshme, Allahu në Kuran i tërheq vëmendjen ymetit të Muhamedit (a.s.): **"A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë, që zemrat e tyre të përulen para këshillave të Allahut dhe para së Vërtetës që Ai ka shpallur e të mos bëhen si ata, që iu është dhënë Libri më parë? Me ka-**

limin e një kohe të gjatë, zemrat e tyre u ngurtësuan dhe shumë syresh janë të pabindur" (Hadid,16). Ky ajet tregon qartë se humbja e ndjeshmërisë në çështjet fetare është shkak për zemërgurësinë.

Kur drita e imanit dobësohet me neglizhencë, indiferencë dhe harresë, syri i zemrës drejtohet nga kënaqësitë e përkohshme të kësaj bote, duke u bërë i verbër ndaj botës tjetër. Në këtë mënyrë, njeriu vërvitet pas plotësimit të dëshirave të kësaj bote, duke harruar ibadetin ndaj Allahut. Sipas një transmetimi, Allahu e këshillon kështu Musain (a.s.): **"O Musa! Mos ushqe shumë dëshira për dynjanë, përndryshe të ashpërsohet zemra. Kurse zemra e ashpër është larg Meje. Teshat le të jenë të vjetra, por zemrën mbaje gjithmonë të pastër dhe të freskët."** Ismail Hakkı Bursevî, Rûhu'l-beyân., VIII, 95). Pejgamberi (a.s.), në lidhje me këtë të vërtetë i ka porositur besimtarët: **"Kini kujdes që kënaqësitë e shumta mos t'ju shpien në harrimin e vdekjes, përndryshe ju ngurtësohen zemrat."** Ibn Mâxhe, Mukaddime, 7. 4) Porosia tjetër profetike: **"Mos u merrni me biseda të padobishme duke harruar Allahun, sepse bisedat e gjata, ku nuk përmendet Allahu ashpërsojnë zemrën, kurse zemra e ashpër është larg Tij."**

Porositë Profetike shprehin qartë humbjen e ndjeshmërisë, kur veprimet dhe sjelljet e njeriut nuk bëhen nën



*“Shko, lajmëroje filanin
se e kam dënuar me dënimin
më të ashpër që ekziston,
por ai është i pavetëdijshëm
për atë dënim...
Unë e kam privuar atë
nga loti dhe lutja.”*

ndjenjën e mbikëqyrjes dhe vëzhgimit të përhershëm të Allahut. Ky është shkaku që sahabët, sapo ndjenin diçka të dyshimtë në zemër, i pushtonte paniku dhe vraponin tek Pejgamberi (a.s.), për të gjetur shpëtim dhe zgjidhje. Madje një herë, kur një sahab ndau shqetësimin me Pejgamberin (a.s.), në lidhje me çështjen në fjalë, Pejgamberi (a.s.), e porositi të ushqente të varfrit dhe të përkëdhelte jetimin, nëse dëshironte të zbuste zemrën. Prej zemrës së vrazhdë nuk mund të rrjedhin lotët e lëvdur në Kuran dhe Sunet, sepse përlotja është produkt i një zemre të butë dhe të ndjeshme. Lotët janë pika eliksiri, që rrjedhin prej njerëzve, zemrat e të cilëve janë mbushur me dashuri për Allahun, me mëshirë, dhembshuri dhe përgjegjësi. Këto janë lotë që e strehojnë besimtarin nën hijen e Arshit dhe shuajnë zjarrin e Xhehenemit. Përlotja është kërkesë e heshtur për falje dhe amnisti për veprimet e realizuara dhe të parealizuara. Përlotja është shfaqja në sy e dridhjes së zemrës përballë madhësisë, diturisë dhe fuqisë së pakufishme të Allahut. Përlotja është shprehje e dashurisë, e pamundur për t'u shprehur me fjalë. Përlotja është një përpjekje e sinqertë për të pastruar shpirtin. Çdo pikë loti e derdhur, është një eliksir që nxjerr në pah gurët e çmuar të njeriut. Prandaj, prej atyre që pretendojnë pastrimin shpirtëror kërkohet përlotje për hir të Allahut. Përlotja është një gjendje

që ndodh normalisht tek ata që kanë shitur dynjanë në këmbim të ahiretit. Fatkeqësisht, sot kjo gjendje është tepër e rrallë midis besimtarëve, për shkak se ata nuk tregojnë ndjeshmërinë dhe kujdesin e duhur ndaj hallallit dhe haramit. Por çfarë mund të bëhet për të mos u privuar nga një mirësi kaq e madhe? Së pari duhet t'i kërkojmë mbrojtje Allahut nga zemra që nuk dridhet nga frika prej Tij dhe nga syri që nuk loton për hir të Allahut. Një mënyrë tjetër për të shpëtuar prej zemërvrazhdësisë është përmendja vazhdimisht e Allahut, sepse sipas shumë dijetarëve shpirtëror, zemra zbutet dhe ringjallet me dhikër. Duhet qëndruar pranë të varfërve dhe të braktisurve, duhet treguar kujdes dhe ndjeshmëri e lartë në mënyrën e sigurimit të jetesës. Një tjetër faktor që ndikon shumë në zbutjen e zemrës është reflektimi dhe meditimi mbi Kuranin dhe natyrën në përgjithësi, sepse ata që i lexojnë ajetet e Allahut me syrin e zemrës, menjëherë bien në sexhde. Siç e konfirmon edhe ajeti kuranor: **Thuaj: “Besoni në të (Kuranin) apo nuk besoni, ata që u është dhënë dijenia para tij, bien në sexhde me fytyrat për tokë, kur ai u lexohet.”** (Isra,107)

Përfundimisht, besimtari nuk duhet të harrojë që privimi nga përlotja është një sëmundje shpirtërore dhe për shërimin e saj, duhet lutur vazhdimisht Allahu.

Të dashuruar pas Parajsës -2

Altin Torba

BRENGOSJA PËR PARAJSEN

Një ditë e pyeta veten:

Vërtet je i dashuruar pas Parajsës?

Kjo pyetje kumboi në tërë brendinë time dhe unë nis të kërkonte përgjigje në çdo damar dhe qelizë... Pas një copë here heshtjeje, u dëgjua një zë... Ishte pikërisht zemra që mori përsipër të më përgjigjej... Më tha se brenda saj gjendej dikush që mund të më orientonte për të marrë përgjigjen... Më tha se duhej të trokisja në një prej portave të saj, që quhej "Porta e Dashurisë"...

Dashuria, nga ana e saj, më orientoi të trokisja në një tjetër portë, ku do të gjeja dikë që mund t'i përgjigjej pyetjes sime, pikërisht në "Portën e Brengës"...

Përmes rrugicës së melankolisë arrita tek Porta e Brengës dhe trokita në të... Para meje u shfaq një krijesë e përlurur... Aty për aty i shpjegova se si qëndronte çështja ime...

M'u përgjigj se çështja ishte pikërisht ashtu siç kishte thënë dashuria dhe se ajo gëzonte një status tepër të lartë tek dashuria, statusin e ambasadorit...

Pa humbur kohë i kërkova brengës, ambasadorit të

dashurisë sime, të më ndihmonte të gjeja përgjigjen nëse isha apo jo i dashuruar vërtet pas Parajsës...

Orientimi i parë, që brenga më dha qe, se ajo s'ishte vetëm se rob i përlurur i vullnetit tim dhe se isha pikërisht unë ai që e bëja atë të:

Brengosej për Amëshimin dhe Parajsën... ose... të brengosej për dynjanë.

E pyeta se si mund ta kuptoja në isha i brengosur për Amëshimin apo për dynjanë?

Ajo më tha:

-Shih treguesit e mëposhtëm...

Nëse Allahu:

të ka pasuruar në zemrën tënde...

ta ka tubuar dhe vënë nën kontroll unin dhe katinin tënde...

ta ka nënshtruar dynjanë...

atëherë përgëzime, ti je nga ata që brengosesh për Parajsën e amëshuar...

Ndërsa, nëse Allahu ka bërë që:

varfëria të t'i ketë pllakosur sytë...

të jesh i hallakatur dhe të mos kesh nën kontroll unin dhe katinin tënde...

nëse dynjaja të ka marrë nëpër këmbë, edhe pse je i vetëdijshëm se prej saj nuk ke për të marrë vetëm atë që është paracaktuar për ty...

atëherë ngushëllimet e mia, ti je nga ata që bren-gosesh për Dynjanë...

I habitur me këtë përgjigje të qëlluar u ktheva dhe pyeta dashurinë time se nga i dinte brenga gjithë këto të fshehta...

Ajo ma ktheu: "I ka mësuar nga thënia e Profetit Muhamed, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, në të cilën thuhet:

"Kush ka Amëshimin, brengë të tijën; Allahu ia pa-suron zemrën, ia tubon katandinë e tij dhe dynjaja i vjen pas e nënshtruar. Ndërsa, kush ka dynjanë brengë të tijën; atij Allahu ia pllakos varfërinë mi-dis syve, e bën të jetë i hallakatur dhe prej dynjasë nuk ka për t'i ardhur vetëm ajo që i është paracaktuar."

(Transmetim i saktë, transme-tuar nga Tirmidhi)

Po po... Orientimi hyjnor është i qartë... brengosja identifikon se çfarë dashu-ron... dashuria të nxit të dëshirosh... dëshira të nxit të ideosh... dhe ideja të nxit të veprosht...

Allahu na bëftë nga ata që bren-gosen për Parajsën, e dashurojnë atë, e dëshirojnë atë, ideojnë dhe punojnë për të...

NXITIMI PËR NË PARAJSË

Fisi medinas Benu Eshhel i Eusit me ftesë të kreut të saj, Sead ibn Muadhrit, kishte pranuar Islamin, me përjashtim të njërit...

Në fakt, ai nuk kishte asgjë me Islamin... Dita-ditës po bindej se Islami ishte një vërtetësi, të cilën e kish-te konfirmuar jo më kot për të tillë kryetari i tyre i urtë Seadi.

Ditët kishin vrapuar pa u ndjerë, derisa diçka për-brenda e kishte ngritur nxitimthi që t'u bashkohej burrave të fisit të tij...

Usejrini kishte vrapuar t'u bashkëngjitej atyre, porse ata tanimë ishin nisur në burrërinë e radhës... Ishin nisur për t'i dëshmuar Zotit të tyre se qenë të

gatshëm t'ia dhuronin Atij jetët dhe pasuritë e tyre, që në fund të fundit Zoti i tyre ua kishte dhuruar... Ishin nisur për në betejën e Uhudit, në përgjigje të urdhrimit suprem të Allahut dhe të Dërguarit të Tij...

Usejrini nxitoi shumë që t'i kapte në rrugë e sipër, porse nuk i arriti përveçse në fushëbetëje. Nuk kish-te se ç'priste. Kishte ardhur momenti ta zëvendë-sonte gjithë atë kohë të humbur... U sul si vetëtimë kundër armikut të së vërtetës, e cila tanimë e kishte pushtuar me krahët e saj të lavdishëm, aq sa ishte gati që për të, të jepte edhe jetën...

Kur beteja e Uhudit mbaroi, myslimanët po këqyr-nin në fushëbetëje për të plagosurit dhe të vranët në radhët e tyre. Kur ja, ç'të shihnin... "Mor po ky është Usejrini... Po ky këtu...!" Ai njihej si delja e zezë e kop-së, që nuk u qe bashkëngjitur të tjerëve kur ata në masë kishin pranuar Islamin... Gjithsesi e vërteta

ishite se ata kishin para tyre Usejrinin, që dukej se ishte në grahmat e fundit... Nxitan ta pyesnin nëse ishte përfshi-rë në betejë në ndihmë dhe në emër të fisit të tij apo e kishte bërë këtë në emër të Allahut dhe të Dërguarit të Tij... Edhe pse në një trup që ishte në grahmat e fundit dhe mbushur plot plagë të ash-pra, me një zë që çuditërisht kumbues e më të vendosur se kurrë, Usejrini u shpreh: "Po, në emër të Allahut dhe të Dërguarit të Tij..."

Kur ia treguan këtë të Dërguarit të Allahut, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, dhe e pyetën se si ishte gjendja e tij, ai kishte thënë shkurt dhe qartë: "Ai është në Parajsë".

Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të, lidhur me këtë thotë:

"Hyri në Xhenet pa bërë asnjë ruku (pa falë asnjë namaz) për Allahun".

UNË KËRKOJ PARAJSËN

Personazhi i historisë sonë është... ose më mirë po ju lëmë ta zbuloni vetë atë...

Ai dëshironte vërtet shumë të ishte prej dësh-morëve të privilegjuar të Bedrit... Ishte lëshuar dhe zhytur thellë në radhët e armikut, por me sa u pa, Allahu ende s'e kishte shkruar, që ëndrra e tij të bëhej



realitet...

Gjithsesi, tani i kishte ardhur shansi i artë që me lejen e Allahut të realizonte ëndrrën e tij të zjarrtë... Ishin nisur drejt Uhudit, stacionit nga ku ai me mall priste të udhëtonte drejt Parajsës, e të takonte Krijuesin e tij, takim që në realitet rezultoi vërtet i rrallë...

Një natë të afërt para këtij udhëtimi, kishte parë në ëndërr një shokun e tij, Mubeshir ibn Abdul Munedhirin, i cili ishte prej atyre që kishin rënë dëshmorë në betejën e Bedrit. E kishte pyetur: "Po a nuk ke rënë ti dëshmor në Luftën e Bedrit?" Ai i ishte përgjigjur: "Po, dhe tashmë ne shëtisim në Parajsë sipas dëshirës..." Por më e bukura ishte se personazhi i ëndrrës së tij kishte shtuar: "Edhe ti do të na bashkëngjitesh së shpejti..."

Kur ia kishte treguar këtë Profetit Muhamed, paqja dhe lavdërimi i Allahut qoftë mbi të, ai e kishte përgëzuar duke i thënë: "Është shehidllëku, o Abdullah".

Tanimë, ai e dinte mirë çfarë kërkonte... Me këtë qëllim ishte nisur, i lumtur sa më s'ka, teksa prapa kishte lënë shtëpinë mbushur plot me gra dhe djalin e tij Xhabirin, që në mungesë të të atit s'dinte se si do t'u vente halli vështirësive të shumta ekonomike dhe sociale, në të cilat gjendej familja e tyre e ngratë...

Abdullah ibn Harami e kishte bërë këtë, sepse pati besuar jo vetëm në teori, por edhe në praktikë se angazhimet ndaj fesë së Allahut ishin më primare se ato familjare dhe personale...

Qe mërziur vërtet shumë me tradhtinë e kryehipokritit Ibn Ubej ibn Selulit, që në krye të çetës së tij prej treqind dezertorësh kishte braktisur ushtrinë e Profetit të Allahut nga frika e vdekjes... Fillimisht qe munduar t'i mbushte atij mendjen, por si përfundim kishte mbetur i çuditur se si dikush mund t'i shmangej rënies dëshmor, për çfarë ai, lavdi Zotit, kishte marrë dhe konfirmimin e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe lavdërimi i Allahut qoftë mbi të dhe po e lakmonte prej kohësh... Ishte mërziur vërtet shumë prej tyre, i kishte mallkuar dhe ishte shprehur se Allahu do të bënte të mundur që i Dërguari i Tij të mos kishte nevojë për këta tradhtarë...

Konfirmimi hyjnor që iu përcoll atij nga Profeti, pas ëndrrës së vërtetë parajsore, u përmbush... Thuhet se ai që i pari që ra dëshmor në betejë, teksa ushtria myslimane në fillimet e kësaj beteje kishte bërë vërtet kërdrinë në radhët armike...

Ndër trupat e të rënëve të Uhudit, që po përgatiteshin për Dasmën e Dëshmorit, ishte edhe trupi i Abdullah ibn Haramit... Gjithsesi, djali i tij Xhabiri ishte vërtet i tensionuar... Herë e zbulonte dhe herë e mbulonte fytyrën e të atit... Vazhdoi kështu një copë herë... Teksa shokët e Profetit tentonin ta ndalonin dhe ta ngushëllonin, nga ana e tij Profeti, paqja dhe lavdërimi i Allahut qoftë mbi të, e shihte dhe nuk i ndërhynte...

Sakaq, Profeti, paqja dhe lavdërimi i Allahut qoftë mbi të, iu drejtua:

"Allahu askujt nuk i ka folur përveçse duke pasur midis tyre një perde, ndërsa babait tënd i ka folur fytyrë për fytyrë; i ka thënë: 'O rob i im, dëshiro e Unë do të ta jap atë!' Ai (babai yt) i ka thënë: 'O Zoti im, më kthe në dynja e të ribie dëshmor'. Allahu i ka thënë: 'Robi im, është parashkruar nga Unë që ata (njerëzit) nuk kthehen më në të (dynja)'. (Babai yt) i ka thënë: 'O Zoti im, informoju ata që vijnë pas meje!'"

Me këtë rast, Allahu i Lartësuar zbriti:

"Kurrsesi, të mos i mendoni ata që ranë dëshmorë në Rrugën e Allahut se janë të vdekur. Përkundrazi, ata janë të gjallë duke u ushqyer te Zoti i tyre. Janë të gëzuar me atë që u dha Allahu nga të mirat e Tij dhe atyre që ende nuk u janë bashkuar radhëve të tyre, u japin myzhde se për ta nuk ka frikë dhe as kanë pse të brengosen." (Al 'Imran, 169-170)

Po, po..., Abdullah ibn Harami e dinte mirë çfarë kërkonte... Shpallja Hyjnore zbuloi, se ai e arriti atë... Jo vetëm, por ai edhe pas vdekjes i kërkoi Allahut të Lartësuar të konfirmonte për mbarë njerëzimin, për mua dhe për ty, këtë përfundim parajsor...

Teksa Abdullahu e ka lënë pas këtë dynja dhe në këto momente po lumturohet në Parajsën që me ngulmim e kërkoi, po ne të nderuar vëllezër dhe motra, a e dimë se çfarë po kërkojmë?...





SËMUNDJET E ZEMRËS

Muhamed El-Gazali

Adhurimi i vërtetë ndaj Allahut është të gërmosh në veten tënde dhe të drejtosh çdo gjë të shtrembër, të fshish çdo gjë të keqe, dhe të shërosh çdo sëmundje kronike, ditë e natë. Që vdekja të të gjejë të pastër ose duke luftuar për arritjen e këtij pastrimi.

Vetëkënaqësia është shenjë e të vegjëlve dhe të mbyllësh sytë ndaj saj, ndërkohë që i bën katër sytë dhe veshët ndaj gabimeve të të tjerëve, është rrugë e humbjes!

Kam parë disa grupime fetare, të cilat rendin duke numëruar gabimet e të tjerëve, ndërsa në të njëjtë kohë ndaj gabimeve të tyre rrinë shumë larg, pothuajse e konsiderojnë veten të pagabueshëm!

Të krenohesh me të vërtetën është një gjë dhe vetëkënaqësia është një gjë tjetër! Të krenohesh me të vërtetën është ndjesi e mirësisë së Allahut, madhështi e suksesit të dhuruar, dëshirë për ta përhapur këtë të vërtetë, në mënyrë që askush të mos privohet nga ajo dhe keqardhje ndaj atyre që largohen dhe privohen prej saj.

Mendo pak rreth këtij dialogu: Një njeri i tha një tjetri: - Unë të dua për hir të Allahut! Tjetri i tha: - Sikur të dish për mua çfarë unë di për veten time, do të më kishe urreyer për hir të Allahut!

Njeriu ia ktheu: - Sikur të dija për ty çfarë di ti për veten tënde, atëherë unë do të isha i zënë me ato çfarë di për veten time...

Besimtarin e mençur e shqetësojnë gabimet e tija dhe nuk merret me të metat e njerëzve. Ai e di se është i nevojshëm për Mëshirën e Lartë dhe në qoftë se ka mirësi më tepër se ata, atëherë kjo i konsiderohet barrë dhe jo vlerë.

Dituria e tepërt kërkon përpjekje më të mëdha, jo lakmi ndaj krijesave dhe pusi ndaj tyre, sepse në një hadith thuhet: **"Një njeri tha: - Pasha Allahun, Allahu nuk e falë filanin! Allahu tha: "Kush është ai që ndërhyr në punët e Mia? Unë e kam falur atë dhe ta kam zhvlerësuar punën tënde".**

Më kujtohet, kur një djalë i ri i zemëruar m'u afrua duke më qortuar dhe më tha: - Ti qëndron me studentët me mjekra të rruara dhe studente të pambuluara me shami, njerëzit të shikojnë të buzëqeshur dhe jo të vrenjtur dhe nuk dëgjojnë prej teje asnjë urdhër, apo ndalesë. Si justifikohesh ti me këtë mënyrë të sjelluri?

I thashë: - Nuk e besoj që të vrenjturit është prej kushteve të thirrësve. Unë, së pari u shpjegoj gjërat elementare të Islamit, në besim dhe në moral. Në qoftë se fara është e mirë edhe frutat do të vinë në kohën e tyre! Ditën që njerëzit do ta njohin Zotin dhe do të lidhen me Të mbi parimin e dëgjimit dhe të bindjes, atëherë ajo çfarë ti kërkon, madje edhe më shumë se çfarë kërkon do të realizohet...!


Ndërsa për çështjen e justifikimit tim, nuk di se çfarë të them për të? E falënderoj Allahun, i Cili ka lëshuar perden e Tij mbi mua dhe nuk ju ka dhënë mundësi ndaj meje!

Ju keni epsh që krijesat të diskreditohen, në mënyrë të kënaqni veten tuaj dhe ky epsh është sëmundje më e ndytë se sa gjynahet, me të cilat i kritikoni njerëzit.

O biri im, kam frikë se me këto qëllime të errëta do të bëheni një e keqe për të tjerët!

Një gjynahqar zemërthyer është më i ndershëm se sa një predikues, që mbikëqyr njerëzit me ashpërsi.

Përktheu
Lavdrim Hamja



E SOTMJA DHE E NESËRMJA E XHAMIVE

Xhafer Durmush

Vlera e një ndërtese dhe rëndësia e saj për vendin apo qytetin në të cilin ndodhet, matet me sasinë e punëve të mira për të cilat shfrytëzohet. Xhamitë janë ndërtesa, ku në radhë të parë falet me xhemat namazi, i cili konsiderohet si shtylla e fesë dhe ku formohet hap pas hapi jeta shoqërore islame. Këto ndërtesa funksionale mund të bëhen burim frymëzimi, nëse përpjekjet e vetëdijshme të banorëve të vendeve ku ndodhen i pranojnë ato si qendra të të gjitha punëve të dobishme. Për këtë shkak, në suren et-Teube, Allahu Teala u drejtohet besimtarëve: **“Mesxhidet e Allahut i ndërtojnë (i mirëmbajnë i meremetojnë) vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zekatin e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut. Sigurisht që këta janë në rrugë të drejtë.”** (Teube, 18.)

Detaji më i rëndësishëm që të tërheq vëmendjen në ajetin e mësipërm, është se ndërtimi i xhamive, i cili stimulohet në një mënyrë shumë efektive, duhet të bëhet në atë formë që të mjaftojë për të gjithë besimtarët në çdo vend dhe kohë pa asnjë lloj kufizimi. Në tefsire të ndryshme theksohet se urdhri në këtë ajet nuk është i kufizuar vetëm me ndërtimin apo meremetimin e ndërtesës. Aty tërhiqet vëmendja edhe në domosdoshmërinë e gjallërimit të xhamive me adhurime dhe xhemat. E shprehur ndryshe, aty theksohet domosdoshmëria e kthimit të xhamive në vendet më të dashura të një qyteti, ku do të marrë jetë çdo lloj aktiviteti i dobishëm.

Pejgamberi ynë (a.s.), në një hadith fisnik, shprehet: **“Në një qytet, vendet më të dashura për Allahun, janë xhamitë e tij.”** (Muslim, Mesxhid, 288.) Në librin *Rijadu's-Salihin*, ky hadith fisnik shpjegohet në këtë mënyrë: **“Shkaku që xhamitë janë vendet më të dashura për Allahun, është se këto vende të shenjta janë ndërtuar me sinqeritet të plotë, vetëm për të fituar kënaqësinë e Tij. Ato vende të pastra kanë shumë vlerë tek Allahu Teala, sepse përdoren nga njerëzit për ta adhuruar Atë me ndjenja të pastra dhe të sinqerta.**

Dashuria e Allahut ndaj xhamive do të thotë se Ai dëshiron mirësi për robërit e Tij që ndodhen atje për të kryer detyrën e adhurimit, do të thotë se Ai dëshiron lumturinë e tyre në këtë botë dhe në tjetrën. Kjo, sepse unitetin dhe bashkimin Islami i ka konsideruar jash-tëzakonisht të rë-

ndësishëm, prandaj dhe i ka dhënë shumë vlerë faljes së namazit me xhemat, i cili është një nga elementët kryesorë që e sigurojnë këtë unitet. Për këtë arsye, në Islam, namazi i cili falet në xhami me xhemat, ka më tepër vlerë se namazi, i cili falet i vetëm në shtëpi apo në vendin e punës..."

Mund të themi se të parët tanë kanë bërë gjënë më ideale në lidhje me ndërtimin dhe shpërndarjen e xhamive nëpër lagje. Ata i stolisën qytetet me xhami, të cilat i ndërtonin vetë sulltanët dhe xhamitë e lagjeve.

Po sot, në ç'pikë jemi me ndërtimin fizik dhe shpirtëror të xhamive? Po për nesër, çfarë mund të themi? Sa interesohemi me pjesën e brendshme dhe të jashtme të xhamisë së lagjes sonë? Sa prej adhurimeve dhe aktiviteteve sociale i kryejmë në xhami? Çfarë mund të bëjmë për të ruajtur dhe zhvilluar lidhjen tonë me xhamitë e qytetit tonë? A ka fshatra apo lagje me popullsi myslimane, ku nuk ekziston asnjë xhami? A ka nevojë për xhami apo për vende, ku myslimanët të kryejnë detyrat e tyre të adhurimit në aeroporte apo stacione? Nëse po, çfarë mund të bëjmë për ta ngritur zërin deri në instancat e autoriteteve përgjegjëse?

Sot, po ndërtohen me qindra pallate e mijëra apartamente në sipërfaqe të gjera të qyteteve ku për fat të keq nuk ka ende asnjë xhami. A jemi shqetësuar ndonjëherë se si do të jetë situata nesër, kur qytetet të zgjerohen edhe më shumë dhe xhamitë të ngelen në lagje të largëta? Si do të jetë jeta e njerëzve në vendet e banimit apo të punës, të cilat janë krejt të zhveshura nga prania e xhamisë? Duke menduar rreth këtyre pyetjeve, mundohem të mos e humbas shpresën. Por përsëri më kap shqetësimi se brezave të ardhshëm do t'u lëmë trashëgim, vende adhurimi të groposura nën tokë nëpër katet e nëndheshme të ndërtesave gjigande dhe lagje, ku nuk do të dëgjohet zëri i ezanit...

Një shqetësim tjetër janë edhe modelet e reja të xhamive, të cilat ndërtohen në emër të arkitekturës moderne... Kam frikë se në vend të modeleve të xhamive, të cilat të japin qetësi shpirtërore dhe kanë identitet islam, do të shtohen shumë ndërtesat e ftohta moderne që janë pa oborr, dalin direkt në rrugë dhe pa identitet islam. Nuk e di se sa i përqendruar mund të jetë një mysliman gjatë adhurimit në një xhami ku muret e tejudkshme të xhamit fillojnë aty ku mbaron tapeti... Në një qytet, në vend të një xhamie, e cila ishte shembur

prej tërmetit, ishte ngritur një ndërtesë moderne dhe madhështore, por pa minare. Kur e pashë, u habita jashtë mase... Nuk mund të gjej ndonjë arsye logjike, e cila i ka shtyrë t'ia marrin minaren xhamisë pa qenë të detyruar! Kur e pashë atë ndërtesë, mbaj mend që bëra këtë dua: "O Allah! Mos u jep mundësi atyre, që duan të ndryshojnë formën origjinale të xhamive!"

Mendoj se urdhrin që stimulon ndërtimin e xhamive në ajetin e mësipërm, duhet ta shikojmë edhe në lidhje me këto probleme dhe të ngjashme me to.

Dëshirat e këqija, si pengesë e harmonisë islame

Në suren Al 'Imran, Allahu Teala deklaron: "**Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami...**" (Al 'Imran, 19.) Kuptimi i këtij ajeti duhet të jetë ky; Islami është një sistem i organizuar, i cili përbëhet nga qindra ingranazhe që funksionojnë në mënyrë të përsosur. Ata që i dorëzohen këtij rregulli, përjetojnë lumturinë e të dyja botëve. Mirëpo, nëse një ose disa prej ingranazheve nuk punojnë siç duhet, sistemi do të pësojë dobësim dhe rënie. Ata që bëhen shkak për këtë dobësim, do të përballen me zemërimin e Allahut.

Në krye të gabimeve që bëri para e popujve, të cilëve u kishte ardhur shpallje prej Allahut, si hebrenjtë dhe të krishterët, ishte refuzimi i urdhreve fetare, që nuk u përshatashin dëshirave të tyre. Dobësia më e rëndësishme që vë në pah paradoksin e njeriut, është se kur është në vështirësi i lutet e i përgjërohet Allahut, por kur është në rehati e harron lutjen dhe adhurimin. Mirëpo, Allahu Teala zemërohet seriozisht me ata që i rregullojnë ligjet e fesë sipas dëshirave të tyre.

Sot po përsëriten të njëjtat gabime, duke marrë dhe zmadhuar gjërat e thjeshta të fesë dhe duke neglizhuar ose braktisur detyra të tjera më të rëndësishme. Në një farë kuptimi, kjo do të thotë adhurim i dëshirave të nefsit. Allahu Teala shprehet kështu, në lidhje me këtë çështje: "**...Kush, përveç Allahut, mund ta udhëzojë atë njeri, që dëshirat e veta i ka bërë zot; atë njeri, të cilin Allahu, duke e njohur për të tillë, e ka shpënë në humbje, duke ia vulosur dëgjimin dhe zemrën e duke i vënë perde para syve të tij?..**" (Xhathije, 23.)

Të gjitha veprimet e myslimanit duhet të kalojnë nga sita e mendjes. Ndërsa mendja, urdhrat dhe udhëzimet nuk duhet t'i marrë nga dëshirat dhe ambiciet e nefsit, por nga zemra e ndriçuar me dritën e besimit.





Kumunikimi shembullor i Pejgamberit (a.s.), ME FËMIJËT

Alli Bulladë

Pejgamberi (a.s.), i ka përshkruar fëmijët si aromë xheneti, ndërsa nipat i thërriste gjithmonë me emrin e një luleje me erë shumë të këndshme, por që kërkon një përkujdesje dhe përpjekje të veçantë për t'u rritur. Pejgamberi (a.s.), i këshillon kështu prindërit, të cilët janë përgjegjës për këto lule: *"Edukoni dhe silluni mirë me fëmijët."*

Një ditë, kur Pejgamberi (a.s.), po falte namazin, qëndroi më gjatë se herët e tjera në sexhde. Sahabët u bënë kureshtarë. Kur Pejgamberi mbaroi namazin, u shpjegoi arsytet përse u vonua, duke thënë: *"Fëmijët kishin hipur mbi shpinë, nuk desha t'u prish lojën, prandaj e zgjata sexhden."*

Kurse prindërit sot nuk i afrojnë fëmijët në xhami, sepse bëjnë rrëmujë e zhurmë. Ndërsa Pejgamberi (a.s.), e fillonte namazin me Umamen në krahë. Kur binte në sexhde e ulte në tokë dhe kur ngrihej e merrte përsëri në krahë. Fëmijët regjistronë çdo gjë që dëgjojnë.

Kur Pejgamberi (a.s.), takonte një fëmijë, nuk e largonte dorën nga dora e tij derisa ta largonte fëmija. Një nga mangësitë e prindërve sot është pakujdesia, mungesa e vëmendjes dhe përkushtimit sa duhet ndaj tyre. Nuk duhet harruar asnjëherë që fëmijët regjistronë çdo gjë që dëgjojnë prej të mëdhenjve, qoftë edhe kur janë duke luajtur.

Pejgamberi (a.s.), është dërguar si model i përkryer dhe mëshirues për gjithë njerëzimin, sepse Ai edukatën e kishte marrë prej Allahut. Çdo sjellje e Tij me të rriturit apo fëmijët ishte sipas vullnetit hyjnor. Besimtarët, që e konsiderojnë shumë të rëndësishëm edukimin e fëmijës, duhet ta mësojnë mënyrën si të sillen me fëmijët e tyre vetëm prej Pejgamberit (a.s.). Nëse familjet sillen si Ai, atëherë sigurohet edhe lumturia familjare dhe ajo shoqërore. Sepse lumturia e kësaj bote dhe botës së përtejme është e fshehur në fragmentet e jetës së Tij.

Pejgamberi (a.s.), ia fërkonte foshnjës së sapolindur buzën me hurmë të llojit të mirë. Një tjetër gjë e rëndësishme që praktikonte Pejgamberi (a.s.), tek të porsalindurit ishte edhe këndimi i ezanit në veshin e djathtë dhe ikametit në krahun e majtë.

Pejgamberi (a.s.), e ka ndaluar ushtrimin e dhunës mbi fëmijët. Enesi (r.a.), ka qëndruar dhjetë vjet pranë Pejgamberit (a.s.) dhe gjatë gjithë kësaj kohe Pejgamberi (a.s.), asnjëherë nuk u nervozua me Enesin (r.a.).

Pejgamberi (a.s.), thotë: *"Dheu është pranverë për fëmijët."* Dheu ka aftësinë të tërheqë energjinë negative të ndodhur tek njerëzit; në këtë mënyrë lojrat në dhe e qetësojnë fëmijën.

Gjëja e parë që këshillon Pejgamberi (a.s.), për t'u mësuar fëmijëve është ajeti 78 i sures nahl: **"Allahu ju ka nxjerrë nga barku i nënave tuaja e ju nuk dinit asgjë dhe ju dha të dëgjuarit, të parit dhe zemrat, që të jeni falënderues"** (Nahl,78)

Sahabët shtrinin gosti për të sapolindurit. Pejgamberi (a.s.), lutej për foshnjën, duke i vendosur dorën në ballë. Kur merrte ndonjë lajm për një fëmijë të lindur, Pejgamberi pyeste menjëherë për gjendjen shëndetësore dhe, kur merrte përgjigje pozitive, falënderonte Allahun për këtë mirësi.

Një ditë vijnë tek Pejgamberi (a.s.), dy nipat Hasani dhe Hysejri (r.a.), duke i kërkuar gjyshit një deve. Pejgamberi, duke mos pasur mundësi të gjente deve për fëmijët, gjeti një zgjidhje për t'u larguar vëmendjen nga kjo dëshirë e perealizueshme për momentin. U kërrus duke u thënë: *"Ejani hipni, se nuk keni për të gjetur deve më të mirë."* Fëmijët hipën gjithë gëzim në kurrizin e gjyshit të tyre, duke harruar devenë. Kurse përgjigjet tona përballë dëshirave të fëmijëve janë standarde, si: nuk kemi mundësi, më vonë etj. Këto fjalë nxisin ndjenjën e varësisë nga paraja dhe krijojnë psikologjinë e varfërisë tek fëmijët.

Kush ka fëmijë, të bëhet si fëmijë me fëmijën e tij.

Kur takohej me fëmijët, Pejgamberi (a.s.), i përshëndeste si të rritur. Ndante me ta sekrete. Ai i vlerësonte fëmijët dhe në momentet më të vështira dhe të ngjeshura nuk i lëndonte ata. Madje, sipas Pejgamberit (a.s.), ishin të rriturit që shqetësonin të vegjlit dhe jo e kundërta. Pejgamberi interesohej dhe fliste vazhdimisht me fëmijët.

"Shkatërimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve, kështu që (Allahu) do t'i bëjë 'të shijojnë' pjesë nga ajo që kanë punuar, me qëllim që ata të kthehen (në përmirësim)."

(Rrum, 41)

Në shekujt e fundit në botën islame është derdhur shumë gjak dhe lot. Gjatë historisë është përjetuar pushtimi mongol, rënia e Spanjës etj. Por periudha e fundit është krejt ndryshe nga të tjerat, sepse krizat e rënda politike, ekonomike dhe kulturore kanë hapur plagë të rënda. Lufta, përçarjet etnike dhe sektare në botën islame vazhdojnë të krijojnë plagë në zemrat e myslimanëve. Pyetjet që kërkojnë përgjigje janë: Kur do të shpëtojë bota islame nga ky kaos dhe kjo rrëmuje e madhe? Kur do ta marrë ymeti islam përgjegjësinë që i takon për të udhëhequr njerëzimin drejt drejtësisë, virtyt dhe moralit të lartë?

Fatkeqësisht myslimanët sot, përveç mburrjes me arritjet e të parëve të tyre, nuk po bëjnë asgjë për të marrë përgjegjësinë që u takon në shkencë, teknologji dhe art. Në jetë është dobësuar fryma e xhihadit (çdo përpjekje në rrugën e Allahut), kurse në shkencë fryma e ixhtihadit (përpjekja për të bërë shkencë) ra në imitim. Bota islame vazhdon të jetë një imituese e perëndimit, pa i dhënë asnjë lloj kontributi të vetin njerëzimit. Rinia islame, e rritur larg traditës e kërkon zgjidhjen në rrymat filozofike dhe ideologjike të huaja. Lidhjet dhe marrëdhëniet midis njerëzve dita-ditës po dobësohen. Brezi që i ka shkëputur lidhjet me Allahun për të gjetur prehje dhe qetësi, nuk gjen alternativë tjetër përveç alkoolit, drogës dhe kumarit.

Çdo ditë e më shumë dhuna në familje, në sport, në punë, në rrugë, shkurtimisht

në çdo fushë të jetës, po rritet me ritme të frikshme. Si shpjegohet që ymeti i Pejgamberit të mëshirës të përfshihet kështu nga dhuna dhe ashpërsia? Nga ana tjetër, adhurimet janë neglizhuar, ndjeshmëria ndaj hallallit dhe haramit është dobësuar. Vendin e fisnikërisë, nderit dhe lavdisë e kanë zënë dëshirat dhe kënaqësitë djallëzore. Faktorët e zhvillimit apo prapambetjes së shoqërisë mund të jenë politike, ekonomike, ushtarake etj. Rolin për shqyrtimin e këtyre aspekteve të çështjes e ka marrë përsipër sociologjia, historia dhe shkencat politike. Kur problemit i qasemi nga këndvështrimi kuranor, konstatojmë, se Ai përqendrohet më shumë te faktori njeri. Këtu, besimi, ibadeti dhe vlerat morale të njeriut luajnë një rol përcaktues. Thënë ndryshe, fati i shoqërisë vlerësohet sipas faktorit shpirtëror dhe jo atij material.

Nga kjo pikëpamje, kritika e Kuranit i drejtohet direkt njeriut dhe përgjegjësitë i takojnë krejtësisht atij. Prandaj i kërkohet të kontrollojë vetveten për çdo fatkeqësi dhe problem që has në jetë. Burimi i çdo të keqeje, që i ndodh njeriut është vetë ai. Kurani thekson se Allahu nuk u bën padrejtësi njerëzve, por janë njerëzit ata që i bëjnë padrejtësi vetes së tyre. Qëndrimi kritik kundrejt të metave dhe gabimeve është i lëvdueshëm në Kuran, prandaj Allahu betohet në shpirtin autokritik në ajetin e dytë të sures Kijame.

Të gjitha porositë fetare në lidhje me këtë temë përqendrohen në plotësimin

Më Afjet



Një Ajet

e detyrave individuale të çdo myslimani. Shkakun e problemit nuk duhet ta kërkojmë jashtë, por brenda nesh. Ajeti kuranor: **“O besimtarë! Ju keni përgjegjësi vetëm për veten tuaj! Ai që është i humbur nuk mund t’ju dëmtojë, nëse jeni në rrugë të drejtë. Tek Allahu do të ktheheni të gjithë e do t’ju lajmërojë për atë që keni punuar.”** (Maide, 105) na kujton pikërisht këtë të vërtetë. Përsëri në një ajet tjetër, Allahu thekson se nuk do të ndërhyjë në ndryshimin e gjendjes së një populli, pa ndryshuar më parë ata veten e tyre: **“Me të vërtetë, Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë ç’kanë në vetvete.”**

Prandaj përmirësimi i shoqërisë është krejtësisht i varur nga përmirësimi individual i çdo anëtar të saj.

Hedhja e përgjegjësisë të tjerëve nuk shërben për asgjë tjetër, përveç vetëngushëllimit fals. Nga kjo pikëpamje, çdo mysliman, në çfarëdo pozite apo statusi qoftë, ka një detyrë të cilën duhet ta kryejë me përgjegjësi të plotë. Nuk është e drejtë që personi të nënvlerësojë rolin e tij, duke ua kalur përgjegjësinë të tjerëve. Siç e shpjegon Kurani, ne jemi përgjegjës para Allahut për aq sa mundemi. **“Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka.”** (Bekare, 286)

Nëse shoqëria myslimane ndodhet në një pështjellim dhe amulli dhe sundohet nga kaosi politik, social dhe ekonomik, nuk

është vetëm për shkak të fuqive kolonizatore. Ky është largim nga përgjegjësitë dhe mosmarrje në konsideratë e ajetit: **“Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve, kështu që (Allahu) do t’i bëjë ‘të shijojnë’ pjesë nga ajo që kanë punuar, me qëllim që ata të kthehen (në përmirësim).”** (Rrum, 41)

Pra, mosrespektimi dhe mosmarrja seriozisht e urdhëresave hyjnore, sjell si pasojë prishjen e ekuilibrave sociale dhe natyrale. Për më tepër që ky dënim nuk prek vetëm ata që janë përfshirë direkt në prishjen e ekuilibrave, por edhe ata që qëndrojnë të heshtur dhe indiferentë ndaj kësaj dukurie.

Nëse bota islame gjendet në një gjendje kaosi, kjo vjen për shkak se nuk ekziston bashkimi, uniteti, ndihma dhe konsultimi i ndërsjelltë midis myslimanëve. **“Mos-besimtarët janë miq e mbrojtës të njëritjetrit. Nëse edhe ju nuk veproni ashtu, do të bëhet ngatërresë dhe shkatërrim i madh në Tokë.”** (Enfal, 73)

Problemet kryesore të myslimanëve janë përçarja, injoranca dhe prapambetja. Përballë përçarjes qëndron bashkimi, përballë injorancës qëndron dituria dhe përballë prapambetjes qëndron çdo përpjekje dhe mundim i secilit individ.

Kur Pejgameri (a.s.), hyri në Mekë si triumfues, mbajti një fjalim para Qabes dhe i drejtoi këtë pyetje popullit të Mekës: "O populli i Mekës! Çfarë mendoni se do të bëj me ju tani?" Ata thanë: "Prej teje presim vetëm mirësi, sepse ti je fisnik dhe bir fisniku." Atëherë Pejgamberi (a.s.), u tha: "Shkoni, jeni të gjithë të lirë."

(Siretu ibn Hisham, 4/41)

Ky është qëndrimi fisnik i Pejgamberit (a.s.), kundrejt armiqve të tij të përbetuar, të cilët vetëm tetë vjet më parë e kishin detyruar të braktiste vendlindjen e tij të dashur, për të emigruar në Medine. Ky qëndrim paqësor i Pejgamberit (a.s.), përballë armiqve, të cilët e kishin munduar dhe torturuar për trembëdhjetë vjet rresht, për më tepër ku i kishte të gjitha mundësitë për t'u hakmarrë, mund të shpjegohet vetëm me të qenit e tij, një Pejgamber i mëshirës dhe i paqes.

Çlirimi i Mekës mjafton si shembull për të krijuar mbi të përshtypjen e një Pejgamberi, që gjatë gjithë jetës ndoqi një politikë paqësore. I Dërguari i Allahut e mbajti sekret deri në momentin e fundit edhe për njerëzit më të afërt planin për mësymje drejt Mekës. Dhe mori masa për të penguar nxjerrjen e informacionit. Siç ishte rasti i Hatib Ibn Ebu Belta, i cili me qëllimin për të mbrojtur të afërmit e vet u përpoq të dërgonte një letër përmes një gruaje në Mekë. Kur ushtria fushoi në një vend afër Mekës, Pejgamberi (a.s.), i urdhëroi ushtarët që secili të ndizte nga një zjarr, që t'i bënte kurejshët të mendonin se kishin përballë një ushtri të madhe, duke ulur në këtë mënyrë moralin e armikut dhe dobësuar mundësinë për një qëndresë të fortë.

Të gjitha këto masa të Pejgamberit (a.s.), ishin në funksion të parandalimit të gjakderdhjes, sepse po të merrej vesh lajmi që muslimanët do të mësynin drejt Mekës, atëherë Kurejshët do të përgatiteshin për luftë, gjë e cila do të shkaktonte humbje dhe gjakderdhje të madhe nga të dyja palët. Megjithëse muslimanët ishin më të fortë se kurrë dhe shumë lehtë mund të përdornin si pretekst për luftë shkeljen e marrëveshjes së Hudejbijes. Por

qëllimi i Muhamedit (a.s.), nuk ishte hakmarrja dhe pushtimi. Prandaj Pejgamberi (a.s.), fjalën e Sad ibn Ubades drejtuar Ebu Sufjanit: "Sot është dita e luftës së madhe, sot është e lejuar derdhja e gjakut në Qabe", e përgënjeshtrroi duke thënë: "Sadi gënjen. Sot është dita, ku Allahu do ta madhështojë Qaben." (Buhari, Megazi, 49). Ai nuk kishte për qëllim as për të qëndruar në Mekë, megjithëse ishte një ndjenjë më se normale për t'u rikthyer në vendlindjen e Tij. Por Ai nuk e mendonte një gjë të tillë dhe këtë e konfirmoi, kur ensarët u merakosën për rikthimin e Muhamedit (a.s.), në Mekë. Ai i qetësoi duke thënë: "Kurrë! Unë jam rob dhe i Dërguari i Allahut. Emigrova tek Allahu dhe tek ju. Jeta dhe vdekja ime është me ju." (Myslim, Xhihad, 31)

Qëllimi i Pejgamberit (a.s.), ishte pastrimi i Qabes nga idhujtaria dhe ngrohja e zemrave të njerëzve ndaj Islamit dhe shpallja e amnistisë së përgjithme ishte pikërisht për këtë qëllim, fitimin e zemrave të njerëzve. Në këtë mënyrë u realizua hyrja e njerëzve në Islam grupe-grupe, që Kurani e përshkruan: "**Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi i Mekës, do t'i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe-grupe, atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai, se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve.**" (Nasr, 1-3) Në mesin e grupeve bënin pjesë Ebu Sufjani, lideri i kurejshëve, Hindi iniciatorja e vrasjes së Hamzait (r.a.), lkrime, biri i Ebu Xhehlit dhe shumë të tjerë, që kishin kryer krime të rënda, por Pejgamberi (a.s.), i falë të gjithë duke i harruar të gjitha ngjarjet e dhimbshme.

Një Hadith



VËLLAZËRIA ISLAME

Allahu i Madhëruar është shprehur në Kuranin Famëlartë se besimtarët janë vëllezër. Gjithashtu edhe Pejgamberi (a.s.), ka bërë të ditur se një besimtar nuk mund të ketë besim të vërtetë pa bërë një lidhje të fortë solide me vëllezërit e tjerë të fesë.

Resulullahu (a.s.), e shpjegon rëndësinë e vëllazërisë islame në këtë mënyrë:

“Besimtari bashkë me vëllanë e tij (në fe), është shumë.” (Axhluni, Keshful-Hafa, nr. 2800.)

“Kur takohen besimtarët me njëri – tjetrin, janë si dy duar që lajnë njëra – tjetrën.” (Dejlemiu, Firdevs, IV, 132/6411.)

Enes bin Maliku (r.a.), thotë kështu:

“Resulullahu (a.s.), interesohej për cilindo vëlla besimtar, që nuk e shihte prej tri ditësh. Nëse ishte larg, bënte dua për të; nëse ishte në shtëpi, i bënte vizitë; nëse ishte i sëmurë, shkonte tek ai për t’i uruar shërim.” (Hajthemiu, II, 295.)

Pra, vëllezërit besimtarë ndihmojnë njëri – tjetrin, ia largojnë të metat njëri – tjetrit, ia ndreqin gabimet njëri – tjetrit, këshillojnë njëri – tjetrin në një mënyrë të bukur.

Dashuria ndaj vëllait në besim, për hir të Allahut, shprehet në këtë mënyrë:

“Në Ditën e Kiametit, Allahu i Madhëruar thotë kështu: ‘Ku janë ata që duan njëri – tjetrin me qëllim

që të më binden Mua, për hirin Tim? Ata do t’i mbroj dhe do t’i mbaj nën hijen (e Arshit), atë ditë që nuk do të ketë asnjë hije.” (Muslimi, Birr, 37.)

Një ditë Resulullahu (s.a.s), pati thënë:

“Ekzistojnë një pjesë e njerëzve që nuk janë as profetë e as shehidë. Mirëpo, në Ditën e Kiametit, për arsye të statusit të tyre tek Allahu, ata do t’i kenë zili edhe profetët dhe shehidët.”

Sahabët e nderuar i thanë:

“Kush janë këta dhe çfarë veprash të mira kanë bërë? Na trego, që t’i respektojmë dhe të krijojmë edhe ne afrimet me ata, o Resulullah!”

I Dërguari i Allahut (a.s.), u ktheu këtë përgjigje:

“Ata janë njerëz të atillë, që nuk kanë lidhje fa-refisnore apo tregtare me njëri – tjetrin dhe që vetëm për hir të Allahut duan njëri – tjetrin. Pasha Allahun, fytyrat i kanë plot nur dhe janë të ulur në piedestale të ndritura. Kur njerëzit frikësohen, ata nuk frikësohen. Kur njerëzit dëshpërohen, ata nuk dëshpërohen.”

Dhe pastaj shtoi këtë ajet:

“Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar.” (Junus, 62) (Ebu Davud, Buju, 76/3527; Hakimi, IV, 170; Shih. Tirmidhiu, Zuhd, 53/2390)

Shembujt më të bukur lidhur me vëllazërinë islame,



i vërejmë në kohën e emigrimit të Pejgamberit (a.s.), nga Meka në Medine. Në ditët e para që kishte mbërritur në Medine, Resulullahu (a.s.), i shpalli vëllezër të gjithë myslimanët. Muhaxhirët, të cilët kishin lënë në Mekë të gjithë pasurinë, të afërmit dhe familjarët, Pejgamberi (a.s.), ua la amanet ensarëve. Kështu, krijoi bashkësinë dhe unitetin fetar, social dhe politik.

Vëllazëria islame ishte mbjellë dhe rritur në një kohë të shkurtër në zemrat e ensarëve dhe muhaxhirëve. Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), ftoi fillimisht ensarët që t'ua ndante tokën e Bahrejnit, ata u tërhoqën dhe thanë:

"O Resulullah! Për sa kohë që nuk u jepet vëllezërve tanë muhaxhirë më shumë sesa neve, ne nuk marrim asgjë!" (Buhari, Menakibul-Ensar, 8)

Resulullahu (a.s.), ka thënë:

"Kur një njeri njihet me një tjetër dhe bëhet vëlla, le ta pyesë për emrin e tij, emrin e të atit dhe se kush është! Sepse kjo gjë bën që të shtohet dashuria mes tyre." (Tirmidhiu, Zuhd, 54/2392)

Xhabiri (r.a.), rrëfen:

"Kur ensarët ndërronin hurmat, ato i ndanin në dy pjesë, në njërën anë shumë dhe në tjetrën vendosnin



"Resulullahu (a.s.), interesohej për cilindo vëlla besimtar, që nuk e shihte prej tri ditësh. Nëse ishte larg, bënte dua për të; nëse ishte në shtëpi, i bënte vizitë; nëse ishte i sëmurë, shkonte tek ai për t'i uruar shërim."

pak hurma. Pastaj, duke vendosur degë dhe gjethe nën hurmat që ishin pak, i tregonin sikur ishin shumë dhe u thoshin muhaxhirëve:

- Merreni atë që dëshironi. Kështu dhe shumica e hurmave shkonte prapë për muhaxhirët. Ensarët, në këtë mënyrë i linin vetes qëllimisht më pak. Deri në çlirimin e Hajberit, kjo bujari e ensarëve vazhdoi në këtë mënyrë." (Hejthemiu, X, 40)

I Dërguari i Allahut (a.s.), rrëfen një ngjarje të tillë:

"Njëri mori rrugën për t'i bërë vizitë vëllait besimtar, i cili ndodhej në një fshat tjetër. Allahu i Madhëruar ngarkoi me detyrë një engjell që të kontrollonte njeriun dhe e vendosi në rrugën që do të kalonte ai. Kur iu afrua pranë, engjëlli i tha:

-Ku po shkon?

-Në këtë fshat kam një vëlla besimtar, atë po shkoj të shoh.

-A ke ndonjë interes që do të përfitosh nga ai?

-Jo, nuk kam. Unë e dua atë vetëm për hir të Allahut, ndaj dhe po shkoj t'i bëj vizitë.

Atëherë engjëlli tha:

- Ashtu sikurse e do ti atë, edhe Allahu të do ty. Unë jam një lajmëtar që Allahu i Madhëruar ka dërguar për të dhënë këtë lajm të mirë." (Muslimi, Birr, 38)

TË MOS RRI SH I ZEMËRUAR ME TJETRIN

Si në ditë të lumtura, po ashtu edhe në ditë dëshpërimi, vëllezërit e besimit islam duhet të mbështesin gjithmonë njëri – tjetrin. Kurse, të rri sh i zemëruar me vëllezërit islamë, asnjëherë nuk është diçka e pëlqyeshme. Një gjë e tillë vetëm paralizon vëllazërinë islame. Resulullahu (a.s.), ka thënë:

"Nuk është hallall për një besimtar të rrijë i zemëruar me vëllain e tij besimtar më shumë se tri ditë. Nëse kanë kaluar tri ditë, kur të takohet me të, le t'i japë selam. Nëse e merr selamin, të dy marrin sevap. Përkundrazi, ai që nuk merr selam, hyn në gjynah. Ai që jep selam, del nga të qenit i zemëruar." (Ebu Davud, Edeb, 47/4915)

"Kush rri i zemëruar me tjetrin për një vit me radhë, është sikur të ketë derdhur gjakun e tij." (Ebu Davud, Edeb, 47/4915)

Sipas shpjegimit të Pejgamberit (a.s.), veprat e njerëzve i paraqiten Allahut të Madhëruar ditëve të hëna dhe të enjte. Përveç njerëzve që janë të zemëruar me vëllain e tyre besimtar, u falen gjynahet të gjithë njerëzve, të cilët nuk i shoqërojnë Zotit tjetër zot. Engjëjve u këshillohet:

"Këtyre dy njerëzve bëjuani faljen atëherë kur të pajtohen!" (Muslimi, Birr, 35 – 36)

"Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni." (Huxhuratë, 10)

"...Prandaj, frikësojuni Allahut, rregulloni marrëdhëniet midis jush dhe bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nëse jeni besimtarë të vërtetë." (Enfal, 1)

Vëllazërimi islam bën që të anashkalohe diskutimet e llojit: "Unë kam të drejtë, ti nuk ke të drejtë". Duhet harruar armiqësitë e vjetra dhe duhet të arrihet në virtytin e të falurit të vëllait besimtar duke sakrifikuar unin, nëse është e nevojshme. Të qëndruarit të zemëruar, është mosbindje ndaj urdhrut të Allahut.

Të pajtosh dhe të rregullosh marrëdhëniet mes



"Në të vërtetë,
besimtarët janë vëllezër,
andaj pajtojini vëllezërit tuaj
midis tyre dhe kijeni frikë
Allahun, në mënyrë
që ju të mëshiroheni!"

vëllezërve të fesë, është një nga punët më të mbara. Resulullahu (a.s.), një ditë, duke iu drejtuar Hazreti Ebu Ejjub Ensarit, tha:

- Ebu Ejjub, të të them një të mirë që Allahu dhe i Dërguari i Tij e pëlqen?

- Po, na e thuaj, o Resulullah! – tha Ebu Ejjubi (r.a.).

Pejgamberi (a.s.), tha:


- Kur njerëzit fyejnë njëri-tjetrin, pajtoji; kur largohen nga njëri-tjetri, afroji. (Bejhakui, Shuab, VII, 490; Hajthemiu, VIII, 80)

TË ZGJIDHËSH PROBLEMET E VËLLAIT

Njërit prej sahabëve iu dhurua një kokë deleje. Ai tha:

"Filan vëlla dhe familja e tij janë më nevojtarë se unë." Dhe ia dha atë dhuratë vëllait që përmedi. Edhe ai, me të njëjtin motiv ia dha një tjetri. Kështu, dhurata u soll dhe përfundoi sërish tek sahabi i parë. Ndaj dhe u shpall ky ajet fisnik:

"...Ata duan t'u bëjnë më mirë mërgimtarëve



“...Prandaj,
frikësojuni Allahut,
rregulloni marrëdhëniet
midis jush dhe bindjuni Allahut
dhe të Dërguarit të Tij,
nëse jeni besimtarë të vërtetë!”

sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtarë...” (Hashr, 9) (Hakimi, Nustedrek, II, 526)

Resulullahu (a.s.), tha kështu:

“Sikur të kisha mundësi të zija një mik nga njerëzit, do të zija Ebu Bekrin. Mirëpo, vëllazëria islame është më e lartë.” (Buhari, Salat, 80)

Një ditë, kur Resulullahu (a.s.), ishte në itikaf, erdhi një person, dha selam dhe u ul. Abdullah bin Abbasi (r.a.), i tha:

- Vëlla, po të shoh të mërzhitur dhe të dëshpëruar.

- Po, o djali i xhaxhait të Resulullahut, jam i mërzhitur. I kam hyrë në hak filanit, por të betohem për të drejtën e të zotit të këtij varri (Resulullahut a.s.), se nuk mund ta shlyej dot atë borxh (që i kam marrë).

- A të flas unë me të në emrin tënd? – i tha Ibn Abbasi.

-Ti e di, – i tha ai.

Ibn Abbasi (r.a.), veshi këpucët dhe doli nga xhamia. Njeriu në fjalë i tha:

- A harrove që je në itikaf, si dole nga xhamia?

Ibn Abbasi (r.a.), iu drejtua:

-Jo! Unë kam dëgjuar nga ky njeri i nderuar, që është i shtrirë në këtë varr dhe sapo u nda prej nesh, të thotë (dhe kur po i thoshte këto, i rridhnin lot):

“Cilido që përpiqet të ndihmojë vëllain e tij të fesë për një problem të tij dhe nëse ia zgjidh atë problem, kjo gjë për të është më e rëndësishme sesa të rrijë në itikaf për dhjetë vite me radhë, duke pasur parasysht se të rrish në itikaf vetëm një ditë, për hir të Allahut, Allahu i Madhëruar mes atij njeriu dhe xhehenemit krijon tri gremina dhe secila është në largësi sa lindja me perëndimin.” (Bejhakui, Shuab, III, 424 – 425. Veçanërisht, shih Hajthemiu, VIII, 192.)

Ebu Hurejra thotë kështu:

“Besimtari është pasqyra e të vëllait. Kur shikon një të metë tek ai, e rregullon.” (Buhariu, el-Edebul-Mufred, Nr. 238.)

Pra, besimtari ia shpjegon me sinqeritet çdo gjë që sheh të mirë dhe, nëse sheh ndonjë të keqe përpiqet t’ia rregullojë duke e qortuar.

MBËSHTETJA QË I DUHET BËRË VËLLAIT BESIMTAR

Pas çlirimit të Stambollit, Fatih Sulltan Mehmeti pati pyetur disa priftërinj të ndershëm, të cilët në kohën e Bizantit ishin futur në burg, se ç’mendim kishin ata lidhur me shtetin osman. Ata i thanë se do t’i jepnin përgjigje pasi ta studionin pak këtë perandori.

Priftërinjtë hynin e dilnin në çdo vend me fermanin që u ishte dhënë. Në orët e para të mëngjesit, kishin dashur të blenin diçka në dyqan. Dyqanxhiu u tha:

- Zotërinj, unë e kam bërë seften. Ju merrni nga ky fqiu që nuk e ka bërë akoma seften!

Priftërinjtë mbetën të mahnitur nga panorama e vëllazërisë islame... Vërtet, a mund të rrihet pa e pasur zili një personalitet të tillë të pjekur, që ndihmon vëllain e tij mysliman, larg çdo interesi?

Miqësia e vërtetë për Allahun, është sikurse jetesa e trupave të ndryshëm me të njëjtën zemër. Jeta e atyre që përpiqen me gjithë qenien e tyre dhe plot sinqeritet të realizojnë përgjegjësinë që kanë mbi vëllazërinë islame, vijon edhe pas kësaj jete të përkohshme. Ata përherë përmenden me nderime dhe lutje. Ashtu sikurse muhaxhirët, ensarët dhe besimtarët e tjerë, që kanë bërë zemrat e tyre streha për vëllazërinë islame.

LARTËSIMI DREJT DEVOTSHMËRISË *me shërbim fetar*

DHE KRYERJA E SHËRBIMIT FETAR *me devotshmëri*

Mustafa Erish

Devotshmëria në Kuranin fisnik, paraqitet si masa e fetarisë dhe vlerës së njerëzve të Allahu (xh.sh.), apo me një shprehje tjetër, paraqitet si cilësia e nënshtrimit të robit ndaj Krijuesit të lartësuar. Në përmbajtjen e këtij termi, gjejmë konceptet si:

- Njeriu duhet ta mbrojë pastërtinë e natyrshmërisë së tij kundrejt rreziqeve dhe ndyrësive materialo-shpirtërore që mund ta dëmtojnë atë, duhet ta mbrojë veten, duke u strehuar te urdhrat hyjnorë, kundrejt rreziqeve të kësaj bote e botës tjetër, që duken apo nuk duken dhe që mund ta dëmtojnë atë e personalitetin e tij, madje që mund ta shkatërrojnë.


- Duhet të rrisë vlerën

e tij të Allahu, duke e lartësuar gjendjen e gradën shpirtërore, me një shprehje tjetër, duke u afruar sa më afër të Allahu (xh.sh.) dhe duke bërë një jetë larg neglizhencës me një zemër që dridhet nga frika ndaj Krijuesit, duke pasur parasysh gjithmonë përgjegjësinë që ka kundrejt Zotit.

Robërit e devotshëm janë ata që lavdërohen nga Allahu (xh.sh.). Ata janë njerëzit që kanë shpëtuar nga errësira e ndjenjave djallëzore dhe që e kanë ndriçuar jetën e tyre me dritën e besimit, Islamit dhe mirësisë. Siç shprehen edhe miqtë e Zotit, ata janë njerëz që kanë përparuar në pastrimin e zemrës.

Si arrihet kjo gjendje? Cilat rrugë të shpien në këtë pozitë të lartë? Ja, kjo është pyetja që cilës duhet t'i japim përgjigje. Mëshira hyjnore nuk e ka lënë vetëm robin edhe në këtë çështje. Kështu që, e ka treguar rrugën e kësaj çështjeje të lartë.





Në Kuranin fisnik thuhet se një jetë e jetuar me një besim të saktë, me frikë ndaj Allahut e me qetësi, është prej faktorëve që të shpien te devotshmëria. Po ashtu edhe shërbimet kundrejt krijesave. Në këtë artikull, brenda kornizës së Kuranit fisnik do të përpiqemi të shtjellojmë aspektin e shërbimit fetar, i cili sjell devotshmërinë dhe edukatën e kryerjes së shërbimit fetar me devotshmëri.

Shërbim fetar, do të thotë që t'u japësh të tjerëve nga pasuria, koha, madje edhe nga jeta jote, kur është e nevojshme. Domethënë, të ndash çdo gjë me të tjerët. Do të thotë t'i ndihmosh të tjerët, t'u zgjidhësh hallet dhe t'ua kthesh brengat në gëzime. Do të thotë të bëhesh një rob i mëshirshëm i Zotit, i cili është Mëshirues dhe Mëshirëbërës. Do të thotë që mëshirën të mos e kesh vetëm për vete, por për të gjithë robërit e Allahut, madje për të gjitha krijesat. Sigurisht se kjo gjendje, e lartëson vlerën e robit të Allahu i madhëruar apo, me një thënie tjetër, bëhet shkak që të hyjë në grupin e robërve të devotshëm.

Ky ajet fisnik, tregon kornizën e plotë të specifikave që e bëjnë robin të devotshëm. Këtu shihet qartë se shërbimi fetar zë një vend të rëndësishëm. Allahu i madhëruar, thotë:

“Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin dhe profetët; e atij që me vullnet jep nga pasuria e vet për të afërmit, jetimët, të varfrit, udhëtarët e mbetur rrugës, lypësit dhe për lirim të robëruarve; e atij që fal namazin dhe e jep zekatin; dhe e atyre që i plotësojnë premtimet, kur marrin përsipër diçka; e atyre që durojnë në kohë skamjeje, sëmundjeje dhe lufte. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë ata që e kanë frikë Allahun.” (Bekare, 177)

Edhe në ajetet e para të sures el-Bekare, duke treguar njërin prej cilësive themelore të robërve të devotshëm, tregohet se të qenët njeri që jep, është një mundësi edukimi e rëndësishme, që lartëson gradën e nënshtrimit të robit ndaj Allahut. Krijuesi i lartësuar, thotë:

“Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit, të cilët besojnë në të fshehtën, falin namazin dhe japin nga ajo që u kemi dhënë Ne.” (Bekare 2-3.)

Nëse e studiojmë me kujdes Kuranin fisnik, në shumë ajete shohim se ka një lidhje shumë të fortë ndërmjet të qenit njeri i devotshëm dhe njeri që jep. Ndër të tjera, mund të përmendim këtë ajet:

“Prandaj, jepni prej atyre mirësive që ju kam dhënë Unë, para se t'i vijë vdekja ndonjërit, e ai të thotë: ‘O Zoti im, sikur të më kishe lënë edhe një kohë të shkurtër në jetë, do të kisha dhënë lëmoshë dhe do të bëhesha ndër të mirët!’” (Munafikun, 10.)

Madje, shprehet qartë se ata që nuk japin prej atyre që duan, nuk e arrijnë përsosmërinë në mirësi apo, me një shprehje tjetër, nuk mund të bashkohen me karvanin e robërve të devotshëm. Allahu (xh.sh.), thotë:

“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni. Çfarëdo që të ndani, Allahu e di mirë atë.” (Al 'Imran, 92.) Njëra prej gjërave më të rëndësishme në lidhje me pastrimin e vetes dhe të zemrës, është të qenët njeri që jep. Në ajetin fisnik, veçoria pastruese dhe zhvilluese e të dhënit, shprehet kështu:

“Merr nga pasuria e tyre lëmoshë, me të cilën t'i pastrosh ata dhe t'ua rrisësh veprat e mira! Lutu për ta, sepse lutja jote është vërtet qetësim për ta. Allahu dëgjon dhe di gjithçka.” (Teube, 103.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha një sahabi, i cili u ankua për ngurtësinë e zemrës së tij: “Shko dhe le-dhatoji kokën një fëmije jetim, në mënyrë që të të

zbutet zemra.”¹ Në këtë mënyrë, tregoi se shërbimi fetar është një mundësi edukuese, që e lartëson gradën e zemrës.

Shërbimi fetar, nga njëra anë është ilaç për shumë sëmundje shpirtërore, si mendjemadhësia, smira, koprracia, egoizmi e mizoria, nga ana tjetër është shkallë lartësimi, që bëhet shkak për lindjen e cilësive të bukura, si nderi, dashuria, mëshira, modestia dhe bujaria.

Sufitë, që kanë dhënë edukimin e personalitetit dhe të devotshmërisë në historinë e civilizimit tonë, e kanë përdorur shërbimin fetar në mënyrën më ndikuese si një mundësi për edukim. Në këtë mënyrë, shërbimi fetar është bërë një mundësi edukimi shumë e rëndësishme, e nxjerrë nga Kurani dhe suneti me një intuitë të madhe prej tyre. Sepse kushti i përparimit me virtyte, nuk është qëndrimi, por është shfaqja në mënyrë bujare e çdo mundësie dhe sakrifice në shërbimet fetare që bëhen në rrugë të Allahut. Kjo e vërtetë tregohet kështu në ajetin fisnik:

“Nuk janë të njëjtë ata besimtarë që rrinë në shtëpitë e tyre, përveç të paaftëve, me ata që luftojnë në rrugën e Allahut me pasurinë dhe jetën e tyre. Allahu i ngre një shkallë më lart ata që kanë luftuar me pasurinë dhe jetën e tyre, kundrejt atyre që kanë ndenjur në shtëpitë e veta. Ai u ka premtuar të gjithëve mirësi, por i ka dalluar ata që luftojnë, nga ata që nuk luftojnë me shpërblim të madh: me grada të veçanta, me falje dhe mëshirë. Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.” (Nisa, 95-96.)

Lidhja ndërmjet shërbimit fetar dhe devotshmërisë, nuk është një lidhje e njëanshme. Siç është shërbimi fetar një mundësi e rëndësishme për formimin dhe zhvillimin e devotshmërisë, edhe devotshmëria ka një rol shumë të madh, që shërbimi fetar të jetë me të vërtetë një shërbim i tillë. Shërbimi fetar nuk përbëhet prej sjelljeve dhe veprave që mbështeten në interesat e kësaj bote, por nga veprat e mira, që bëhen duke kërkuar vetëm kënaqësinë e Allahut të

madhëruar. Kështu që, shërbimi fetar kërkon një pjekuri shpirtërore të sinqertë kundrejt Allahut. Në ajetin fisnik thuhet:

“Allahu pranon veprat e bëra vetëm prej robërve të tij të devotshëm.” (Maide, 27.)

Atëherë, shtimi i devotshmërisë bëhet shkak për pranimin e punëve të mira. Kur robi thellohet në devotshmëri, jep një shërbim fetar më cilësor dhe me zemërgjerësi. Për shembull, robërit e devotshëm që kanë përparuar në devotshmëri, nuk e përdorin shërbimin fetar për të robëruar njeriun. Nëse shërbimi fetar bëhet me këtë njet, edhe pse njeriu është shërbëtor i mirësisë, ata e dinë se në këtë rast nuk është edukuar vetja, por i është shërbyer asaj për t’u hutuar dhe për t’u bërë si faraonët.

Në të njëjtën formë, nëse shërbimi fetar bëhet me njetin për të qenë i nderuar, edhe pse shërbyesi i njerëzve është më i nderuari prej tyre, atëherë kjo nuk ka lidhje me gjendjen e të devotshëmve të vërtetë. Kështu, të devotshmit e vërtetë e dinë shumë mirë se munda dhe punët e mira, që bëhen për të fituar lavdërimet dhe nderimet e njerëzve, nuk kanë lidhje me shërbimet fetare.

Nisur nga shpjegimet e mësipërme, mund të themi: Nëse shërbimi fetar, nuk e shpie njeriun drejt devotshmërisë, ai në të vërtetë nuk është shërbim fetar, edhe pse në dukje ngjan si i tillë. Po ashtu, nëse devotshmëria nuk e shpie njeriun drejt shërbimit fetar, ajo devotshmëri në të vërtetë nuk është e tillë.

Gjithsesi, nuk duhet të harrojmë se Allahu (xh.xh.), çdonjërit prej robërve të tij mund t’ia bëjë të dashur shërbimin fetar në aspekte të ndryshme. Për këtë arsye, mospranimi si shërbim fetar i veprave të tjerëve përveç asaj që bën vetë, është mendim i pjekur dhe paragjykim për robërit e Allahut.

Po në këtë mënyrë, vlerësimi i robërve të Zotit sipas pamjes së jashtme të tyre, duke harruar se devotshmëria është në zemër dhe se atë e di vetëm Allahu Teala, është një shenjë e qartë e mungesës së perceptimit dhe intuitës.



1. Ahmed b. Hanbel, Musned, II, 263, 387.

SI ARRIHET QETËSIA SHPIRTËRORE?

peshë. Atëherë, përse nuk përiqemi të mos distancohemi nga gjynahet? Përse të mos e frenosh veten nga pirja e duhanit, që sot? Përse të mos zgjohesh për ta falur namazin e sabahut në kohë, që sot?

3. Shtoji veprat e mira. Të arrish qetësinë shpirtërore, nuk do të thotë të mos bësh gabime. Gabimi është normal, sepse jemi qenie njerëzore dhe të gabueshme.

Qetësia shpirtërore është rezultat i veprave të mira. Allahu i madhëruar thotë: **"...Veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija."** (Hud, 114)

4. Bëj sa më shumë sexhde. Kur një sahab e pyeti Pejgamberin, se çfarë duhej të bënte që të ishte në xhenet së bashku me të, i Dërguari i Allahut u përgjigj: **"Atëherë bëj sa më shumë sexhde."**

Abdullah ibn Mubarek ka thënë: "Armiku yt më i rrezikshëm është nefsi yt. Nëse e thyen atë, e ke më të lehtë të thyesh armikun e jashtëm. E nëse thyesh para nefsit, para armiqve të tjerë do të jesh shumë më i dobët."

Abdullah ibn Hudhafa, një nga shokët e Pejgamberit (a.s.), u kap rob nga bizantinët, së bashku me disa shokë të tjerë të tij. Komandanti bizantin deshi t'i thyente shpirtërisht, por dështoi. Fillimisht, ai e lidhi në një pemë dhe i urdhëroi ushtarët të hidhnin shigjeta drejt tij, por pa e goditur. Abdullahu nuk lëvizte fare dhe nuk tregonte shenja frike dhe dëshpërimi. Komandanti mori dy nga shokët e Abdullahut dhe i hodhi të gjallë në një kazan me vaj të nxehtë. Ai i kërkoi të braktiste fenë islame në këmbim të faljes së jetës, por Abdullahu sërish refuzoi. Kur e afruan pranë kazanit me vaj të nxehtë, Abdullahut i rrodhën disa pika lot. Kjo e gëzoi komandantin bizantin, pasi mendoi se e kishte shkatërruar shpirtërisht. Duke qeshur me ironi, i tha: "Përse qan? Apo tani je gati ta braktisësh fenë tënde në këmbim të jetës?" Abdullahu iu përgjigj: "Jo, unë qava pasi kam vetëm një shpirt të vetëm, të cilin do ta jap për hir të Zotit. Do të doja që të kisha shpirta, aq sa kam qime në trup dhe të gjithë t'i jepja për hir të Zotit."

Kur e burgosën Ibn Tejmijen ai tha: "E çfarë do të më bëjnë mua armiqtë? Nëse më vrasin, vdes si shehid. Nëse më burgosin, më japin mundësinë të jem vetëm me Zotin. Nëse më syrgjynosin, ky për mua do të jetë udhëtim në rrugën e Zotit. Xheneti është në zemrën time dhe kudo që shkoj e kam me vete."

Në dynja ekziston një xhenet. Kush nuk e shijon atë, nuk e shijon xhenetin e ahiretit. Ai xhenet është njohja e Zotit, dashuria për Të dhe qetësia shpirtërore.

Qetësia shpirtërore luan një rol të rëndësishëm në gjendjen brendshme të njeriut dhe të shoqërisë. Ndjenja e sigurisë dhe e qetësisë konsiderohet njëra prej veçorive kryesore të njeriut të shëndoshë, sepse vetëm nën efektin e kësaj qetësie, ai mund të shënojë progres dhe zhvillim.

Sëmundjet shpirtërore sot, janë ndër sëmundjet më të përhapura në shoqëri dhe ekspertët tregojnë se 80% e sëmundjeve fizike mund të fillojnë edhe si pasojë e problemeve shpirtërore dhe psikike.

Fjala "iman" buron nga fjala "emn", që do të thotë qetësi e prehje shpirtërore, si dhe çlirim nga çdo frikë, stres dhe shqetësim.

Psikologu i njohur amerikan William James, thotë: "Sa më shumë që kalon koha, e kuptoj që nuk jam i aftë ta kaloj jetën pa Zotin". Ndërsa, në një vend tjetër ai thotë: "Besimi është forca që i fal jetë njeriut, kurse mungesa e tij është dështim dhe shkatërrim".

Allahu (xh.sh.), thotë: **"Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira që ka bërë."** (Nahl, 97)

Ajeti i mësipërm nuk flet për xhenetin, por për jetën e kësaj bote. Në interpretimin e "jetës së bukur", që përmendet në ajetin e mësipërm, shohim se nuk thuhet që kjo jetë nuk do të ketë vështirësi. Jo, ajo ka problemet dhe vështirësitë e veta, por në qoftë se njeriu bën vepra të mira duke qenë besimtar, atëherë ai do të kalojë një jetë të bukur dhe të qetë në këtë botë.

Si e fitojmë qetësinë shpirtërore:

1. Përkujtimi i shpeshtë i Zotit. Allahu i lartësuar premtom që secili besimtar që përmend Zotin, siguron qetësinë shpirtërore. Allahu (xh.sh.), thotë: **"Atyre që besojnë u qetësohen zemrat, kur përmendet Allahu. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!"** (Rad, 28)

2. Distancoje veten nga gjynahet e mëdha dhe të vogla, në mënyrë që të arrish qetësinë shpirtërore. Shumë njerëz ia ndalojnë vetes shumë ushqime të lejuara, që të bien në

Bontoni islam, ç'është ky?

"Ju, me të vërtetë, Pejgamberin e Allahut e keni shembull të mrekullueshëm, për atë që i druhet Allahut dhe Ditës së Fundit dhe i cili e përmend shumë Allahun" (El-Ahzab, 21)

Hyrje

Na ndodh të lexojmë nëpër libra apo revista për *bontoni islam*; na ndodh të dëgjojmë nëpër media për bontoni islam, por jo gjithherë do të ndahemi të kënaqur me mesazhin nga tekstet apo ligjërimet e njerëzve që flasin apo shkruajnë. Sidomos kohët e fundit, ligjërimet apo shkrimet e shumta karakterizohen nga një gjuhë e vrazhdë ndaj Islamit në përgjithësi dhe bontoni islam në veçanti. Kundërshtarët ofendojnë pa përzgjedhur mënyrat dhe mjetet për komunikim, kurse myslimanët, janë të pafuqishëm t'u përgjigjen në mënyrë cilësore sulmeve kundërshtarë të njëpasnjëshme.

Islami, sistem tërësor i jetës

Islami është një sistem i tërësishëm, i cili i rregullon të gjitha pikëpamjet e jetës njerëzore. Ai është përfshirës, i lidhur dhe i gërshetuar në atë mënyrë, që mbulon të gjitha nevojat njerëzore. Ai nuk është besim emocional, i shkëputur nga jeta normale, reale njerëzore, por depërton thellë në të gjitha pikëpamjet besimore, morale, shoqërore, politike, ushtarake, juridike e të tjera.

Për dallim prej feve të tjera, Islami ka edhe veçanësitë e veta. Këto veçori e dallojnë nga ideologjitë, religjionet dhe sistemet e tjera. Për shembull, Islami nuk është teologji e pastër sikurse janë disa fe botërore. Ai, krahas besimit, është njëkohësisht edhe mënyrë e jetës, që nënkupton aplikimin praktik të tij dhe nuk nënkupton një ngushtim vetëm në aspektin teorik teologjik. Prandaj në Islam paraqitja, ndërtimi dhe zhvillimi i fesë nuk ka ecur drejt teorizimeve, ideologjizimeve apo dialektizimeve të caktuara, por ka ecur drejt bashkimit

1. Fjala *bonton* është franceze (*bon ton*), që do të thotë: ton, zë i mirë, mirësjellje dhe mënyrë e bukur e të shprehurit të njerëzve mirë të edukuar dhe të arsimuar; sjellje, qëndrim dinjitoz etj. Sipas: Milan Vujaklija, Leksikon stranih reci i izraza, Beograd, 1980, fq. 123.

të gjallë, organik që praktikohet në bashkësi. Ai është Islam i njëmendët, dinamik dhe praktik, i shpallur ta rregullojë jetën në formën praktike dhe që realitetin konkret t'ua nënshtrojë kriterëve të veta. E qartë, jeta islame buron nga Krijuesi dhe është e bazuar në dije, në përkryeshmëri, në fuqi dhe urtësi. Është i qartë edhe problemi vijues: Islami nuk është vetëm konstantë frymore dhe kulturologjike, një teori e pastër, sepse nuk është e tillë natyra e tij dhe synimi i tij përfundimtar, por një konstantë dinamike e realitetit. Islami është fe hyjnore, që ka metodën hyjnore në veprim dhe është në harmoni të plotë me natyrën e Islamit dhe si e tillë nuk është e mundur të ndajë substancën e Islamit nga metoda e tij në praktikë. Natyrisht, Islami është shpallur të bëjë ndryshimin e konceptionit ideor të njerëzisë dhe në pajtim me këtë, ta ndryshojë realitetin jetësor dhe përditshmërinë, sikurse është shpallur ta ndryshojë metodën dhe programin me të cilën ky konception ndërtohet dhe me të cilin ky realitet jetësor ndryshohet. Së këndejmi, Kurani është shpallur në mënyrë të herëpashershme, që ndryshimi i konceptit të bëhet në mënyrë të natyrshme. Synimi i programit dhe metodës hyjnore është ofrimi i mënyrës së veçantë të mendimit, me të cilën do të lirohemi nga të gjitha pikëpamjet joislame të mendimit në jetën aktuale.

Brenda elitës politike, ekonomike, kulturore globale myslimane, por edhe ndër ne, ka individë dhe grupime të vogla të cilët ekzistojnë bindja se besimi i gjallë islam duhet të largohet nga natyra e tij dhe të transformohet në teori për studime dhe arsimim dhe me këtë teori t'i kundërvihet frymës së pastër islame. Individë të tillë harrojnë se Islami mund të luajë rolin e tij vetëm si sintezë ndërmjet udhëzimeve teorike dhe veprimeve praktike. Shembull ideal kemi sintezën absolute të

Muhamedit (a.s.), ndërmjet teorisë dhe praktikës. Edhe brezi i parë e ruajti këtë frymë islame, që nuk mund të thuhet për brezat e tjerë në të ardhmen, mendimin teorik të të cilëve e përcillte joharmonia ndërmjet mendimeve teorike dhe veprimeve praktike.

Si të kthehen vlerat e humbura

Aktualisht myslimanët janë larg të arriturave teknike dhe teknologjike të Perëndimit. Do të duhej shumë punë në arsimim dhe hulumtime, shumë investime në këtë aspekt, që të arrihet kjo distancë, e krijuar për shekuj. Por, normalisht edhe Perëndimi ka mangësitë e tij dhe ne duhet të hulumtojmë në atë vakum. Edhe disa perëndimorë objektivë por edhe disa intelektualë myslimanë kanë shenjuar disa njolla, disa mangësi në kulturën dhe qytetërimin perëndimor, në të cilat myslimanët mund të kontribuojnë në përmirësimin e tyre: mungesa e besimit të mirëfilltë, jo të çoroditur dhe metoda e drejtë, e cila njerëzisë do t'i mundësojë zotërimin edhe të të arriturave materiale, por të frymës së re, që do t'i plotësojë nevojat natyrore njerëzore.

E tërë kjo do të thotë që përkundër nivelit të lartë teknik dhe shkencor në botën aktuale, njerëzit i robërohen njëri-tjetrit në forma të ndryshme bashkëkohore. Kjo nuk është në Islam, ku njeriu i robërohet vetëm Krijuesit, kurse me krijesat mban raporte të barabarta. Ky është koncepti që myslimanët mund t'ia ofrojnë Perëndimit dhe mbarë njerëzisë. Nëse Islami do të zbatohej plotësisht, në të gjitha nivelet dhe segmentet, në aspektin ideor dhe ligjvënës, të rendit dhe ekonomik, në politikë dhe moral, koncepti i tij i drejtë do të zbatohej edhe në botën jomyslimane. Nuk duhet ngatërruar shoqëria e mirëfilltë myslimane me atë që e quajmë myslimane, ku njerëzit janë të lindur si myslimanë, por nuk njohin sheriatin, si ligj të tyre.

Shoqëria injorante apo jomyslimane herë-herë gjatë historisë, absolutisht e mohon Islamin dhe çdo gjë islame, kurse historinë e percepton dhe interpreton në mënyrë materialiste. Herë-herë shoqëria e pranon Krijuesin, por duke e rrëguar Atë vetëm në mbretërinë qiellore dhe duke ia mohuar rolin në mbretërinë tokësore. Ky akses rezulton në përjashtimin e shariatit nga mbretëria tokësore dhe rregullimin e kësaj mbretërie me ligje qytetare që identifikohen me ...izma të shumtë. Sistemi i tillë shoqëror lejon për myslimanët ta adhurojnë Krijuesin nëpër xhami e shtëpi, por ndalon të angazhohen për adhurimin në vende publike, në punishte, shkolla, polici, gjykata, institucione shtetërore etj. Ky sistem ndalon madje ndëshkon çdo angazhim për sheriatin si alternativë të sistemeve laike, së paku nuk mundëson funksionimin e tregut të lirë të mendimeve.

Besimtarët myslimanë e kanë të qartë se pushteti suprem i përket vetëm Allahut, i manifestuar në histori

nëpërmjet shariatit. Ky sistem pushteti i mundëson njeriut t'i robërohet Krijuesit, por e privon njeriun nga robërimi njeriu-njeriut. Me shariat nënkuptojmë jo vetëm aspektin ligjor, siç keqkuptohet zakonisht, por tërësinë e jetës njerëzore: raporti ndërnjerëzor, aspekti njeri-bota bimore e shtazore dhe njeri-kozmos, njeri-bota e padukshme dhe raporti njeri-Krijues.

Është interesant se Islami rregullon jo vetëm temat e mëdha, ato misterioze, tema të nxeha, por rregullon edhe temat nga përditshmëria, ato më banalet. Kjo ndodh pikërisht për arsye, se Allahu e bëri Islamin kodeks të mirësjelljes njerëzore, rrugë të përkryer dhe udhëzim korrekt.

Këtë përditshmëri dhe zakonshmëri të Islamit e ilustron shumë myslimanë të mëdhenj, por edhe jomyslimanë të cilët e kanë pranuar Islamin. Ata thonë se nuk u bindën nga teologët e aftë e mendjempreshtë as nga librat e lartë intelektualistë, por nga përgjigjet praktike të Islamit në çështjet aq të zakonshme jetësore, aq të thjeshta, që magjepsin shpirtin, zemrën dhe trupin.

Njëmend, çdo segment i jetës njerëzore është i rregulluar me shariat. Ne dimë si të veprojmë kundrejt myslimanëve dhe jomyslimanëve, kundrejt natyrës dhe mjedisit, shtazëve dhe çdo krijese tjetër. Islami rregullon mënyrën e qëndrimit në shoqëri, të uljes, ndenjes, ngritjes, hyrjes në shoqëri, daljes nga shoqëria, mirësjellja ndaj gjinisë tjetër, mënyra e të ngrënit dhe pijes, hyrja dhe dalja nga tualeti, fillimi dhe përfundimi i punës e shumë gjëra të tjera. Madje, Islami jep udhëzime edhe si të pihet uji, edhe si të flihet (jo në bark), nga lindja e fëmijës e deri në varrimin e tij edhe shumë e shumë imtësi "me vlerë të madhe". Nëse sot, njeriu kureshtar do të kërkojë sqarime nga shkencat përkatëse, do të gjejë udhëzime të nevojshme për të gjitha pikëpyetjet eventuale që mund t'i shtrohen apo që deri tash nuk na kanë fjetur në zemër. Mjekësia aktuale dhe shkencat përcjellëse kanë përgjigjet e tyre në këto dilema, që nuk dallojnë nga këshillat para 15-shekullore të fesë islame.

Në vend të përmbylljes

Konsiderojmë se periudha postmoderne, e cila karakterizohet me një shturje të paparë morale, politike, ekonomike, kulturore e të tjera, me një degradim të paparashikueshëm njerëzor dhe planetar, ka nevojë për mirësjelljen dhe bontonin islam, sepse bontoni islam është i natyrshëm, human, bashkëkohor në çdo kohë, sepse nëse ndryshon teknologjia dhe të mirat materiale, besimi, morali, mirësjellja janë gjithnjë të njëjta, nga Ademi (a.s.) e deri te Muhamedi (a.s.), parime këto që e ndërtojnë personalitetin e njeriut dhe e stolisin me virtyte të larta morale.

Lotët, çelësi i jetës shpirtërore

Sadık Dana



*"Nuk ka pikë më të dashur
te Allahu se këto dy pika.
Njëra prej tyre është
pika e lotit, që derdhet
për Allahun dhe nga frika prej Allahut
në errësirën e natës.
Ndërsa tjetra, është pika e gjakut
që derdhet në luftë për Allahun."*

I nderuari, Hz. Muhmud Sami Ramazanollu, edhe pse kishte fytyrë të buzëqeshur, qante shumë nga brenda. Ai qante për shpëtimin e umetit mysliman nga dora e tiranëve. Qante për shpëtimin dhe faljen e mëkatarëve. Kur lexohej Kurani Fisnik, dëgjonte me frikërespekt ndaj Allahut Teala dhe nganjëherë i rridhnin lotët. Veçanërisht përgjatë periudhës së haxhit, në kohën kur shokët e tij flinin ndërmjet Medines së Ndriçuar dhe Mekës së Nderuar, është parë, duke qarë me lot që i rridhnin nga sytë si perla nën dritën e hënës. Kjo panoramë madhështore, që nuk mund të përshkruhet, ishte aq e bukur sa që poetët dhe letrarët e kishin të vështirë ta përkufizonin.

Poeti i njohur, i ndjeri Kemal Edib Kyrkçyollu, në një varg të një poezie të shkruar për Shejhin tonë të nderuar, e përshkruan kështu:

Fytyra e tij është si një botë pasqyre prej dritash.

Lotët janë një thesar shpirtëror shumë i shtrenjtë për salikët.

Lotët janë argument për ndjesinë dhe butësinë e zemrës.

Lotët janë një shenjë për përsosmërinë e salikut.

Hz. Abdulkadir Gejlani thotë:

"O i nderuar! Është kusht që të ngelësh pak në vështirësi dhe të shtrëngohesh... Ai që nuk ka vështirësi, nuk mund të lutet nga shpirti e zemra dhe nuk kërkon një rrugëdalje. Për këtë arsye, të themi:

Përderisa të mos lëshosh shi mallëngjimi dhe pendimi nga retë e syve pasi ta vendosësh ballin në tokë, nuk do të mbijnë bimët e mira të jetës tënde shpirtërore për të cilën je mallëngjyer.

Lum për ata që e njohin pamundësinë dhe paafësinë e tyre!

Lum për ata që punojnë siç duhet!

Sa të lumtur janë ata që mund të derdhin lot!

Lotët janë zbukurimi i arifëve (njohësve të gnosës islame) dhe të dashuruarve.

Një lot i derdhur për hir të Allahu Teala, është më i vlefshëm se ibadetet qofshin ato sa malet.

Lotët janë çelësi i jetës shpirtërore.

Lotët janë stolia a tyre që kanë arritur zemrën e shëndoshë."

Transmetohet nga Hz. Muslim Ibn Jesu se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

"Nëse një sy rrjedh lot, Allahu ia bën haram zjarrin atij trupi që e mbart atë sy. Nëse një pikë i rrjedh nëpër faqe, asaj fytyre nuk i shfaqet ndonjë njollë

e zezë dhe poshtërim. Nëse ai që qan, qan për një umet që i dhimbset, ai umet falet. Lotët nuk kanë çmim dhe me to shuhen detet e zjarrit.” (Ramuz el-Ehadith)

Hz. Ebu Sulejman Darani thotë:

“Ushtrijini sytë tuaj për të qarë dhe zemrat tuaja për të medituar!”

Hz. Ahmed er-Rufai thotë:

“Shenja më kryesore e arifëve janë lotët. Kur arifët mendojnë për gjendjen e tyre, u rrjedhin lot si rrëke nga sytë.”

Allahu i Madhëruar i tregon kështu cilësitë e tyre:

“Ata bien me fytyrë përtokë, duke qarë dhe ai (leximi i Kuranit) ua rrit përluljen.”
(Isra, 109.)

Qarja është disa llojesh:

Qarja e syrit në pamje të jashtme.

Qarja e zemrës.

Qarja e të fshehtës, botës së brendshme.

Qarja e syrit është për ata që synojnë t’i kthehen Zotit.

Qarja e zemrës është për ata, që ia kanë dedikuar veten rrugës së Allahut.

Qarja e të fshehtës është për ata që e kanë gdhendur dashurinë e Zotit në shpirt-rat e tyre.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Nëse brenda një umeti gjendet dikush që qan për Allahun, Allahu e mëshiron të gjithë umetin për hir të tij.”

Kab el-Ahbar ka thënë:

“Një pikë loti që rrjedh nga frika prej Allahut, e dua më shumë se sa të jap sadaka një mal prej floriri.”

Transmetohet nga Enes bin Maliku, radijallahu anh, se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Allahu ia ka ndaluar xhehenemit djegien e një syri që zbardhet dhe dobësohet për shkak të lotëve. Xhehenemi nuk i djeg kurrë sytë që derdhin

lot për Allahun. Fytyrat në të cilat rrjedhin lot për Allahun, nuk poshtërohen dhe nuk përjetojnë vështirësi. Çdo vepër e mirë, patjetër ka një sevap, një shpërblim. Ndërsa shpërblimi i lotëve të derdhur për Allahun, është shuarja e flakëve të xhehenemit. Nëse në një popull gjendet qoftë edhe një njeri që qan vetëm për Allahun dhe prej frikës së Allahut, Allahu e mëshiron të gjithë atë popull për hir të tij.” (Nga Tenbihu’l-Gafilin)

Tregon Hz. Hasan el-Basriu:

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Nuk ka pikë më të dashur te Allahu se këto dy pika. Njëra prej tyre është pika e lotit, që derdhet për Allahun dhe nga frika prej Allahut në errësirën e natës. Ndërsa tjetra, është pika e gjakut që derdhet në luftë për Allahun.”

Në një hadith që transmeton Abdullah ibn Mes’udi, radijallahu anh, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Zjarri i xhehenemit nuk e djeg asnjë që ka derdhur lot sa një mizë apo sa një kokë mize prej syve dhe i kanë rrjedhur në fytyrë nga frika prej Allahut.”

Mikaili, alejhi’s-salam, ka thënë: “Tri gjëra më janë bërë të dashura nga kjo botë:

Syri që qan, gjuha që bën dhikër dhe zemra që dridhet.”

Profetët dhe të dashurit e Zotit qajnë nga madhështia e Allahut Teala.

A nuk e ke parë Jahjanë, alejhi’s-salam, i cili, edhe pse nuk kishte bërë asnjë mëkat, nuk kishte njeri që qante më shumë se ai.

Jakubi, alejhi’s-salam, nuk qau vetëm për ndarjen nga Jusufi, por qau nga frika se mos ndarja në këtë botë bëhej shkak edhe për ndarjen në botën tjetër.

Kur Allahu Teala dëshiron që robi i Tij të qajë, të rënkojë dhe t’i përgjërohet madhështisë së Tij, e sprovon atë duke e ndarë nga të dashurit ose me uri ose me gjëra të tjera të ngjashme. Këto gjëra janë të njohura prej të devotshmëve. Ata kanë lartësim të habitshëm dhe shfaqje të çuditshme. Këto shihen qartë në gjendjet e tyre.





KURANI DHE SUNETI i Pejgamberit (a.s.)

Serkan Këjly

1- ALLAHU KA URDHËRUAR PEJGAMBERIN, (A.S.), QË TË VEPROJË SIPAS SHPALLJES.

Allahu Teala e urdhëron të Dërguarin, (a.s.), që të veprojë sipas shpalljes hyjnore:

“O i Dërguar! Kije frikë Allahun! Mos i dëgjo jobesimtarët dhe hipokritët! Me të vërtetë, Allahu është i Urtë dhe i Gjithëdijsëm. Bindju asaj që të është shpallur ty nga Zoti yt, se vërtet, Allahu e di mirë se çfarë bëni!”

(Ahzab, 1-2)

Edhe në një ajet tjetër, Allahu i madhëruar, thotë:

“(O i Dërguar!) Ndiq atë që të ka shpallur Zoti yt. S’ka zot të vërtetë përveç Tij. Shmangu prej idhujtarëve.”

(En’am, 106)

“(O i Dërguar!) Ne të kemi vendosur ty në rrugën e drejtë të fesë, andaj ndiq atë dhe mos shko pas dëshirave të atyre që nuk dinë!” (Xhathije, 18)

Allahu (xh.xh.), në këto ajete u tregon njerëzve se ia ka bërë farz të Dërguarit të tij (a.s.), që ta ndjekë shpalljen, sepse Allahu Teala që është i urtë, sundues dhe që e di më mirë sistemin e dobishëm për robërit e tij, pra sheriatin, e ka ndaluar Hz. Pejgamberin nga rruga e qafirëve dhe hipokritëve duke i urdhëruar këtë. Madje, ndërmjet këtyre urdhrave është shprehur se duhet t’i heqë sistemet e tyre

(qafirëve). Çdo sistem, që nuk pranohet nga Allahu, nuk është gjë tjetër përveçse dëshirë vetjake dhe pasion.

“Siç e dinë të gjithë të mençurit, urdhri që Pejgamberi i Allahut t’i bindet shpalljes, është urdhër edhe për ne.” (Imam esh-Shafii, er-Risale)

2- ALLAHU E KA URDHËRUAR PEJGAMBERIN (A.S.), QË T’UA PREDIKOJË NJERËZVE ATË QË I SHPALLET

Allahu (xh.xh.), thotë: **“O i Dërguar! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt! Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë mesazhin e tij. Allahu të ruan ty prej njerëzve. Natyrisht që Allahu nuk i udhëzon njerëzit që nuk besojnë.”** (Maide, 67)

Ibn Kethiri, Allahu e mëshiroftë, në komentimin e këtij ajeti, thotë: “Allahu Teala e urdhëron robin dhe në të njëjtën kohë të Dërguarin e tij, Muhamedin, (a.s.), që t’ua predikojë dhe shpjegojë njerëzve shpalljen. Siç shpjegohet në ajetin fisnik, Hz. Pejgamberi (a.s.), e ka kryer plotësisht detyrën e shpalljes. Në të njëjtën kohë, i është bindur çdo urdhri të Allahut dhe i ka zbatuar në formën më të mirë, sepse morali i tij është Kurani.

Në vazhdim, Ibn Kethiri, thotë: “Ka shumë hadithe, të cilat tregojnë se i Dërguari i Allahut, (a.s.), e ka shpjeguar

plotësisht atë që i është shpallur. Njëri prej tyre është hadithi Mesruk, i cili transmetohet nga nëna jonë Hz. Aishaja (r.anha.). Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

*“Kushdo që të thotë se Muhamedi (a.s.), ka fshehur diçka nga shpallja, patjetër ka gënjyer, sepse Allahu i madhëruar, ka thënë: **“O i Dërguar! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt! Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë mesazhin e tij.”** (Muslim, Iman: 1/287)*

Përsëri, në komentimin e këtij ajeti, Ibn Kethiri duke transmetuar nga Ibn Abbasi, thotë: “Domethënë, nëse fsheh qoftë edhe një ajet nga ajo që të ka zbritur, nuk e ke kryer detyrën e profetësisë.” Allahu (xh.xh.), thotë:

*“(Të dërguarit i çuam) **me prova të qarta dhe libra. Ndërsa ty (o Muhamed) të zbritëm Përkujtesën (Kur’anin), me qëllim që t’u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur dhe që ata të mendojnë.”** (Nahl, 44)*

Në lidhje me komentimin e ajetit: *“...me qëllim që t’u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur...”* (Nahl, 44) ka thënë: “Dija që të është dhënë nga Zoti yt, domethënë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), është më i nderuari prej njerëzve dhe më i virtytshmi prej krijesave. Ai e ndoqi atë që iu zbrit nga Allahu dhe për shkak se ishte i dhënë pas kësaj, e shpjegoi në mënyrën më të bukur. Atë që ishte e mbyllur dhe e vështirë, e shpjegoi një nga një.”

Allahu i lartësuar, thotë: *“...Ne ta zbritëm ty Librin si shpjegim për çdo çështje, si udhërrëfyes, si mëshirë dhe si lajm të mirë për myslimanët.”* (Nahl, 89)

Tefsirin e ajetit: *“...Ne ta zbritëm ty Librin si shpjegim për çdo çështje...”*, e transmeton nga Imam Evzai si sunet: “Imam Shafiu (r.h.), në librin e tij me titull “er-Risale” thotë se i Dërguari i Allahut, (a.s.), e ka ndjekur udhëzimin e Allahut, është kapur fort pas tij dhe këtë e dëshmon edhe vetë Zoti, sepse në të njëjtën kohë thotë:

“Ne të kemi dërguar ty Shpallje me urdhrin dhe vullnetin tonë. Ti më parë nuk e ke ditur se çfarë është Libri e as çështje besimi. Por atë (Kur’anin), Ne e bëmë dritë, me anë të së cilës udhëzojmë kë të duam nga robërit Tanë. Ti, me të vërtetë, udhëzon në rrugën e drejtë, në rrugën e Allahut, të Cilit i përket gjithçka që ndodhet në qiej dhe gjithçka që ndodhet në Tokë.” (Shura, 52-53)

Imam Shafiu, në librin me titull “er-Risale” njofton se në një hadith që ka shtjelluar, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: “Çdo gjë që ka urdhëruar Allahu Teala, unë ua kam urdhëruar juve. Po ashtu, çdo gjë që e ka ndaluar, edhe unë ua kam ndaluar.”

Siç shpjegohet edhe në këtë hadith, patjetër që i Dërguari i Allahut, (a.s.), ua ka predikuar njerëzve plotësisht mesazhin, që Allahu ia kishte dërguar atij. Allahu i madhëruar, thotë:

1. Imam Shafiu në Musnedin e tij dhe Bejhakui në Sunenin e tij e kanë transmetuar si sahih. Shikoni er-Risalen e Imam Shafiut, që i ka bërë tahkik Allame Ahmed Shakiri.

“...Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha, që Islami të jetë feja juaj...” (Maide, 3)

Hz. Pejgamberi, (a.s.), thotë: “Unë ju kam lënë në një rrugë nata e së cilës është e ndritshme si dita. Ai që devijon prej saj, sigurisht se do të shkatërrohet.”²

I Dërguari i Allahut (a.s.), në haxhin e lamtumirës e ka shprehur me një gjuhë shumë të qartë se e ka kryer detyrën e profetësisë, duke thënë: “O Zot! Unë e predikova mesazhin tënd. O Zot! Ji dëshmitar!”³ Nisur nga kjo, e dimë se sheriatu ynë është një. Ne nuk kemi dy sheriate të ndryshëm Dhahir dhe Batin, siç mendojnë disa. Unë nuk kam mundësi ta shpjegoj këtë çështje në këtë material të vogël, sepse hadithet që janë transmetuar në lidhje me të, janë hadithe mevzu, domethënë, të shpifura.

Imam Shafiu, në librin e tij me titull *er-Risale*, thotë: “Ligjet e vendosura nga i Dërguari i Allahut Teala, janë si ligjet e vendosura nga Allahu.” Kështu, Allahu, xhelle xhelaluh, thotë:

“...Ti, me të vërtetë, udhëzon në rrugën e drejtë, në rrugën e Allahut, të Cilit i përket gjithçka që ndodhet në qiej dhe gjithçka që ndodhet në Tokë...” (Shura, 52-53)

3- URDHRI PËR T’U BINDUR ALLAHUT E TË DËRGUIARIT TË TIJ (A.S.) DHE LARGIMI NGA KUNDËRSHTIMI NDAJ TYRE

Allahu i lartësuar, thotë: *“Nuk i takon asnjë besimtari apo besimtareje të vërtetë që, kur Allahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështje të tyre. Kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, me siguri ka humbur.”* (Ahzab, 36)

Ndërsa në një ajet tjetër, thotë: *“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Sa shokë të mrekullueshëm janë këta!”* (Nisa, 69)

“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut...” (Nisa, 80)

“Mos ia drejtoni thirrjen të Dërguarit, njësoj si thirrjen që i bëni njëri-tjetrit. Allahu, me siguri, i di ata që shkëputen prej jush tinëzisht. Le të frikësohen ata që kundërshtojnë urdhrin e tij, që të mos i arrijë ndonjë sprovë ose që të mos i godasë një dënim i dhimbshëm.” (Nur, 63)

Në komentimin e ajetit, në të cilin Allahu i madhëruar thotë: *“...Le të frikësohen ata që kundërshtojnë urdhrin e tij...”*, Ibn Kethiri thotë: “Ata që e kundërshtojnë urdhrin, rrugën, metodën, sunetin dhe sheriatin e të Dërguarit të

2. Ahmed b. Hanbel Musned 4/126 - Ibn Maxhe; 43 dhe Ebu Davud e ka transmetuar.

3. Sahihu'l-Muslim, Kitabu'l-Haxh, 1/147.

Allahut, (a.s.), le të kenë frikë prej kësaj, sepse fjalët dhe veprat maten dhe vlerësohen sipas fjalëve dhe veprave të tij. Ato që i përshtaten atij, janë të pranueshme, ndërsa ato që nuk i përshtaten atij, kushdo që t'i ketë thënë apo bërë, i kthehen prapa. Siç transmetohet në sahihet e Buharit, Muslimit dhe në disa vepra të tjera, Hz. Pejgamberi, (a.s.), ka thënë:

*"Kush bën një vepër dhe për të nuk ka ndonjë urdhër tonin, ajo vepër është e refuzuar (domethënë, e pavlefshme)."*⁴

Domethënë, ata që veprojnë në kundërshtim me shariatën e Hz. Pejgamberit (a.s.), fshehtas apo haptas, duhet të frikësohen dhe largohen nga ky kundërshtim.

Fjala **"sprovë"**, që përmendet në ajet, domethënë kufër, hipokrizi dhe bidat në zemra. Ndërsa, **"të mos i godasë një dënim i dhimbshëm"**, domethënë të frikësohen nga ardhja e ndonjë sprove të madhe në këtë botë, si vrasje, dënim me vdekje apo burg etj.

Imam Kurtubiu, në lidhje me ajetin: **"Le të frikësohen ata që kundërshtojnë urdhrin e tij, që të mos i arrijë ndonjë sprovë ose të mos i godasë një dënim i dhimbshëm."**, ka thënë: "Ata që veprojnë në kundërshtim me urdhrat e Allahut, Allahu do t'ua japë dënimin që meritojnë."

Fjala "sprovë" në këtë ajet, do të thotë vrasje. Ibn Abbasi dhe shumë të tjerë, thonë: Zemrat e tyre do të vulosen, për shkak se kanë kundërshtuar urdhrin e të Dërguarit të Allahut."

Imam Shatibi, në librin e tij me titull "el-l'tisim" (1/132), thotë:

"Zubejr in Bekkar më ka thënë: Kam dëgjuar Malik b. Enesit (r.a.), duke thënë: 'I erdhi një burrë dhe i tha: O Ebu Abdullah! Ku të hyj në ihram për të bërë haxh?'"

Maliku i tha:

"Hyr në dhul-Hulejfe, i cili është vendi ku ka hyrë i Dërguari i Allahut."

Burri i tha: "Unë dua të hyj në ihram në vendin ku gjendet varri i të Dërguarit të Allahut". Maliku i tha:

"Mos e bëj këtë! Kam frikë se mund të të ndodhë ndonjë gjë e keqe.

Burri i tha: "Çfarë fitneje është kjo? Unë vetëm dua të hyj në ihram disa milje pas vendit ku ka hyrë në ihram i Dërguari i Allahut."

Malik b. Enesi (r.a.), i tha:

"A ka fitne më të madhe se sa të vijë dikush dhe ta zgjasë largësinë që e ka begatuar i Dërguari i Allahut, duke e

4. Muslim 1719, Buhari, Sulh: 5, l'tisam: 221, Muslim: 1719, ibn Maxhe, Mukaddime: 14, Ebu Davud: 4606. Kuptimi i fjalës refuzim në këtë hadith, që vjen nga Hz. Aisheja (r.a.), është: E papranueshme dhe e humbur. Ky hadith fisnik përbën pjesën më të madhe të rregullave themelore të Islamit. Ky është hadithi ku janë mbledhur fjalët e të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Në të njëjtën kohë, ky hadith është një refuzim i bidateve dhe besytivne. Bidatet nuk ndryshojnë kurrë, qofshin të reja apo të vjetra.

shkurtuar atë? Unë kam dëgjuar një ajet, në të cilin Allahu i madhëruar, thotë:

"Le të frikësohen ata që kundërshtojnë urdhrin e tij, që të mos i arrijë ndonjë sprovë ose që të mos i godasë një dënim i dhimbshëm."

Pastaj, Imam Shatibi e vazhdon fjalën kështu: "Imam Maliku e përmend këtë fitne si komentit të ajetit kuranor, sepse ata janë bidatçinj. Nuk veprojnë sipas asaj që thuhet në librin e Allahut dhe në sunetin e të Dërguarit të tij, por sipas mendjes së tyre."

Një ngjarje të tillë e transmeton edhe Ibn Vaddah nga Ibn Mes'udi (r.a.). Fjalët: "Ju nuk ndiqni rrugën e të Dërguarit të Allahut, por pranoni rrugë të tjera dhe kapeni fort pas mëkatit të devijimit", Ibn Mes'udi ia ka thënë një grupi që i bindej verbërisht një burri, i cili u thoshte:

"Kush thotë kaq herë 'Subhanalla', Allahu do ta mëshirojë. Kush thotë kaq herë 'Elhamdulillah', Allahu do ta mëshirojë."⁵

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: "Kush më bindet mua, do të hyjë në xhenet. Kush më del kundër, është tërhequr dhe nuk mund të hyjë në xhenet."⁶

Përsëri i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: "Të mos shikoj ndonjërin prej jush që, kur të jetë i shtrirë në kolltuk dhe t'i vijë urdhëresat e ndalesat e mia, të thotë: 'Nuk i pranojmë të tjerët. Ne zbatojmë vetëm atë që shikojmë në librin e Allahut.'"

4- OBLIGIMI PËR TË NDJEKUR SUNETIN E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT, (A.S.)⁸

Allahu i madhëruar thotë:

"Mbani në mendje ato që lexohen në shtëpitë tuaja prej Shpalljes së Allahut dhe Urtësisë (profetike)! Me të vërtetë, Allahu është Bamirës i pakufijshëm dhe di çdo gjë." (Ahzab, 34)

"Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kuranin) e urtësinë (diturinë e thellë fetare), edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar." (Ali Imran, 164)

Imam Shafiu, në librin me titull *er-Risale*, thotë: Në këto ajete kuranore, Allahu i madhëruar përmend Librin dhe Urtësinë. Libri është Kurani. Sipas asaj që kam dëgjuar nga dijetarët, që e dinë shkencën e Kuranit, Urtësia është suneti i të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Kjo është më e afërta

5. Sunenu Darimi: 1/210, Mexhmeu'z-Zevaid, 1/181. Shik. Muslim, M - safir 275 (1/563) Ibn Maxhe, Mukaddime, 12 (1/59), Ahmed b. Hanbel, Musned; 1/380,404.

6. Buhari, Kitabu'l-l'tisam bi'l-Kitabi ve's-Sunneti; 15/12.

7. Ebu Davud, Sunnet, 6 (5/12); Ibn Maxhe, Mukaddime; 2, Tirmidhi; Illm; 2665. Edhe Ahmed bin Hanbeli e transmeton në musnedin e tij si sahih.

8. Me fjalën sunet synohet praktikimi i ligjeve të shariatit dhe rrugës që ka ndjekur i Dërguari i Allahut, (a.s.), e cila është shpjegim i Kuranit.

me temën tonë. Të vërtetën e di vetëm Allahu, sepse Kurani fisnik është një dhikër. Ndërsa urtësia ndjek Kurandin.

Allahu i madhëruar u shpreh robërve të tij mirësinë që ua ka dhënë me mësimin e Librit dhe të Urtësisë. Nëse bëjmë kujdes në këtë çështje, shohim se urtësia nuk është diçka jashtë sunetit të Hz. Pejgamberit (a.s.). Për këtë arsye, nuk është e drejtë të themi diçka tjetër përveç kësaj. Nga ana tjetër, bindja ndaj të dërguarit të Allahut, është bërë farz. Në të njëjtën kohë, është shpjeguar edhe obligimi që njerëzit duhet ta ndjekin Hz. Pejgamber (a.s.). Kurrë nuk është e lejuar që të thuhet një fjalë e tillë si, së pari është farz libri i Allahut, pastaj suneti i të Dërguarit të tij.

Nuk është e drejtë t'i themi farz çfarëdolloj fjale, përveç ligjeve që ndodhen në librin e Allahut dhe në sunetin e të Dërguarit të Tij. Kjo është e qartë: Suneti i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), është shpjeguar me argumente të përgjithshme dhe të veçanta. Pastaj Allahu Teala e ka përmendur urtësinë bashkë me librin e tij dhe i ka bërë ndjekës të njëri-tjetrit. Vlen të theksohet se Allahu Teala nuk ia ka dhënë këtë veçori askujt prej krijesave, përveç të Dërguarit të Tij (a.s.).

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: "Dijeni mirë këtë: mua më është dhënë Kurani fisnik dhe diçka e njëjtë me të. Në ardhje e sipër janë disa njerëz që qëndrojnë ulur në kolltuk, të qetë dhe të ngopur dhe që do të thonë: 'Kapuni pas Kuranit! Çfarëdo që të shikoni hallall aty, pranojeni si hallall! Çfarëdo që të shikoni haram, pranojeni si haram!' Ajo që ka bërë haram i Dërguari, padyshim se është haram si ajo që ka bërë haram Allahu (xh.xh).⁹

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: "Ju kam lënë dy gjëra. Përderisa të kapeni pas tyre, kurrë nuk do të devijoni. Ato janë Libri i Allahut, Kurani dhe Suneti i të Dërguarit të tij."¹⁰

Një ditë Hz. Umer, radijallahu anih, erdhi te i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, me disa fletë të Teuratit dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut! Këto janë disa fletë nga Teurati"- dhe filloi t'i lexonte. Të Dërguarit të Allahut (a.s.), po i skuqej fytyra. Në këtë moment, Ebu Bekri (r.a.), i tha Umerit: "Mbetsh jetim, mor i shkretë! A nuk e shikon shprehjen e fytyrës së të Dërguarit të Allahut?" Kur Umeri (r.a.), e pa këtë gjendje të Hz. Pejgamberit, tha:

"I kërkoj mbrojtje Allahut nga zemërimi i Allahut dhe i të Dërguarit të tij. Jam i kënaqur me Allahun si Zot, me Islamin si fe dhe me Muhamedin si profet." Pastaj i Dërguari

i Allahut, (a.s.), tha:

"Betohehem në Allahun, në dorën e të cilit është shpirti im, se sikur të vinte Musai (a.s.) dhe ta pasonit duke më lënë mua, do të devijonit nga rruga e drejtë. Sikur ai të ishte gjallë dhe të kishte arritur profetësinë time, do më pasonte mua."¹¹

Nga ana tjetër, e shoh të dobishme t'i vendos këtu edhe hadithet e mëposhtme, që kanë lidhje me temën tonë. I Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë: "Çfarë po u ndodh disa njerëzve, që largohen nga ato gjëra të cilat i bëjnë? Betohehem në Allahun, unë e njoh më mirë dhe e kam frikë më shumë se ata Allahun."

Imam Shafiu, thotë: "I Dërguari i Allahut (a.s.), krahas dispozitave që ka vendosur bashkë me librin e Allahut, ka vendosur edhe dispozita të tjera, që nuk gjenden si tekst në Kuran. Allahu na ka obliguar t'i ndjekim dhe t'u bindemi çfarëdo lloj dispozite që të vendosë i Dërguari i tij. Në këtë mënyrë, nuk ka pranuar asnjë lloj justifikimi në çështjen

e mospasimit të të Dërguarit të tij dhe diçka të tillë e ka pranuar si mëkat dhe ligësi.¹² Allahu Teala nuk ka lënë asnjë rrugë, që robërit të ndahen nga suneti i të Dërguarit të tij, (a.s.)."

Imam Shafiu, në një shprehje tjetër të bukur të tij, thotë:

"Dispozitat në librin e Allahut nuk kanë ndonjë kundërshtim me dispozitat në sunetin e të Dërguarit të Allahut. Përkundrazi, ato janë bashkë në çdo lloj gjendjeje. Kush merr diçka nga i Dërguari i Allahut, patjetër ka marrë nga Allahu, sepse Allahu e ka bërë obligim bindjen ndaj të

Dërguarit të tij." Përsëri thotë: "Kush të ketë dëgjuar një fjalë nga i Dërguari i Allahut, saktësia e transmetimit të së cilës është vërtetuar, duhet t'ua mësojë edhe të tjerëve."

Këtu kuptohet se pasuesi i një medh'hebi nuk e ka të lejuar të mos punojë me një hadith të saktë, kur ai është argument. Imam Shafiu ka thënë: "Suneti i të Dërguarit të Allahut (a.s.), bashkë me Kurandin fisnik, mund të kuptohen në dy mënyra. E para është:

Teksti i Kuranit Fisnik pason shpalljen, që Allahu i ka zbritur të Dërguarit të tij (a.s.). Ndërsa e dyta: Ai është shprehur, se synimi i ajeteve në Kurandin fisnik është shpallje, që vjen nga Allahu dhe ka shpjeguar se si janë bërë farz ato. Po ashtu ka njoftuar se si duhet të punojnë robërit nga aspekti i përgjithshëm e i veçantë dhe se si duhet



9. Ahmed bin Hanbel, Musned: 2/367,4/132, Ebu Davud, Sunnet: 6, (5/10), Imare, 33; Tirmidhi, Ilm: 10, Ibn Maxhe, 2.

10. Buhari, 1/24, Imam Malik, el-Muvatta 2/899; Hakim 1/93.

11. Imam Ahmed, Musned, 3/470-471; Darimi 1/441, el-Musannaf: 10/313-334, Mexhmeu'z-Zevaid, 1/173- 174, 182. Hadithi është hasen. Shikoni tahkikun e Miskati Mesabih.

12. Të anosh: Shik. el-Kamusu'l-Muhit.

ta kuptojnë këtë. Në këto dy çështje, i Dërguari i Allahut, (a.s.), pasonte librin e Allahut.”

Vendi që ka suneti i Profetit (a.s.), në fe, është një vlerë e paretuzueshme, sepse ai është një produkt i shpalljes. Dispozitat që vendos i Dërguari i Allahut, (a.s.), në një çështje për të cilën Allahu e ka lejuar, pranohen si dispozitat që janë vendosur nga Allahu. Ne si myslimanë, e kemi detyrim ligjor që sunetin, i cili është komentim i Kuranit që ka bërë Hz. Pejgamberi dhe zbatim i Librit të Allahut në jetën praktike, ta pranojmë të vlefshëm edhe për ne siç ka qenë në kohën e të Dërguarit të Allahut.

Ai që pohon se e kupton Kuranin më mirë se i Dërguari i Allahut, (a.s.), të cilit i ka zbritur, nuk është gjë tjetër përveçse një mashtrues. Ata që refuzojnë sunetin, duke pohuar se punojnë në emër të Kuranit, kategorikisht nuk janë të sinqertë. Ata, të cilët nuk pranojnë vendin e sunetit të pastër që ka në jurisprudencën Islame, edhe pse ka argumente të prerë për vendosjen e ligjeve nga ana e tij, janë njerëz që nuk kanë pjesë nga Islami.” (Imam Sheukani, Irshadu'l-Fuhul, fq. 29.)

Sepse në Kuran nuk ka qoftë edhe një ajet që e refuzon sunetin. Ndërkohë, ka shumë ajete që urdhërojnë pasimin dhe zbatimin e tij. Allahu i madhëruar, thotë:

“Ne ta kemi zbritur ty Librin, vetëm që ti t’u sqarosh atyre çështjet, për të cilat ata nuk pajtoheshin, si dhe që të jetë udhërrëfyes e mëshirë për njerëzit që besojnë.” (Nahl 64)

“Ai nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje hyjnore, që i vjen atij.” (Nexhm, 64) Abdullah bin Amri, thotë:

“Çdo gjë që dëgjoja nga i Dërguari i Allahut, (a.s.), e shkruaja me qëllim për ta mësuar përmendsh. Kurejshët më ndaluan ta bëj këtë. Edhe unë hoqa dorë. Pastaj i tregova të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ai bëri me shenjë nga goja e tij dhe më tha:

“Shkruaj! Beto hem në Allahun, në dorën e të cilit është shpirti im se nga këtu nuk del gjë tjetër përveç së vërtetës.” (Ebu Davud, 2/343.)

Allahu thotë: **“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut.”** (Nisa, 80)

Gjendja e atyre që e mohojnë sunetin, na kujton kufrin e qartë të atyre që duan të ndajnë Allahun nga i Dërguari i tij, siç tregohet edhe në Kuran. Allahu i madhëruar thotë për ta:

“Vërtet, ata që mohojnë Allahun dhe të dërguarit e Tij dhe dëshirojnë të ndajnë Allahun nga të dërguarit e

Tij, duke thënë: ‘Ne disa i besojmë e disa nuk i besojmë’ dhe duke dashur që kështu të zgjedhin një rrugë të ndërmjetme. Pikërisht ata janë mohuesit e vërtetë. Ne kemi përgatitur dënim poshtërues për mohuesit.” (Nisa, 150-151)

Besimi te Kurani, e shpie njeriun te teuhidi “La ilahe illallah”, ndërsa besimi te suneti i të Dërguarit të Allahut (a.s.), e shpie atë te shehadeti “Muhammedun Rasulullah”. Faktikisht, shehadeti “Muhammedun Rasulullah”, do të thotë që t’u bindesh urdhrave të të Dërguarit të Allahut, të besosh në çështjet që ka njoftuar, të largohesh nga të këqijtat që i ka ndaluar dhe të adhurosh Allahun (xh.xh.), në formën që kërkohet. Nëse dikush thotë:

“Unë nuk i besoj asnjë gjëje tjetër, përveç sunetit që ka lidhje me aspektin e veprës”, gjendja e tij hyn te kjo dispozitë e Allahut të madhëruar:

“Mos vallë, një pjesë të Librit (Teuratit) e besoni, kurse pjesën tjetër e mohoni? Cilido prej jush që vep-ron kështu, do të ndëshkohet me poshtërim në këtë jetë, ndërsa në Ditën e Kiametit do të dërgohet në dënimin më të ashpër. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj veprimeve tuaja.” (Bekare, 85)

Nëse dikush thotë: “Unë nuk i besoj dhe nuk punoj me asgjë tjetër përveç Kuranit”, ky njeri i ngjan atij që thotë: “Dëshmoj se nuk ka zot tjetër Përveç Allahut, por nuk dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i tij”. Kjo dëshmi nuk ka kurrë vlerë. Allahu Teala, thotë:

Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.” (Ali Imran, 31)

Kur umeti Islam ka hyrë në një proces të prishur në çështjet, si pasimi i Pejgamberit, nënshtrimi dhe bindja ndaj urdhrave të tij, edhe pse pohojnë se e duan të Dërguarin e Allahut, kjo është një ndjenjë dhe ndërgjegje që s’ka lidhje me teuhidin. Në të njëjtën kohë, nga aspekti i Kuranit dhe sunetit është një gënjeshtëri. Ai që pohon të kundërtën e kësaj, le të sjellë argumentin e tij. Rezultati do të nxjerrë në pah fytyrën e brendshme të çdo gjëje. Allahu i madhëruar, thotë:

“Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjykimit tënd dhe të të binden ty plotësisht.” (Nisa, 65)

vijon...





QABJA, QENDRA E VËLLAZËRISË

Ahmet Basher

Besimtarët, me zemrat plot përmallim për vendet e shenjta, vërshojnë drejt Qabes çdo vit në periudhën e haxhit ose në muajin e Ramazanit. Njerëz të kombësive, të racave, gjuhëve dhe pozitive të ndryshme sociale kryejnë tavafin sipas gjuhës dhe zemrës së tyre. Dikush lutet me zë, dikush me zë më të lartë, dikush më të lehtë dhe dikush tjetër i lutet Zotit në heshtje të plotë. Tavafi përreth Qabes vazhdon njëzet e katër orë pa ndërprerje, përveç gjatë kohës që falen pesë namazet obligative.

Kur thirret ezani, të gjithë besimtarët rreshtohen krah për krah njëri-tjetrit pa dallim pozite, statusi, kombësie dhe race. Ky është një solidaritet, që nuk mund të rastiset në asnjë vend tjetër të rruzullit tokësor.

Gjatë muajit të Ramazanit nuk ngelet vend pa u shtruar sofrat iftari. Në këto sofrat shtrohen iftare vëllazërore. Dikush ndan hurma, dikush tjetër shtron sofrat për qindra persona. Dikush shërben gjithë kënaqësi ujë zemzemi, dikush tjetër shërben çaj, kafe, fruta e kështu me radhë.

Kur e shikon me vëmendje, nuk mund të mos thuash me vete: kjo është vëllazëria e vërtetë. Vëllazëria, kaq e nevojshme për myslimanët në këto ditë, vetëm në Qabe përjetohet. Besimtarët vërshojnë si lumë i qetë rreth Qabes, kurse në namaz qëndrojnë krah për krah si një grup vargmalesh. Në sofër, përpara vetes gjithmonë preferon vëllain në besim. Megjithëse gjuhët janë të ndryshme, mjafton një buzëqeshje për t'u kuptuar me njëri-tjetrin. Një përfaqim i sigurtë mjafton për të ngrohur zemrat e tyre, megjithëse nuk e njohin njëri-tjetrin. Në mënyrë të pavullnetshme i liron vendin atij që është në këmbë, i hap rrugën atij që kalon dhe ndan sexhaden së bashku me atë që nuk e ka.

Këtë panoramë kaq të bukur dhe mahnitëse midis myslimanëve, përse nuk e shikojmë në vende dhe kohë të tjera? Në fakt, midis popujve dhe kombeve islame nuk ka asnjë problem. Të gjithë jetojnë në mënyrë paqë-

sore dhe vëllazërore me njëri-tjetrin. Problemi qëndron te drejtuesit, që bien në kurthin e intrigave dhe bëhen lojë e fuqive të huaja. Këta udhëheqës, për të zgatur sa mundur pasurinë e kësaj bote, i bëjnë padrejtësi popullit.

Sikur të gjithë liderët e botës islame të vinin së bashku në Qabe, qoftë edhe për një javë të vetme, dhe në këtë mënyrë të përjetonin vëllazërinë e vërtetë, dhe të shikonin me sy, dëgjonin me veshë dhe të ndjenin me zemrat e tyre që Zoti ynë është një, Pejgamberi ynë është një, drejtimi ynë është një, libri ynë është një dhe ezani ynë është një.

Do të ishte shumë mirë sikur të vetëndërgjegjësoheshin për mosmarrëveshjet dhe përçarjet që ekzistojnë midis tyre. Por kush mund t'i sjellë liderët myslimanë këtu? Kjo duket si e pamundur në këtë atmosferë tejskajshmërisht të polarizuar. Shejtanët njerëz bëjnë çmos për t'i mbajtur vendet myslimane në gjendje përçarjeje dhe grindjeje.

Nëse myslimanët do të ishin të bashkuar si një trup i vetëm, kujt do t'ia shisinin armët forcat armike? Mbi cilët vende do t'i provonin bombat e reja që prodhojnë? Cilat ura, rrugë, aeroporte do të shkatërroheshin për t'u ndërtuar përsëri? Shkurtimisht, si do të fitonin para korporatat?

Por, a janë vetëm fuqitë e huaja përgjegjëse për gjendjen e myslimanëve? Padyshim që jo. Çdo person dhe çdo institucion është përgjegjës për gjendjen e botës islame. Çdo mysliman është përgjegjës për ndasitë e mëdha që ekzistojnë midis myslimanëve.

Nuk ka dyshim që udhëzuesi i zemrave është Allahu. Egoistët, të cilët nuk mendojnë aspak për të tjerët, dorështrënguarit që nuk ndajnë mirësitë që u ka dhënë Allahu, të pasurit dhe drejtuesit duhet të kryejnë haxhin ose umren sa më shpesh dhe të nxjerrin mësim nga vdekja, nëse dëshirojnë të arrijnë lumturinë e kësaj bote dhe botës tjetër.

Elementet fetare në Ciklin e Kreshnikëve

Drita Isufaj

Feja mbetet një ndër vlerat më të fuqishme që qëndron në zemër të qytetërimeve, është njëherazi e shkuara dhe e tashmja e tyre, prandaj ajo në përgjithësi zë një vend të veçantë në krijimtarinë folklorike.

Në *Ciklin e Kreshnikëve* prania e elementeve fetare është e dukshme, por ato nuk janë qëllim në vetvete. Rapsoditë e *Ciklit* nuk përmbajnë propagandë fetare për përhapjen e Krishtërit (siç ndodh në disa prej epikeve evropiane) dhe as të Islamit, sepse aty, siç shprehen B. Palaj dhe D. Kurti në *Visaret e kombit*: '... nuk këndohet islami si në luftë me kristjanizëm; por këndohet fuqia e një rrace rreth njeriut, qi ka punë me zana shqiptare, kundra fiseve slave, qi duen me dërmue trojet e tija; kështu qi mbas shpirtit t'edave shqiptarë asht personifikimi i luftës ndërmyjet rracash.'¹

Në kontekstin e elementeve fetare të *Ciklit*, së pari dallohen ato që i përkasin mbishtresave turke, të cilat janë të vona në këngët kreshnike dhe nuk e kanë prekur thelbin e tyre. Mbishtresa të tilla janë të zakonshme në krijimet epike, sepse mbi bërthamën primitive të eposeve kombëtare mund të zënë vend disa shtresa kulturore².

Elementet e Islamit, në rapsoditë gjenden dendur në trajtën e formulave klishe të poezisë popullore legjendare shqiptare, të cilat në tekstet e para viteve nëntëdhjetë të Institutit të Kulturës Popullore, për arsye të njohura, nuk janë përfshirë në botime. Droja ndaj islamizimit të kreshnikëve, ose së paku e theksimit të besimit të tyre para identifikimit kombëtar, ka bërë që në përmbledhjet e botuara në Tiranë Muji të mos flasë turçe. Ndryshe ndodh me përmbledhjet

e botuara nga specialistët e Prishtinës, në tekstet e të cilave nuk ka lëvizje të tilla. Ndër *formulat klishe* që sjellin këto përmbledhje përfshihen kuvendimet e heronjve me Zotin, lutjet, faljet e namazit sipas rriteve islame etj.

Islami dhe ndikimet orientale vërehen që tek emrat e dyshes së vëllezërve *Muj* dhe *Halil*. Sido që ka pasur përpjekje poetike për t'i shpjeguar emrat e tyre me një burim etimologjik vendas (*Muj* nga *mujës*; mundës që fiton mbi të gjithë; dhe *Halil* nga *halë* dhe *yll*), burimi turko-arab i tyre është i dukshëm. Emri *Muj*, lidhet me shkurtimin e emrit me prejardhje nga arabishtja *Mustafa*, kuptimi i të cilit në shqip është: *i zgjedhur*, po ashtu edhe *Halil* është me prejardhje nga gjuha arabe dhe do të thotë: *bashkëluftëtar*, *mik* i *ngushtë*. Domethëniet e emrave të dy vëllezërve harmonizohen me pozicionin e tyre në *Cikël*; Muji është i përzgjedhuri, ai ka fuqi të mbinatyrshme dhe është i pathyeshëm, ndërsa Halili shfaqet si një lloj alteregoje e tij, është bashkëluftëtari i tij, miku i bëmave. Edhe kreshnikët e tjerë përgjithësisht kanë emra myslimanë; ata quhen *Ali*, *Mehmet*, *Hasan*, etj. Turko-arabë janë edhe titujt: *agë*, *dizdar*, *bajraktar*.

Në rapsodi të ndryshme i shohim personazhet të kryejnë konkretisht rite islame. Muji është mysliman; ai merr abdes në mëngjes herët, po kështu edhe nëna e tij:

*Nana e Mujit herët kenka çue,
Abdes bulla paska marrë,*

Kur Halili e zgjon të vëllanë me tingujt e sharkisë i drejtohet kësisoj:

*Nuk a tash sharkis me i ra,
por a koha abdes me marrë.
A don djalë sabahin ti me e falë?*

Ata përshëndesin me *selam*:

1. B. Palaj, D. Kurti, *Visaret e kombit*, Hymje, Nikaj, Tiranë, 1937, fq. 9-10.

2. Broxini Xhovani, *Epika shqiptare dhe ajo italiane*, Çështje të folklorit shqiptar, nr. 2, fq. 166-167



*Mir' selam nanës i kan dhanë
mir' selamin nana ua ka marrë*

Kur shkjetë rrethojnë kullën e Mujit dhe përpiqen ta mashtrojnë, Muji për të provuar se ata janë *shkje* i vë të marrin abdes, por ata nuk dinë ta kryejnë këtë rit e kështu zbulohen:

*Kur jan nisën abdes për me marrë
shojshojn shkiet tek p'e kqyrshin,
Nuk po dijshin abdes për me marrë.
Dikush kryet para tek p'e lante,
Dikush kambët para po m'i lante*

Shtresa e vonë e orientalizmave në epos lidhet së pari me dekorin etnografik të tij. Në epos, siç vërehet kanë hyrë formulat orientale të përshëndetjes, të urimit, të mallkimit; një varg ritesh dhe zakonesh të jetës së përditshme, sidomos për sa i takon besimit ku, shkalla e ndikimit ka qenë më e madhe. Heroi kreshnik thotë *hoshgjeldën* (turq. hoşgeldin – mirë se erdhe) dhe i flet kalit *turçe*, betohet *n'turk me din e iman* duke e kuptuar besimin si opozicion të mjaftueshëm dallimi me sllavët jomyslimanë.

Duhet theksuar se ndikimet më të rëndësishme orientale në eposin shqiptar kanë ardhur përmes instrumentit të *lahutës*. Emri i instrumentit vjen prej arabishtes: *al-'ud*. Kjo fjalë arabe mendohet se lidhet me rrënjën e vjetër të persishtes *rud*, që do të thotë *tel*.³ Ende sot nuk ka një shpjegim bindës nëse në Ballkan ka ardhur instrumenti bashkë me fjalën, apo është marrë vetëm fjala, e cila i është dhënë si emër i ri një instrumenti të ngjashëm tradicional të vendit.

Sipas Sh. Sinanit, kushtëzimi i plotë i motiveve orientale dhe i pranisë së elementëve të fesë mys-

3. Neubauer Eckhard, *Der Bau der Laute und ihre Besaitung nach arabischen, persischen und türkischen*, Quellen des 9. bis 15. Jahrhunderts, Zeitschrift für Geschichte der arabisch-islamischen Wissenschaften, vol. 8, 1993, f. 279–280.

limane në epos, me shfaqjen e pushtetit të Perandorisë Osmane në Ballkan, është një nga keqkuptimet më të zakonshme dhe njëherësh më të dëmshme të dijës.⁴ Kontaktet e botës shqiptare dhe më gjërë, asaj evropiane me Lindjen janë më të hershme; ato përkujnë pak a shumë me kohën e përhapjes së islamit, me periudhën e ndriçimit humanist të kulturës orientale, gjë që lehtësoi komunikimin e vlerave shpirtërore të saj. Nëse të gjitha lidhjet kulturore të botës shqiptare me atë orientale do të argumentoheshin me rrethanat e funksionimit të perandorisë osmane, si do të shpjegoheshin të gjitha këto ndikime e ngjashmëri në Evropën tjetër, ku Osmanët nuk mundën ta shtrijnë pushtimin e tyre perandorak? Pra duhet pranuar se ka pasur kontakte të tjera më të vjetra të popullsisë vendase evropiane me popujt myslimanë, të cilat duhet të kenë filluar që në shekujt VIII-IX.

Por si ndodh që në disa prej rapsodive personazhet falin namazet si myslimanë dhe në disa të tjera pinë verë me shakuj si të krishterë? Kjo shpjegohet me ndryshimet që pëson rapsodia gjatë procesit të transmetimit nga një rapsod tek tjetri si dhe me ruajtjen e një lloj tradite paleokristiane e kristiane ndër shqiptarë.

Në *Ciklin e Kreshnikëve* krahas ndikimeve orientale, gjenden gjithashtu paralele ndikimesh të motiveve biblike, të cilat me gjasë i përkasin periudhës së sundimit të Perandorisë Bizantine.

Motivi kryesor me prejardhje biblike në *Cikël* është konsideruar ai i ringjalljes. Mendohet se ringjallja është një nga vlerat më të rëndësishme që kënga laike e ka marrë prej botës biblike. Ky motiv është një nga shtyllat kryesore në të cilat mbahet bota e krishterë.

Në dy prej rapsodive më të njohura të eposit shqiptar *Muji mas deket* dhe *Halili mas deket*, heronjtë vriten dhe ngjallen përsëri pas njëqind vjetësh, por ata vdesin vetëm figurativisht; vdekja e tyre ka kup-

4. Sinani Shaban, *Mitologji në Eposin e Kreshnikëve*, Argeta – LMG, Tiranë, 2006, f. 123

timin e një largimi të përkohshëm nga kjo botë. Ata ngrihen sërish nga varri njëlloj sikur të ngriheshin nga shtrati:

*Dorën Mujit Halili ia ka dhanë
E prej vorrit Mujin ma ka qitë*

Kjo ringjallje e tyre është konsideruar tradicionalisht si e ngjashme me motivin biblik të ringjalljes së Krishtit. Por, duhet pasur parasysh dhe duhet të theksohet se ringjallja e Krishtit, edhe pse është një nga shtyllat e krishtërit, nuk është një arketip.⁵ Arketipi i ringjalljes e ka origjinën në disa fenomene ciklike natyrore, shpjegimi i të cilave ka shqetësuar që në lashtësi ndërgjegjen njerëzore si p.sh.: lindja dhe perëndimi i diellit dhe lindja e tij sërish ditën tjetër, lulëzimi i bimëve në pranverë dhe tharja e tyre në dimër për të lulëzuar sërish pranverën e ardhshme, yjet dhe hëna që shfaqen në mbrëmje për t'u zhdukur në mëngjes dhe për t'u shfaqur sërish mbrëmjen tjetër, por edhe vetë fenomeni i njeriut që bie në gjumë dhe zgjohet sërish (në besime të ndryshme gjumi konsiderohet si gjendje vdekjeje ose vdekja e vogël). Heronjtë e *Ciklit* zgjohen nga vdekja duke thënë: *pa-skam marrë një sy gjum*. Kjo ringjallje e tyre ka ngjyresa të mitologjisë antike dhe të besimeve pagane. Përpara se ajo të lidhet me motivin biblik duhet lidhur fillimisht me këto besime të lashta, të cilat janë kuptimësuar më vonë prej konceptit të ringjalljes së Krishtit (Isasë a.s.).

Gjurmë të dukshme të motiveve biblike kemi më së shumti tek rapsodia e veçantë e *Gjergj Elez Alisë*. "Emri i këtij personazhi përbëhet nga emri katolik *Gjergj* dhe emrat myslimanë *Elez* dhe *Ali*, pra, emër me tri pjesë, siç ka qenë zakon në Shqipëri...me rastin e laramanëve emrat treshe u bënë katolikë në pjesën e parë dhe të fundit dhe myslimanë në pjesën e mesme...ose katolik-mysliman-mysliman."⁶

Dyluftimi i heroit të kësaj kënge me bajlozin është krahasuar me dyluftimin e Shën Gjergjit me kuçed-

5. McKenzie Leon, *Pagan resurrection myths and the resurrection of Jesus*, Baker and Taylor, USA, 1997, f. 73

6. Sejko Veis, *Mbi elementet e përbashkëta në epikën shqiptaro-arbëreshe dhe serbo-kroate*, Bargjini, Tiranë, 2002, f. 157.

rën, simbolin e antikrishtit. Heroi mund të shikohet si një simbol fetar i cili çliron të tjerët nga e keqja dhe sakrifon vetveten. Figura e Shën Gjergjit mori me kalimin e kohës veshjen e kreshnikut që e ndien veten të lidhur me jetën tokësore, me truallin e vendlindjes, me njerëzit që e rrethojnë duke u kthyer kështu në simbol të luftëtarit, të prijësit që çan përpara drejt lirisë (tipare këto që e përafrojnë atë me figurën e kalorësit mesjetar).

Kalendari kohor dhe hapësira e veprimeve në këtë ep të shkurtër ndërtohen mbi bazën e numrave mistikë, siç janë treshi dhe shumëfishat e tij; në përgjithësi veprimet e kreshnikëve llogariten sipas një kalendari të lashtë, ku duket mendësia pagane ose paleokristiane e shenjtërimit të numrave: kreshnikët ndeshen me shtatë krajli, kalojnë nëntë male ndihmohen nga tri zana, vetë ata janë tridhjetë. Në rapsoditë ka një kombinim të numrave mistikë të kalendarit të kryehershëm të njerëzimit dhe të numrave të shenjtë të krishtërit.

Ka studiues që duke analizuar praninë e elementëve biblikë në eposin tonë shkojnë deri aty sa thonë se fjala *kreshnik* e ka burimin tek rrënja e vjetër e sllavishtes *krst*, prej së cilës u formua më pas *krstnik*, me kuptimin *kryqtar*, *kalorës i krishtërit*. Pra e shikojnë këtë emër si një fjalë që ruan gjurmët e shtegtimit nëpër Ballkan të disa prej kryqëzatave të shenjta. Por ky është vetëm njëri prej shpjegimeve, që janë dhënë mbi etimologjinë e kësaj fjale e që mbetet i diskutueshëm.

Për sa i takon mendimit për Zotin vërejmë se në rapsoditë Ai përmendet sidomos në formulësimet hyrëse dhe mbyllëse, por gjithashtu edhe në përmbajtjen e rapsodive; në jetën e kreshnikëve Ai është përgjithësisht pjesë e të përditshmes.

Pra në *Ciklin e Kreshnikëve* kemi një prani të konsiderueshme të elementëve fetarë islam si dhe të motiveve orientale e biblike të cilat e kanë pasuruar eposin legjendar. Duke iu kthyer edhe njëherë motiveve orientale theksojmë se shtresa e orientalizmeve në eposin tonë përbën një realitet të padiskutueshëm që është krijuar nga kontakti i kulturave, e është bërë natyrshëm pjesë e artit folklorik.



SHEJTANËT PREJ NJERËZVE DHE XHINDEVE

Nuredin Jëlldëz

Në ajetin 112, të sures En'am, Allahu Teala na bën të ditur një çështje ndaj së cilës sot duhet të kemi shumë kujdes. Allahu na njofton se xhindët dhe shejtanët janë në një koalicion në kuadër të planifikimit dhe zbatimit të së keqes. Ajeti është si më poshtë: **“Kështu, Ne çdo profeti ia kemi bërë armiq shejtanët prej njerëzve dhe xhindëve, të cilët e frymëzojnë njëri-tjetrin me fjalë boshe, të zbukuruara për mashtrim. Por, sikur të donte Zoti yt, ata nuk do të kishin mundësi ta bënin këtë, prandaj lëri ata dhe trillimet e tyre.”**

Ky ajet, në një mënyrë shumë të qartë, thekson këto pika:

a) Çdo peygamber ka pasur armiq. Peygamberët asnjëherë nuk kanë kryer mision në një terren të thjeshtë dhe pa armiq.

b) Armiqtë që kanë dalë kundër peygamberëve, janë armiqtë tanë të njohur si shejtanë, të cilët përbëhen si prej xhindëve ashtu edhe prej njerëzve. Cilësia e përbashkët e këtyre xhindëve dhe njerëzve që kanë dalë kundër peygamberëve, është djallëzia. Ata gjithmonë kanë qenë të bashkuar në armiqësi. Dhe kjo vjen si rezultat i kthimit të shejtanëve në njerëz ose i njerëzve në shejtanë. Me një fjalë, kjo dyshe, pra njerëzit dhe xhindët e kthyer në shejtanë, kanë treguar të njëjtën armiqësi dhe në këtë çështje kanë bashkëpunuar me njëri-tjetrin.

c) Ky fenomen, padyshim që është realizuar me dëshirën dhe lejen e Allahut. Nëse Allahu nuk do të kishte dëshiruar, sigurisht që edhe nuk do të kishte ndodhur.

d) Meqenëse besimtarët janë udhëtarë të rrugës së peygamberëve, atëherë, metodat dhe rezultatet e misionit të peygamberëve vlejné edhe për ta. Të gjithë besimtarët janë të detyruar të luftojnë deri në Ditën e Kiametit me një grup që ka bërë koalicion me njerëzit e shejtanizuar dhe sulmojnë fenë e Allahut. Ky është thelbi i misionit. Ata që nuk e kuptojnë këtë thelb, janë të dënuar të shkrihen e të humbasin nën forcën shtypëse të ngjarjeve dhe të ngelen të pashpresë.

Njeriu besimtar beson dhe është i sigurt se sado e madhe të jetë forca dhe numri i shejtanëve dhe derivateve të tyre, që luftojnë në të njëjtin front për të mbajtur lart flamurin e së keqes, ata nuk janë veçse një hiç përballë gjyqimit dhe caktimit të Allahut. Të besosh në këtë mënyrë, do të thotë të ushqesh idealet e peygamberëve dhe

të pasosh misionin e tyre. Allahu Teala na ka njoftuar se shejtanët do të mundohen të kultivojnë forcën e frikës mbi besimtarët, por besimtarët nuk duhet t'i frikësohen askujt tjetër përveç Tij: **“Shejtani frikëson vetëm ithtarët e vet. Ju mos iu frikësoni atyre, por frikësohuni prej Meje, nëse jeni besimtarë!”** (Al'Imran, 175.)

Besimtari, nuk duhet të ndikohet aspak prej frikës që mundohet të mbjellë e keqja. Ai duhet të besojë i palëkundur se atij do t'i mjaftojë forca e Allahut Teala. Kjo, sepse çfarëdo që mund të bëjnë, ata s'mund ta kapërcejnë dot kufirin që u ka vendosur Allahu: **“...Por, sikur të donte Zoti yt, ata nuk do të kishin mundësi ta bënin këtë...”**

Pse?

Një besimtar nuk mund të pyesë **“Pse?”** për një punë të cilën e di që e ka bërë Allahu. Ashtu si nuk mund të pyesë për shkak të dyshimit, ashtu nuk mund të pyesë edhe për aq sa qëndron brenda kornizës së edukatës që i ka falur besimi. Për një besimtar, fjalia e fundit në lidhje me këto çështje, është: **“...Unë di atë që ju nuk e dini.”** (Bekare, 30.)

Fakti që Allahu di gjithçka, është i mjaftueshëm dhe qetësues për ata që e besojnë Atë. Padyshim se lenia e peygamberëve dhe të gjithë brezave që i pasojnë ata, përballë një grupi armiqsh të përbërë prej njerëzve dhe xhindëve, e ka një shpjegim logjik. Megjithatë, nuk ka nevojë për hetime nëse ka apo s'ka ndonjë shpjegim logjik. Të shohësh urtësinë e asaj që bën Allahu, do të thotë të jetosh sikur e di të fshehtë. Ky është edhe dallimi i besimtarit.

Megjithatë, të vërtetat që do të na ndihmojnë të kuptojmë ngjarjet që ndodhin përreth nesh dhe që do t'i orientojnë ato në një rezultat, i cili nuk do ta dëmtojë botën tonë të përjetshme, gjenden para nesh. Para së gjithash, dalja në pah e së vërtetës është e mundur vetëm me ekzistencën e së keqes. Çdo gjë ekziston së bashku me të kundërtën e saj. Të bardhës i themi e bardhë, për shkak të ekzistencës së të zezës. Kuptimi i duhur i kësaj të vërtete bën që shumë ndodhi të zbardhen lehtë në mendjen e një njeriu besimtar.

Nëse mund t'i kalibrojmë syzet tona dhe numrin e tyre, do të kuptojmë se jemi duke përparuar në një rrugë të qartë dhe drejt përfundimeve të sigurta. Allahu Teala nuk lë askënd në mes të rrugës dhe kurrë nuk fton kënd në një fund të panjohur. Çdo gjë është e fshehur te syzet dhe kalibrimi i duhur i tyre.



Sulbe të zgjedhura

Arjan Ymeraj

Lotimi për Zotin

SI PËRGJËRIM DHE NEVOJË

Falënderimet e singerta i përkasin vetëm Allahut, *subhanehu ue teala*, ashtu siç e meriton Madhështia dhe Sundimi i Tij. Paaqa, lavdërimet dhe mëshira e Zotit qoftë mbi më të devotshmin e njerëzve, mbi udhërrëfyesin për në rrugën e Allahut, mbi Profetin Muhamed, *salallahu alejhi ue selem*, mbi familjen e tij të pastër, shokët e tij besnikë dhe mbi ata që e pasojnë atë me të drejtë deri në Ditën e Gjykimit.

I Dërguari i Allahut, Muhamedi, *alejhi selam*, ishte njeriu më i devotshëm midis njerëzve. Për këtë, ai i frikësohej shumë Allahut. Frika është fryt i dijes. Sa më shumë ta shtojë dijen njeriu, po aq i shtohet edhe frika. Për këtë, Allahu i Madhëruar, në Suren el-Fatir, ajeti 28 thotë: **“Me të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët.”** Ndërsa Profeti, *salallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “A e dëgjoni atë që dëgjoj unë? Krisi qielli, e si të mos krisë! Për Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, nuk gjen as katër gishta vend bosh në hapësirë, që të mos ketë një engjell që i bën sexhde Allahut të Lartësuar ose qëndron në këmbë për të, ose i përlulur. Sikur ta dinit atë që di unë, do të qeshnit pak, do të qanit shumë e do të dilnit nëpër faqet e kodrave duke iu strehuar Allahut nga frika prej dënimit të Tij.”

Frika merr vlerë atëherë kur me të arrihet nderi, devotshmëria, luftimi i së keqes dhe veprat e mira që e afrojnë njeriun tek Allahu i Lartësuar. Në një hadith kudsij (*hadith i shenjtë, që e transmeton Profeti prej Allahut*) frika përkufizohet e ndarë në dy lloje: **“Beto-hem në Krenarinë Time! Nuk bashkoj te rob i dy frikëra dhe as dy siguri. Nëse ai e ndjen veten të sigurt prej dënimit në këtë botë, i fus si frikë Ditën e Kiametit. E, nëse ai më frikësohet në këtë botë, i dhuroj si siguri Ditën e Kiametit.”**

Shkaku më i fortë, që e largon njeriun nga gjynahet

është droja (*frika*) ndaj Allahut, droja prej dënimit dhe hidhërimit të Tij. Për këtë, Allahu i Madhëruar, në Suren en-Nur, ajeti 63 thotë: **“Le të frikësohen ata që kundër-shtojnë urdhrin e Tij, që të mos i arrijë ndonjë sprovë ose që të mos i godasë një dënim i dhembshëm.”** Frika realizohet me anë të lotimit për Zotin, si përgjërimit dhe nevojë. Allahu i Lartësuar i përshkruan kështu ata që përlohen, duke thënë në Suren el-Isra, ajeti 109: **“Ata që bien me fytyrë në tokë (bëjnë sexhde), duke qarë; dhe ai (leximi i Kuranit) ua rrit përluljen.”**

Në *Musannefin* e *Abdurrezakut* transmetohet se i Dërguari i Allahut, *salallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Nuk ka sy që loton e që Allahu të mos e ruajë nga zjarri. Nuk ka lot që rrjedh në faqe e që atë fytyrë ta prekë vështirësia e përcmimi. Sikur të qante vetëm një njeri, do të mëshirohej një popull i tërë. Për çdo gjë ka peshore e masë për t’u matur, përveç lotit; me të fikën dete të tëra zjarri.”

I Dërguari i Allahut, Muhamedi, *alejhi selam*, ka thënë: “Dy sy nuk i prek Zjarri (i Xhehenemit): atë sy që qan në errësirën e natës nga frika prej Allahut dhe atë sy që gdhin duke bërë roje (duke qenë i gatshëm) në rrugë të Allahut.” Në një thënie tjetër, Profeti, *alejhi selam*, thotë: “Nuk hyn në Zjarr ai që qan nga frika prej Allahut.” Po ashtu, ai thotë: “Kur njeriut i rrënoqethet trupi nga frika prej Allahut, i bien gjynahet siç bien gjethet e thara nga pema.”

Abdurrahman Senxheri thotë:

Katër gjëra t’i lani me katër të tjera...

1. Fytyrat me ujën e syve.
2. Gjuhët me përmendjen (*dhikrin*) e Krijuesit.
3. Zemrat me drojën (*frikën*) ndaj Zotit, dhe
4. Mëkatet me pendim.



I Dërguari i Allahut *salallahu alejhi ue selem*, për shkak të frymës frikësuese të ajeteve dhe kërcënimit të fortë që mban Kurani, ka thënë: *“Më thinji Surja El-Hud dhe motrat e saj: El-Hakka, El- Vakia, Amme jetesaelun (En-Nebe’e), Et-Tekvir dhe El-Gashije.”*

Shokët e Profetit, *alejhi selam*, e më pas edhe ndjekësit e tyre (*tabiinët*), duke ndjekur shembullin e tij, si në çdo çështje tjetër, ashtu edhe në lotimin për Zotin, si përgjërimit dhe nevojë, u bënë pishtarë që ndriçojnë me rreze mirësie dhe udhëzimi, ngaqë u edukuan dhe pajisën me moralin e bukur të Profetit, *salallahu alejhi ue selem*.

Imam Aliu, *radijallahu anhu*, kur ka përshkruar sahabët (*shokët e Profetit, paqja qoftë mbi të*), ka thënë: *“Për Allahun. Kam parë sahabët e Profetit, paqja qoftë mbi të, e sot nuk shoh askënd që t’u ngjajë atyre. Gdhinin në mëngjes me flokë e rroba të pluhurosura; ndërmjet syve të tyre lëkura ishte rrudhur e mavijosur, sepse kalonin natën në sexhde e në këmbë duke lexuar Librin e Allahut. E kur zgjoheshin, përmendnin Allahun e Lartësuar, përkuleshin si pema gjatë një dite me erë, ndërsa sytë u rridhnin lot derisa u lageshin rrobat.”* E më pas, vazhdonte: *“Për Allahun, sot duket sikur njerëzit gjithë natën e shkojnë dëm, derisa zgjohen të hutuar.”*

Ebu Bekri, *radijallahu anhu*, ishte njeri që qante shumë, saqë nuk i përmbante dot lotët kur lexonte Kuran. Omeri, *radijallahu anhu*, kishte dy vija të zeza në faqe prej gjurmëve të lotëve. Gjithashtu, shumë sahabë dhe sahabë kishin gjurmë në fytyrë nga qarjet e mëdha dhe të gjata gjatë kujtimit të vdekjes dhe llogaritjes së vetes së tyre, për ta pastruar atë me pendim dhe kërkim të faljes.

Tregohet se një i moshuar pa një fëmijë që merrte abdest në një lumë duke qarë. I moshuari i tha: *“Përse qan, o djalosh?”* Fëmija ia ktheu: *“O xhaxha, lexova Kuranin derisa arrita tek ajeti i Allahut: ‘O ju që besuat, ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri...’* e u frikësova se ndoshta Allahu më hedh në zjarri.” I moshuari i tha: *“Po ti nuk je përgjegjës, sepse nuk e ke arritur moshën e pjekurisë, prandaj mos ki frikë, ti nuk e meriton Zjarrin.”* Atëherë, djaloshi i tha: *“O xhaxha, a mendon mirë apo jo? A nuk e ke parë që njerëzit kur duan të ndezin zjarr për nevojat e tyre, fillimisht e ndezin me shkopinj të vegjël, e pastaj vendosin drutë e trasha?”* I moshuari filloi të përlotej dhe tha: *“Fëmija qenka më i pjekur në besim se shumë prej nesh.”*

Një prej njerëzve të mirë ka thënë: *“Kush bën një mëkat dhe qesh për të, Allahu e shpie atë njeri në Zjarr duke qarë. Ndërsa kush i bindet Allahut duke qarë, atë njeri Allahu e shpie në Xhennet duke qeshur.”*



“Nuk ka sy që loton e që Allahu të mos e ruajë nga zjarri. Nuk ka lot që rrjedh në faqe e që atë fytyrë ta prekë vështirësia e përçmimi. Sikur të qante vetëm një njeri, do të mëshirohej një popull i tërë. Për çdo gjë ka peshore e masë për të matur, përveç lotit; me të fikën dete të tëra zjarri.”

NALTSIJA E FES MYSLIMANE

Në qoftë se e marrim parasysh në pikpamje shkencore njerin, është si një trup i perbashkët që është i formuëm prej otomevet të ndryshme; ashtu edhe njeriu është permbledhja e çudinave, është vendi i të mirës dhe i të keqes, është burimi i miqsisë e i barbarizmit, është qendra e gjithë kundërshtimevet.

Njeriu sa do lindet i qytetnuëm, por me qenë se është i pajosun me çilsinat shtazore detyrohet me ju shtrive ligjvet të natyrës; nga ky shkak del nevojat që njeriu vetë nuk mundet me marrë në kulmin e plotsimit të tij, pa pasun një shtyt që t'a largoj prej së keqës, ti diftoj rrugën e drejtë, t'a shpetoj nga errësina; se njeriu vetë kurr nuk mundet me marrë në kulmin e qytetnimit e të lumtunisë.

Se në marrshim parasysh njerinë kur duet në shesh (më mirë me thanë në faqe të dheut) ishin krejt në gjendjen e egër pa ndryshime aspak me shtazët tjera, nuk e njifshin njëri tjetrin, ishin të shperda me trupa lakuriqa, ishin të zhytun në thellojen e paditunisë, nuk dishin ç'është jeta haja, pija, gjumi, e mira e keqja.

Njeriu me gjithë se shetiste nuk e kuptonte vetëm se ku është, shetiste si i terbuemë nderpër male, fusha, germadha të pa fund ku shifte gjithë kund kafsh, shpend e nuk mujte me i dallue që ata kreatorë kanë njena me tjetrën. Në ket kohë njeriu s'mendonte tjetër gjë, veç se si me shpetuë nga rreziku i uës, që kthe kalonte duke mbytur shtazë që ishin të pa fuqishëm, e dyke u mbsheh prej shtazvet që ishin më të fuqishëm ndepër shpella e zgaura pemësh.

Që kjo vertetohet më mirë nder kohnat e sodshme. (Sot në mes të njerzvet t'Afrikës e të majmunave ka shumë pak ndryshime).

Pra kurse bota njerzore ishte në një gjendje të mjerueshme, për veç ligjës së natyrës u-lypte një

ligjë tjetër që kjo ligjë ishte e doemosëshme; me qenë se njeria është i pajosun me çilsinat shtazore detyrohet me bërë keq e nuk mundet me dal kurr në dritë. Gjer sa mos të delte një prës i drejtë që me i zgjue e me i shti n'udhë të moralit e të shoqnis e me veprue me një mënyrë të arsishme e njerzore.

Pra moralisht vërtetohet që besimi i ligjit mbi atë të natyrës "besimi i fesë ose i dinit është i domosdoshëm".

Nuk mohohet, se përparimet e mbdhaja që po shofim, zbulimet e verteta e të mrekullueshme që po bëhen, të naltsuemit e njeriut, njëti që i ka plotsue kto s'është tjetër vetëm ligjit hyjnuër "ligji qytetnore e fetare" që është dhanë nga krijuesi i gjithsisë.

Ky ligj hyjnuër u është komunikue atyne që kanë pranue e janë mundue, për lumtninë e njerzvet tjerë, atyne që kishin një zëmbër të pastër e një ndergjegje të kthjelltë. Kto njerzë të ndershëm, kto njerzë të pastër e të naltësue; që janë prësat e njerzisë, që janë ndertusat e qytetnimit, që janë themelusat e lumtunisë njerzore, kta në gjuhën fetare quhen Profetër.

Detyra e profetit të parë që:

Me i detyruë sa të jetë e mundur që mos të silleshin lakunriq, e me i largue nga çilsinat shtazore: e mos me hangër ato gjëna që ndeshin sikur shtazët. Ky prës do të vepronte si mbas kohës e s'mundej me i urdhënuë me urdhna të randa sepse nuk ishin të plotsue nevojat njerzore; tregtija industria nuk i njifshin se shtimi njerzuer ishte i pakët. Detyra e kti profeti qe sa me i shti n'udhë të moralit, e me i largue nga çilsinat shtazore.

Me kalimin e kohvet elementi njerzuer erdh tue u shtue, sa që kuptuën dobinat njerzore e me

u mësue ndër punë të mira qi pretendimi i profetit të dytë ishte i nevojshëm; se njerzit nuk ishin në gjendjen e parë.

Ky i detyron për me mësue ato gjâna qi nuk kishin talent me i krye; dhe i mëson njerzit nder punë qi ata nuk i dishin mâ parë.

Ndrimi i kohës me doemos shkaktonte qi të kishte një prîs tjetër; se njerzit e kësaj kohe kishin përparuë aq-tepër sa qi qesheshin me veprimet e para, pse ndrrimi i kohës ju gatonte një fushë të gjânë për komunikimin e një profeti tjetër.

Koha qi vinte mbas të dytit i bante njerzit me mësue e me prit një tjetër; ky pris, qi do të vinte, kishte me i plotësue të gjitha urdhnat qi mâ përpara nuk i njifshin, pse ky prîs qi do të vinte e gjênte mâ të shtruëme natyrën njerzore, e kështu ja u plotsoj nevojat e tyne.

Pra si mbas ndrimin të kohës, dhe si mbas natyrës së njerzisë kuptohet çiltazi se një ligjë hyjnuër është plotsue me ardhjen e një ligjit tjetër.

Kështu kuer duel në shesh H. Musaja, përparimi njerzuër qe shumë mâ i gjânë në përpjestimin e kohvet të tjera, tregtija, industria kishin bâ hapa mâ të mdhaja se përpara. Natyrisht koha kërkonte një ligjë mâ të plotsueme qi t'i përmbushi mâ tepër se të parat nevojat njerzore, ky libër hyjnuër ishte plotsuesi i të parvet. Prandej në librat hyjnore të perparshme nuk mujte m'u veprue se veprimi i tyne i sillte dam jetës shoqnore, dhe përparimit e kulturës njerzore.

Gjith kështu edhe në kohët të H. Isas, ndërmjet këtyne dy profetve bota njerzore kishte përparuë aqë tepër sa qi kishte një ndryshim të madhe me kohnat e perpashme. Veprimi i këti ligji ishte i domosdoshëm, pse aj ishte zgjanusi i të parit, e ishte një pengimë i madh kundrejtë përparimit, e shoqnis njerzore mos veprimi i kti ligji.¹

Me kalimin e kohës njerzija përparoj aqë tepër sa qi mbrininë në kulmin e përparimit, me një ndryshim si nata me ditën me kohnat e përparshme. Pra u kërkonte një ligjë hyjnore qi t'i pregatiste një

1. Me gjith ate disa prej dijetarve te Jahudive me qenë se kishin bâ disa ndryshime ne Tev-rat, at-here Zoti me urdhnin e Tij per me e pështue nga errsija dergoj H. Isan, po prej fisit te tyne per me e qite në drite.

herë e mbarë, udhën e drejtë, lumtunin njerzore përparimin shoqnuër.

I madhi Perendi për me e naltsuë njerin mbi gjith kreatyrët, e me e shpetuë nga mjerimi qi e kishte mbuluë, e me i sigurue lumtunin mâ të naltë të dy jetvet; dërgojti të dashtunin e tij, trupin e shejt të madhit Muham-med (hiri i Zotit qoftë mbi të) si një vetimë e pa pritun, si një rrufe e jashtë-zakonshme, ja pregatiti një herë e gjithmonë udhen e mbarë qi i duhej me ndjekë njeriut sa të jetë gjallë.

Tue i dhanë dhe statutin hyjnuër, qi është lumtunija e njerzisë, burimi i kulturës, përmirsimi i moralit, naltsimi i shpirtit, e është mâ i zgjedhuni i gjithë libravet hyjnore të tjera.

Nga ky shkak është një mëkat i madh, është një pengim rrenues kundrejt shoqnis, e përparimit botnuër me para pelqye libra tjera mbi atë; sepse ligja hyjnore e profetit të parë është plotsue me të dytin, e i dyti me të tretin; e kështu si mbas gjendjes së njerzisë me radhë deri në librin hyjnuër të H. Muham-medin.

Shkurtazi vertetohet se feja Myslimane e cila është e trashigueme prej H. Ademit e deri tu H. Muhammedi, është feja mâ e naltë, është feja mâ e vërtetë, është feja mâ e saktë, është miqsija e shoqnis njerzore, është shtyhja e përparimit dhe e kulturës, është doktorija e shndetit, është përmirsusja e të gjithë nevojave njerzore.

Mohimi s'është i drejt: se përparimet e mbdhaja qi po shofim sod i varen drejtë për së drejti kulturës fesë Myslimane. Por mjerisht sod për sod përmbajtsit e kësaj feje (mâ mirë me thanë bota Myslimane) janë në gjendjen mos-vepruse kundrejtë saj; por kjo nuk difton mungesën qi i varet asaj. Se një inxhië qi bje në durët e njerzvet qi se njofin ose se meritojnë, inxhise vlefte si humbët.

Zoti na drejtoftë n'udhë të drejtë.

"Idheja e naltë e shkollës bashkë me superiorët e saj."

Nga studentat e Shkollës së naltë fetare.

IBRAHIM HIMA
Marrë nga revista Zani i Nalte,
nr: 8, fq. 240, Marcë 1927

NJOLLAT QË SHKAKTOHEN NGA DIELLI: SI T'I HIQNI ATO?

Njollat e diellit në fytyrë janë kthyer në një fenomen që po vjen gjithnjë e në rritje, sidomos te femrat e grupmoshave të ndryshme. Kështu që është shumë e rëndësishme të merrni informacion të bollshëm për këtë çështje.

Përse shfaqen njollat kafe?

Shumë besojnë që këto njolla shkaktohen vetëm nga dielli. Ky është një mit, i cili duhet thyer duke qenë se shpesh këto njolla të fytyrës mund të lidhen thjesht me ngadalësimin natyral të procesit të ripërtëritjes së qelizave të epidermës. Natyrisht, në formimin e tyre mund të ndikojë në mënyrë të tërthortë edhe "sfondi i ekspozimit", ose rrezet e diellit të marra në mënyrë të gabuar gjatë gjithë jetës. Një shkak tjetër i shfaqjes së njollave kafe vjen nga çrregullimet hormonale. Po kështu, edhe përdorimi i kremrave dhe i parfumeve fotosensibilizante ndikon drejtpërsëdrejti në formimin e tyre. Prandaj, është mirë që njollat kafe ose ato të diellit, më mirë t'i parandaloni sesa t'i kuroni. Përpara se të filloni të ekspozoheni në diell,

është e rëndësishme të zbehni, apo më mirë t'i eliminoni këto njolla, derisa ato mos të bëhen më evidente nga nxirja diellore.

Çfarë duhet të bëni?

Kurimi i njollave kafe nga dielli është një problem të cilit i duhet kushtuar shumë kujdes, sidomos nëse e keni lëkurën të pastër (pa njolla apo akne). Në këtë lloj lëkure këto njolla bëhen më të dukshme dhe nëse fenomeni neglizhohet për një kohë të gjatë, mund të çojë në pasoja edhe më të dukshme. Prandaj duhet të mbroheni sa më shumë të jetë e mundur nga dielli, sepse nëse ky dëm ju shkaktohet vetëm një herë dhe nuk mund ta ktheni më mbrapsht. Pra çfarë të bëni? Gjëja e parë që duhet të bëni është që të merrni një "skrab" të mirë, të cilin duhet ta aplikoni minimumi 1 herë në javë, për të hequr të paktën pjesën sipërfaqësore të njollave kafe në fytyrë. Për rastet më të avancuara, kërkojini mjekut tuaj nëse ju mund të përdorni me sukses fotopeeling me lazer. Thelbësore për kurimin e njollave kafe gjatë

ekspozimit në diell, është aplikimi i kremmit specifik me vitaminë C ose me luleshtrydhe. Pas tij vendosni në fytyrë kremi klasik kundër diellit. Në këtë mënyrë ju do të mbroheni lëkurën që njollat të mos evidentohen më shumë. Mbroni gjithmonë dhe në mënyrë të përshtatshme lëkurën tuaj përpara se ta ekspozoni atë në diell, duke bërë kujdes në zgjedhjet e produkteve cilësore me faktor mbrojtës të përshtatshëm për tipin tuaj të lëkurës (minimumi 30 spf).

SI TË ZGJIDHNI LODRA TË SIGURTA PËR FËMIJËT TUAJ!

Keni dëgjuar dhe shpesh jeni bërë pjesë e lodrave të rrezikshme për fëmijët tuaj. Kjo ka ardhur si pasojë e mospasjes së informacionit të duhur. Për këtë arsye po ju paraqesim disa udhëzime se si t'i zgjidhni lodrat për fëmijët tuaj dhe se si t'i mësoni t'i përdorin ato.

Lexoni gjithmonë me kujdes udhëzimet dhe informacionet e shkruara mbi paketimin e lodrës. Verifikoni prezencën e markave të certifikimit, të cilat dëshmojnë për cilësinë e produktit. Etiketat apo shenjat që gjenden zakonisht tek lodrat, janë tre. Prandaj lodra që do të blini duhet të ketë të paktën njërën prej tyre që të konsiderohet normale. Këto janë si mëposhtë:

"CE": kjo është një lloj certifikate e cila tregon që lodra është prodhuar me materiale të sigurta dhe në përputhje me ligjet e parashikuara evropiane. Për momentin kjo është e vetmja etiketë e detyrueshme.

"Lodra të sigurta": kjo etiketë ndodhet vetëm tek ato lodra që kanë kaluar një sërë kontrollesh laboratorike për të verifikuar rezistencën dhe sigurinë e tyre.

"Siguri e kontrolluar": garanton se produkti mund të përdoret për kujdesin e fëmijëve, për shembull ajo gjendet te biberonët, gotat plastike, pelenat plastike etj.

-Preferoni gjithmonë lodra me një ekuilibër të përshtatshëm midis cilësisë dhe çmimit, produktet e lira mund të jenë të falsifikuara dhe mund të thyhen lehtë.

-Blerjen e lodrave bëjeni vetëm në dyqane të specializuara ose në hipermarkete. Dyqanet e vogla, mbi të gjitha nëse janë të huaja, mund të kenë në raftet e tyre produkte jo të sigurta dhe të pacertifikuar.

-Në paketimin e lodrës shikoni emrin e prodhuesit dhe të importuesit, për të verifikuar nëse bëhet fjalë për marka të njohura dhe të sigurta.

-Sigurohuni që lodra mos të ketë tela ose pjesë lehtësisht të ndashme, nëse i referohen një fëmije të vogël. Te lodrat elektronike, kontrolloni që kabina e baterisë të jetë e mbyllur me një vidë dhe që nuk mund të hapet nga fëmija.

-Shigjetat, harqet dhe lodra e tjera të këtij lloji duhet të kenë mbështjelljen e duhur me gomë për të mbrojtur



fëmijën dhe shoqëruesit e tij të lojës.

-Lodrat elektronike duhet të jenë të pajisura me një transformator që redukton rrymën output në një maksimum prej 24 volt.

Si testohen lodrat?

Lodrat, që mbajnë markën e nënshkruar "Lodër e sigurt", u nënshtrohen një sërë testesh që i vënë ato në provë për të verifikuar përshtatshmërinë, moshën që duhet ta përdorë atë dhe sigurinë në përgjithësi.

Testet më të rëndësishme që duhet të kapërcehen për të arritur certifikimin e lodrave janë:

- Prova e djegshmërisë.
- Prova toksike e mbulesës dhe e të gjitha pjesëve plastike dhe metalike.
- Analiza e përbërësve të përdorur te ngjyrat.
- Prova elektrike për të kontrolluar nivelin e ngrohjes së lodrave elektronike.
- Prova elektrike specifike për lodrat që përdoren në prezencë të ujit.
- Zbulimi i radioaktivitetit.
- Kontrolli i nivelit të higjienës së produktit.
- Kontrolli i rrezikut të keqpërdorimit të lojës.

NË SHQIPËRI ZHVILLOHEN PUNIMET E KONFERENCËS SË 6-TË, TË LIDERËVE MYSLIMANË TË BALLKANIT

Në Tiranë, zhvilloi punimet Konferenca e 6-të e Kryetarëve të Bashkësive Islame të Ballkanit, e organizuar nën kujdesin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, z. Bujar Nishani.

Konferenca me temë "Roli i Islamit dhe përfaqësuesve të fesë në zgjidhjen e problemeve sociale dhe shpirtërore" u organizua, më datë 18.05.2013, ku ishin të pranishëm liderë dhe personalitete fetare e publike nga vendet e rajonit, përfaqësues të trupit diplomatik të akredituar në Tiranë si dhe të ftuar të tjerë.

Fjalën e hapjes e mbajti kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë Haxhi Selim Muça, i cili pasi falënderoi të pranishmit për

pjesëmarrjen bëri një eks-
poze të veprimtarisë 22
vjeçare të KMSH-së.

Z. Muça theksoi se, *"Që një prijës fetar të pranohet nga njerëzit që e ndjekin, duhet që të jetë në gjendje t'i zgjidhë të gjitha problemet që i përkasin shoqërisë. Profeti Muhamed (a.s.), modeli që besimtarët ndjekin në jetën e tyre, u dha zgjidhje të gjitha situatave, duke i kthyer madje në favor të tij dhe të besimtarëve".*

Në këtë pikëtakim të liderëve të rajonit foli edhe kryetari i Komunitetit Mysliman të Turqisë, prof.dr. Mehmet Gormez, i cili përveç se shprehu kënaqësinë mbi pjesëmarrjen në këtë konferencë të gjerë, vlerësoi rolin e Komunitetit Mysliman në shërbim të shoqërisë shqiptare dhe kontributin e tij të vazhdueshëm në ruajtjen dhe kultivimin e vlerave të larta morale e njerëzore. Në fjalën e tij para të pranishmëve, z. Gormez theksoi se, *"feja është shumë e rëndësishme në jetën e njeriut për paqen shpirtërore, për krijimin e vlerave humane dhe moralin. Besimi dhe feja kontribuojnë në të mirën e shoqërisë. Feja është një disiplinë që ndikon mendimet dhe sjelljet e individit."*

"Nëse në jetën sociale dhe konkretisht në analizën e këndvështrimit të shkencave humane nuk inkurajohet dimensionin shpirtëror, atëherë shoqërisë do t'i mungojë një arterie e rëndësishme siç është shpirti i besimit. Ne duhet të jemi të vetëdijshëm se ashtu sikurse pushteti ka një rol të pamohueshëm në zbatimin e ligjit dhe normave shoqërore, edhe rëndësia e fesë në këtë fushë është e pamohueshme", përfundoi fjalën e tij, kreu i myslimanëve të Turqisë.

Fjalë tjetër ishte ajo e mbajtur nga Myftiu i Kosovës, z. Naim Tërnavë. Ai nënvizoi se mesazhi universal i fesë Islame, duhet të lexohet dhe shpjegohet qartë, dhe duke ecur nëpërmjet rrugës së profetit

Muhamed (a.s.), të bëhet e mundur zgjidhja e problemeve shpirtërore të individëve dhe shoqërisë. Myftiu Tërnavë foli gjatë mbi rolin social të fesë jo vetëm në Ballkan por edhe në Evropë.

Në vijim foli edhe kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë, H. Sulejman Rexhepi. Pas urimit dhe vlerësimit për homologun e tij H. Selim Muça, z. Rexhepi e vuri theksin në rëndësinë e kë-

saj konference që po zhvillohet në Shqipëri, vend ku liria e besimit u mohua për disa dekada, çka solli edhe rrënimin moral e shpirtëror të popullit shqiptar. Ai shtoi se "njerëzit e çdo feje, gjuhe dhe kombi, jetojnë prej shekujsh në këto troje në paqe dhe harmoni, e arritur kjo përmes përjetimit të fesë së lartë islame, e cila është bërë shkas për krijimin e kushteve të bashkëjetesës midis popujve tanë".

Konferenca vijoi me fjalët e kërërve të komuniteteve myslimane të shteteve të tjera pjesëmarrëse si: Mali i Zi, Greqia, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Sllovenia, Bullgaria, Rumania dhe Qiproja. Vitin që vjen, kjo konferencë do t'i zhvillojë punimet e saj në Qipro.



VESHI I ARTIFICIAL NË 3D

Shkencëtarët dhe kërkuesit nga e gjithë bota po punojnë për krijimin e pjesëve të trupit të njeriut. Këto pjesë ndërtohen për të ndihmuar njerëzit që kanë lindur pa shqisa ose që i kanë humbur shqisat në aksident apo nga sëmundje të ndryshme.

Kështu që një grup studiuesish nga Universiteti i Princeton kanë arritur të ndërtojnë një vesh artificial 3D që mund të dëgjojë më mirë se veshi i njeriut. Ajo çfarë e bën atë më interesant është printimi në 3D. Kemi dëgjuar se printerët 3D mund të ndër-

tojnë organe të njeriut në të ardhmen, por ajo çfarë vlen të theksohet rreth këtij projekti është se veshi i printuar ndërthuret me pajisjet elektronike. Kërkuesit e universitetit të lartpërmendur përdorën qeliza të printuara në 3D dhe copëza të vogla dhe pastaj kombinuan një antenë spirale për të krijuar një vesh "bionik". Përfundimi ishte një organ plotësisht funksional, që mund të dëgjojë frekuenca radioje një milion herë më mirë se veshi i njeriut.



BALONAT WIRELESS TË GOOGLE



Gjigandi Google ka filluar të punojë për sigurimin e internetit edhe përmes "balonave wireless". Ky shërbim do të ofrohet për vendet në zhvillim.

Plani është që këto "balona" të përdoren për projektimin e internetit pa kabëll përmes platformave të lartësisë së madhe, në një gamë të gjerë. Ende nuk dihet se sa do të jetë shpejtësia e internetit, që do të ofrojë ky shërbim i ri.

Këto balona do të shfrytëzojnë sinjalet televizive ekzistuese, duke

ditur se lidhjet me tela janë të disponueshme në shumë rajone të Afrikës dhe Azisë.

Burimet raportojnë se Google tashmë është në bisedime me qeveritë e disa vendeve, të cilat duhet të japin lejen për përdorimin e sinjalit. Ky veprim është një mënyrë, me të cilën Google dëshiron të fitojë avantazh në krahasim me kompanitë tjera në tregun e vendeve në zhvillim dhe t'u sigurojë atyre qasje në shërbimet e veta.

INTEL ME MIKROPROCESORË TË RINJ MË EKONOMIK

Familja e ardhshme e procesorëve Intel të koduar me emrin "Haswell" krahasuar me paraardhësit e tyre "IvyBridge" do të shtojnë me 50% jetëgjatësinë e baterive tek laptopët.

Këta procesorë janë dizajnuar enkas për laptopët dhe tabletët me qëllim konsumimin sa më të vogël të baterisë. Sipas RaniBorkar, zv.president i grupit arkitekturore në Intel, shtimi i jetëgjatësisë në bateri nuk do të shoqërohet me kosto performancë, madje në gjendje qetësie do të jetë e mundur që jetëgjatësia e baterisë të jetë përmirësuar deri në 20 herë. Përmirësimet janë vitale për kompaninë Intel si dhe për partnerët prodhues të kompjuterëve.

Shitjet e kompjuterëve janë në nivelet e tyre më të ulëta pasi përdor-

ruetit kanë kaluar në blerjen e tableteve dhe smartfonëve duke lënë disi pas dore kompjuterët mobile.

Procesorët Haswell pritet që të lançohen muajin tjetër. Një prej qëllimeve të krijimit të këtyre procesorëve lidhet me plotësimin e hendekut që ekziston midis laptopëve dhe tableteve, duke ofruar bateri më rezistente si dhe ekrane me prekje

apo tastiera portative.

Intel ka përshtatur procesorët për t'u përdorur edhe tek tabletet megjithatë në këtë rast nuk është se jetëgjatësia e baterisë do të ketë përmirësim të konsiderueshëm, por pajisja e tableteve me procesorë Intel do të ndikojë në rritjen e performancës.

Përmirësimet e procesorëve Intel vijnë si rezultat i përmirësimit të lidhjeve që do të thotë se transferimi i të dhënave realizohet shumë më shpejt, konsolidimit të rregullatorëve të voltazhit.

Ndikim të pjesshëm ka edhe njësia e menaxhimit të energjisë që përshtat në mënyrë dinamike konsumimin e energjisë në pjesë të ndryshme të procesorit duke reduktuar kështu harxhimin e energjisë.

